

LIGJ
Nr.7609, datë 22.9.1992

PËR TARIFAT DOGANORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Për qëllimet e këtij ligji zbatohen përcaktimet:

1. Me "import" kuptohet: çlirimi për qarkullim të lirë të mallrave, me origjinë nga territoret që nuk janë pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.
2. Me "eksport" kuptohet: çlirimi për qarkullim të lirë të mallrave, drejt territoreve që nuk janë pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.
3. Pezullimi i taksave në kuadrin e kuotave tarifore ka kuptimin e pezullimit të taksave për një vëllim të caktuar të importit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit të këtij ligji është i gjithë territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Tarifat doganore të Shqipërisë

Tarifat doganore në Republikën e Shqipërisë, sipas aneksit të këtij ligji zbatohen kur mallrat importohen në Republikën e Shqipërisë.

Tarifat doganore të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga:

- a) Nomenklatura e mallrave sipas aneksit të këtij ligji, e cila është krijuar duke u mbështetur në sistemin e harmonizuar;
- b) Nivelet e taksave doganore;
- c) Masat tarifore preferenciale;
- ç) Masat e pavarura pezulluese që sigurojnë një ulje ose çlirim nga taksat e importit të disa mallrave të veçanta;
- d) masa të tjera tarifore të përcaktuara me ligj.

Masat e parashikuara në shkronjat "c" dhe "d" zbatohen në vend të atyre të parashikuara nga shkronja "b", kur autoritetet doganore vërejnë që mallrat përkatëse plotësojnë kushtet e paraqitura nga këto masa të sipërpërmendura. Pra nuk është që deklaruese të bëjë kërkesë të veçantë.

Neni 4

Aneksi i këtij ligji me 97 kapituj është pjesë përbërëse e tij dhe çdo referim për ligjin përfshin në të njëjtën kohë edhe referimin për aneksin.

Neni 5

Takimi doganor i mallrave të importuara në Republikën e Shqipërisë

Mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen taksimit të detyrueshëm doganor, në qoftë se në këtë ligj nuk përcaktohet e kundërta.

Neni 6

Me propozimin e ministrit të Financave dhe të Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Tregëtisë dhe Lidhjeve Ekonomike me Jashtë, Këshilli i Ministrave mund të ndryshojë nomenklaturën e mallrave për ta përshtatur atë me konventat ndërkombëtare përkatëse.

KREU II

LLOJET E KATEGORITË E TAKSAVE DOGANORE

Neni 7

Taksat doganore dhe kategoritë e tyre

Taksat doganore caktohen në bazë të tarifave doganore të Republikës së Shqipërisë. Informacioni për taksat doganore, nivelin e tyre dhe çdo modifikim i mundëshëm duhet të publikohen menjëherë.

Neni 8

Llojet e taksave doganore

Në Republikën e Shqipërisë përdoren këto lloje taksash doganore:

- "Taksa mbi vlerën" (ad valorem), të llogaritura sipas një përqindjeje ndaj vlerës doganore të mallrave që do të taksohen;
- "taksa specifike", të llogaritura sipas një mase fikse (për njësi) të mallrave që do të taksohen;
- "taksa të kombinuara", të përbëra nga këto dy lloje të taksave doganore.

Neni 9

Taksat e eksportit për mallrat që caktohen me ligj shprehen në përqindje ndaj vlerës doganore të mallrave që eksportohen.

Neni 10

Taksat doganore sezonale

Taksat doganore sezonale vendosen për mallrat e importuara a të eksportuara për një periudhë kohe jo më tepër se 4 muaj nga data e vendosjes së tyre.

Neni 11

Llojet e veçanta të taksave doganore

Në raste të veçanta për të përforcuar a zëvendësuar taksat doganore të përcaktuara nga tarifatat doganore të Republikës së Shqipërisë, për mallrat e importuara mund të përdoren përkohësisht këto taksa:

- taksat doganore speciale;
- taksat antidumping;
- taksat kundërbalancuese.

Neni 12

Taksat doganore speciale

Taksat doganore speciale përdoren:

- si masë mbrojtëse, kur mallrat importohen në Republikën e Shqipërisë në sasi të tillë të tepërt ose në kushte të tilla që ato mund të kërcënojnë prodhuesit kombëtar të mallrave të njëjta ose të mallrave konkurruese;

- si masë ndaluese:

- a) për personat fizikë a juridikë përfshirë në marrëdhëniet e jashtme ekonomike dhe që veprojnë në kundërshtim me interesat kombëtare në këtë fushë;

- b) për të mos lejuar konkurrencën e padrejtë, përcaktuar nga rastet e vendosura në legjislacionin shqiptar;

- c) për të kundërbalancuar aktet diskriminuese të kompanive, vendeve a bashkimeve të vendeve kundrejt Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Taksat antidumping

Taksat antidumping mund të përdoren kur mallrat importohen në Shqipëri me një çmim shumë më të ulët se sa çmimi i tyre konkurrues në vendin eksportues (pikërisht në momentin e eksportimit të tyre) dhe në qoftë se një import i tillë kërcënon ose është gati të kërcënojë prodhuesit kombëtar të mallrave të njëjta ose konkurruese ose në qoftë se ai ndalon a ngadalëson organizimin apo zhvillimin e prodhimit të mallrave të njëjta në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Taksat kundërbalancuese

Taksat kundërbalancuese zbatohen, kur mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë janë prodhuar ose përpunuar me mbështetjen e subvencioneve të drejtëpërdrejta a të tërthorta dhe në qoftë se të tilla importe kërcënojnë ose janë gati të kërcënojnë prodhuesit kombëtarë të mallrave të njëjta a konkurruese, ose nëse ato ngadalësojnë apo ndalojnë prodhimin e mallrave të njëjta në Republikën e Shqipërisë.

KREU III

BAZA E TAKSIMIT PËR ZBATIMIN E TAKSAVE DOGANORE

Neni 15

Përcaktimi i bazës së taksimit për zbatimin e taksave doganore

Llogaritja e taksave doganore bëhet duke u mbështetur në:

- natyrën tarifore të mallrave;
- vlerën doganore të mallrave;
- origjinën e mallrave.

Neni 16

Përcaktimi i natyrës tarifore të mallrave

Natyra tarifore e mallrave është përshkrimi i mallrave, i dhënë nga nomenklatura e mallrave (e paraqitur në aneksin e këtij ligji).

Neni 17

Vlerësimi doganor i mallrave

Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi i paguar ose

që duhet të paguhet për mallrat, kur ato shiten për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Vlera doganore përfshin çmimin e mallrave të paraqitura në faturë, shpenzimet e transportit dhe ato të sigurimit.

Vlera doganore duhet të kushtëzohet në deklaratën doganore, kur mallrat e taksueshme kalojnë kufirin shqiptar.

Neni 18

Përcaktimi doganor i vendit të origjinës së mallrave

Një vend konsiderohet si vend i origjinës së atyre mallrave që janë prodhuar a përpunuar tërësisht atje.

Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend, vlerësohen me origjinë nga vendi ku ato përshkojnë procesin ose punën e tyre përfundimtare thelbësore, ekonomikisht të përligjur apo punën në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim dhe që rezulton në prodhimin e një produkti të ri, ose paraqet një fazë të rëndësishme të prodhimit.

Do të konsiderohen mallra tërësisht të prodhuara në atë vend:

- a) mineralet e nxjerra nga territori i tij ose shelfi i tij kontinental;
- b) produktet e marra nga shtrati i detit ose nëntoka poshtë këtij shtrati, jashtë ujërave territoriale, me kusht që ky vend të ketë të drejta ekskluzive për të shfrytëzuar këtë shtrat a nëntokë.
- c) kafshët e gjalla të lindura e rritura në territorin e tij;
- ç) produktet e marra në këtë vend prej kafshëve të gjalla;
- d) produktet vegjetale të korrura në territorin e tij;
- dh) produktet e gjuetisë dhe të peshkimit të këtij vendi;
- e) ushqimet me origjinë detare dhe peshku i prodhuar a përpunuar nga mjetet detare me origjinë nga ky vend ose marrë me qira nga ky vend, për t'u përdorur në oqean me flamurin e tij kombëtar;

ë) të gjitha nënproduktet e mbeturinat, si dhe kthimet, të rezultuara nga operacionet prodhuese të kryera në këtë vend;

f) të gjitha produktet të bëra në këtë vend nga prodhimet ose produktet e përcaktuara nga shkronja "a" deri në shkronjën "e" të këtij paragrafi.

Shërbimi doganor në Shqipëri konsideron si kriter të transformimit a të procesimit të mallrave në vendin e dhënë;

- ndryshimin e natyrës tarifore të mallrave të deklaruar;
- rritjen tërësore të vlerës bazë (si vlerë e shtuar)

Gjithashtu si kriter për të përcaktuar origjinën e mallrave, mund të merren edhe seritë e proceseve teknologjike a industriale të kryera mbi mallrat e deklaruar.

Por nuk konsiderohen si procese industriale, kështu që ato nuk e ndryshojnë origjinën e mallrave disa procese, si:

- operacionet që synojnë ruajtjen e mallrave gjatë magazinimit ose transportimit të tyre;
- operacionet e kryera përpara shitjes a transportimit të tyre (ndarja e ngarkesës, grupimi i ngarkesës, ndarja në asortimente, paketimi);
- operacionet që konsistojnë në thjesht mbledhjen (grupimin);
- përzierja e mallrave (ose e komponentëve që nuk i japin produktit përfundimtar tipare, të cilat lejojnë të bëhet një diferencim nga komponentët bazë).

Për vërtetimin e origjinës së mallrave organet doganore kërkojnë certifikatën e origjinës së mallit. Me gjithë paraqitjen e kësaj certifikate, organet doganore në raste dyshimesh serioze kërkojnë vërtetime shtesë, për të vërtetuar që treguesi i origjinës është zbatuar në përputhje me rregullat e vendosura nga legjislacioni përkatës shqiptar.

Neni 19

Llogaritja dhe pagesa e taksës doganore

Taksat doganore llogariten nga shërbimi doganor në bazë të dispozitave të këtij ligji, pasi të jetë pranuar deklarata doganore.

Taksat paguhet në lekë ose në valutë.

Pasi është llogaritur vlera doganore dhe kur duhet të paguhen taksat doganore, valutat e huaja kthehen në lekë në bazë të kursit zyrtar shqiptar në fuqi.

Taksat doganore paguhen nga importuesi ose nga përfaqësuesit e tij ligjor.

Taksat doganore paguhen në organet doganore. Të ardhurat nga taksat doganore derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU IV

PËRJASHTIME NGA TAKSAT DOGANORE, AVANTAZHET DHE PREFERENCAT TARIFORE

Neni 20

Përfjashtimet nga taksat doganore

Përfjashtimet nga taksat doganore jepen në këto raste:

a) Për mjetet e transportit që bëjnë transportimin ndërkombëtar të mallrave, të bagazheve a pasagjerëve, si dhe për makineritë e pajisjet e tyre teknike, lëndët djegëse, pajisjet e bordit dhe mallrat e tjera të nevojshme për funksionimin normal të tyre gjatë qarkullimit ose në pikat ndërmjetëse të ndalimit; apo të sjella nga jashtë për qëllime riparimi;

b) Për pajisjet dhe makineritë teknike, lëndët djegëse, lëndën e parë të përdorur në procese industriale, pajisjet dhe mallrat e tjera të eksportuara nga Republika e Shqipërisë, me qëllim që të garantohet veprimtaria prodhuese e anijeve në detin shqiptar dhe që merren me qira nga kompanitë ose agjencitë shqiptare, po ashtu, si dhe rezultatet e peshkimit të tyre të importuara në Shqipëri;

c) për valutën shqiptare dhe të huaj, si dhe letrat me vlerë shqiptare dhe ato të huaja.

ç) për mallrat e importuara në Shqipëri nga shoqatat, organizatat dhe institucionet që, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të vendosura nga Republika e Shqipërisë, janë miratuar të importojnë sipas përfjashtimeve doganore, si dhe mallrat e importuara në Shqipëri nga shoqatat, organizatat dhe institucionet në formën e ndihmave humanitare falas;

d) për mallrat e rrjedhura nga Republika e Shqipërisë dhe të riimportuara nga jashtë, pa i'u nënshtruar transformimeve ose proceseve;

dh) për mallrat e huaja të riekportuara jashtë, pa i'u nënshtruar transformimeve ose proceseve në Republikën e Shqipërisë;

e) për mallrat e huaja të riimportuara në Republikën e Shqipërisë për të cilat janë paguar taksa gjatë importimit të tyre të parë në Republikën e Shqipërisë dhe të cilat përkohësisht kanë qenë të riekportuara jashtë.

Neni 21

Ulja e taksave doganore

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë miraton uljen e taksave doganore sipas një rregulloreje të caktuar për mallrat që janë dëmtuar përpara se të zhdoganohen, por që ende mund të përdoren.

Neni 22

Masat tarifore preferenciale

Masat tarifore preferenciale vendosen në kuadrin e tarifave doganore shqiptare, sipas formës së pezullimit ose të uljes së taksave, apo sipas formës së kuotave preferenciale tarifore të importit për mallrat që rrjedhin nga shtete, të cilat formojnë me Republikën e Shqipërisë një bashkim doganor apo një zonë të lirë tregtare, ose janë në përgatitje për të krijuar bashkime të tilla apo në shtete a grup-shtetesh, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje të veçanta, që sigurojnë dhënien e trajtimit preferencial tarifor.

Neni 23

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen organet doganore.

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë ngarkohet të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 24

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.324, datë 15.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR INTERPRETIMIN E NOMENKLATURËS SË MALLRAVE

ANEKSI 1

Klasifikimi në Nomenklaturën e mallrave do të udhëhiqet sipas këtyre parimeve:

1. Titujt e seksioneve janë bërë vetëm për lehtësi referimi. Për qëllime ligjore, klasifikimi do të përcaktohet në përputhje me kushtet e krerëve dhe shënimeve të ndonjë seksioni apo kapitulli ose dhe me kusht që të tilla shënime nuk e kërkojnë ndryshe, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

2.a) Çdo referim në krye të një artikulli do të bëhet për të përfshirë një referencë për ata artikuj të paplotësuar apo të pambaruar me kusht që, ashtu siç është paraqitur, artikulli i pambaruar apo i paplotësuar ka karakterin thelbësor të artikullit të plotësuar apo të mbaruar. Ai gjithashtu mund të bëhet për të përfshirë në referencë për ato artikuj të plotësuar apo të mbaruar, (ose që mund të klasifikohet si i mbaruar apo i plotësuar sipas këtij rregulli), por të paraqitur të pambledhur apo të shpërndarë.

b) Çdo referim në krye të një materiali apo substance do të bëhet për të përfshirë një referencë për përzierjet apo kombinimet e atij materiali apo substance me materiale apo substanca të tjera. Çdo referim për mallrat e një materiali apo substance të dhënë, do të bëhet për të përfshirë një referim për mallrat që përbëhen tërësisht apo pjesërisht nga një material apo substancë e tillë. Klasifikimi i mallrave që përbëhen nga më shumë se një material apo substancë do të bëhet në përputhje me parimet e rregullit (3).

3. Kur nga zbatimet e rregullit 2(b) ose për ndonjë arsye tjetër mallrat që në pamje të parë janë klasifikuar në dy apo më shumë krerë, klasifikimi do të ketë efekt si vijon:

a) Kreu që siguron një përshkrim më specifik do të preferohet nga krerët që sigurojnë një përshkrim më të përgjithshëm. Por, kur dy apo më shumë krerë paraqesin secili vetëm ndarjen e materialeve apo substancave që bëjnë pjesë në mallrat e përbërë apo përzierjet, apo vetëm në ndarjen e mallrave në një grup të vendosur për shitjen me pakicë, këto krerë do të vlerësohen njëllë të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe në qoftë se një nga ato jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave.

b) Mallrat e përbëra dhe përzierjet që përbëhen nga materiale apo komponentë të ndryshëm dhe mallrat e vendosura në një grup për shitjen me pakicë, të cilat nuk mund të klasifikohen sipas rregullit 3 (a) do të klasifikohen sikur përbëhen nga materiali apo komponenti që i jep atyre karakterin thelbësor, aq sa mund të zbatohet ky kriter.

c) Kur mallrat nuk mund të klasifikohen sipas rregullave 3(a) apo 3(b) ato do të klasifikohen në atë kre të cilat mund të jenë të fundit në rendin numerik, midis atyre mallrave që meritojnë të njëjtin vlerësim.

4. Mallrat që nuk mund të klasifikohen sipas rregullave të mësipërme do të klasifikohen në krerët më të përshtatshëm, me mallrat me të cilat ato janë të ngjashme.

5. Në shtesë të dispozitave të mësipërme, rregullat e mëposhtme do të zbatohen përsa i përket mallrave të paraqitura brenda në:

a) Kutitë e kamerave, kutitë e instrumenteve muzikorë, kutitë e armëve, kutitë e veglave të pikturës, kutitë e bizhuterive dhe kontenierët e ngjashëm të përshtatur veçanërisht për të futur një artikull apo grup artikujsh të veçantë, të përshtatshëm për përdorim afat-gjatë dhe të paraqitur së

bashku me artikujt për të cilët ato janë bërë, do të klasifikohen me artikuj të tillë, kur ata janë të një lloji, që shiten normalisht menjëherë bashkë me të. Por, ky rregull nuk zbatohet për kontenierët që i japin të tërës karakteristikat e tyre thelbësore.

b) të nënshtuar ndaj dispozitave të rregullit 5 (a) materialet paketuese dhe kontenierët të paraqitur bashkë me mallrat brenda do të klasifikohen me këto mallra, në qoftë se ata janë të një lloji normalisht të prëdorur për paketimin e mallrave të tillë. Por, kjo klauzolë nuk është e detyrueshme kur të tilla materiale paketuese apo kontenierë janë të përshtatshme për ripërdorim.

6. Për qëllime ligjore, klasifikimi i mallrave në nënkrerë të një kreu, do të përcaktohet në përputhje me kushtet e shënimeve të këtyre nënkrerëve dhe të ndonjë nënkreu të lidhur me të, si dhe mdryshimet e nevojshme të rregullave të mësipërme, duke kuptuar se vetën nënkrerët e të njëjtit nivel zbatohen gjithashtu shënimet e seksioneve dhe të kapitujve të lidhur me njëri-tjetrin, po të mos kërkohet ndryshe nga konteksti.

SEKSIONI I KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET E TYRE

Shënime:

1- Çdo referencë në këtë seksion, për një specie apo lloj të veçantë të një kafshe, veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, përfshin një referencë për llojin apo speciet e reja.

2- Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe gjatë gjithë nomenklaturës çdo referencë për produktet e thara gjithashtu përfshin produktet të cilat janë të dehidratuara, të avulluara apo të ngrira.

KAPITULLI I KAFSHËT E GJALLA

Shënim:

1. Ky kapitull përfshin të gjitha kafshët e gjalla përveç:

a) peshkun dhe kafshët guackore që jetojnë nën ujë, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore ujore, të kreut nr.03.00;

b) kulturat e mikroorganizmave dhe të produkteve të tjera të kreut nr.30.00;

c) kafshët e kreut nr.95.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
01.00	Kafshët e gjalla	5

KAPITULLI II MISHI DHE TË BRENDSHMET E NGRËNËSHME TË MISHIT

Shënim:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) produktet e papërshtatshme për konsum njerëzor përveç sallos së derrit të nxjerrë nga mishi i dobët dhe dhjamt të shpendëve;

b) zorrët, fshikëzat apo stomaqet (kreu nr.05.00 ose gjak i kafshëve, (kreu nr.05.00 apo 30.00).

c) dhjamin kafshor, përveç sallos së derrit të nxjerrë nga mishi i dobët dhe dhjamt të shpendëve (kreu nr.15.00)

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
02.00	Mishi dhe të brendshmet e ngrënëshme të mishit	5

KAPITULLI III PESHKU DHE KAFSHËT GUACKORË TË NËNUJSHME, MOLUSQET DHE KAFSHËT E TJERA JOVERTEBRORE UJORE

Shënim:

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) sisorët detarë (kreu nr.01.00 apo mishin e tyre (kreu nr.02.00)

b) peshku (përfshirë mëlçitë dhe vezët e peshkut) ose kafshët guackore të nënujshme apo kafshët e tjera jovertebrore ujore, të ngrodhura dhe të papërshtatshme për konsum njerëzor për arsye të llojit të tyre apo kushteve të rritjes (kreu nr.05.00); miellrat, pluhurat në formë të kokërrzuar të peshkut, të kafshëve guackore të nënujshme, molusqeve dhe kafshëve të tjera jovertebrore ujore të papërshtatshme për konsum njerëzor (kreu nr.23.00)

c) havjar apo zëvendësuesit e havjarit përgatitur nga vezët e peshkut (kreu nr.16.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
03.00	Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore	5

KAPITULLI 4

PRODUKTET BULMETORE; VEZËT E SHPENDËVE, MJALTË NATYRAL, PRODUKTET E NGRËNSHME, ME ORIGJINË KAFSHORE, TË PAPËRFSHIRA APO TË PASPECIFIKUARA DIKU TJETËR

Shënim:

1. Shprehja “qumësht” nënkupton qumështin e paskremuar apo qumështin pjesërisht apo tërësisht të skremuar.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
04.00	Produktet bulmetore, vezët e shpendëve, mjaltë natyral, produktet e ngrënshme, me origjinë kafshore, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër.	5

KAPITULLI 5

PRODUKTET ME ORIGJINË KAFSHORE TË PAPËRFSHIRA APO TË PASPECIFIKUAR DIKU TJETËR

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) Produktet e ngrënshme (përveç zorrëve, fshikëzat dhe stomaget e kafshëve të tëra apo pjesë prej tyre dhe gjaku i kafshëve lëng apo i tharë);

b) Lëkurët (duke përfshirë gëzofët) përveç lëkurëve dhe pjesëve të tjera të shpendëve bashkë me puplat, lëkurët e rrjepura dhe lëkurët e ngjashme, të mbetura pasi janë përdorur si lëndë e parë, të produktve kafshore të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër, apo të kafshëve të ngordhura të kapitullit 1 ose 3, të papërshtatshme për konsumimin njerëzor (kapitulli 41 ose 43).

c) Materiale tekstile kafshore, përveç flokëve të kalit dhe mbeturinave të flokëve të kalit. Seksioni XI);

d) Nyjet apo xhufkat e përgatitura për furça apo fshesa (kreu nr.96.00).

2. Gjatë gjithë nomenklaturës dhëmbët e elefantit, të lopës së detit, të balenave dhe të derrit të egër, brirët e rinocerontit dhe dhëmbët e të gjithë kafshëve janë vlerësuar si “fildish”.

3. Gjatë gjithë nomenklaturës, shprehja “Flokët e kalit” ka kuptimin flokët e krifës apo të bishtit të kalit ose të demave.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
05.00	Produktet bulmetore, vezët e shpendëve, mjaltë natyral, produktet e ngrënshme, me origjinë kafshore, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër.	5

SEKSIONI II ZARZAVATET

Shënim:

1. Në këtë seksion shprehja “kokërr” ka kuptimin e produkteve që janë të aglomeruara, ose direkt nga ngjeshja ose nga shtesa e një lidhësi në masën jo më tepër se 3% të peshës.

KAPITULLI 6

PEMËT DHE BIMËT E TJERA TË GJALLA, KOKAT E BIMËVE, RRËNJËT DHE TË TJERA TË NGJASHME ME TO, LULET DHE GJETHNAJAT ZBUKURUESE

Shënime:

1. Ky kapitull përfshin vetëm pemët dhe bimët e gjalla (duke përfshirë edhe zarzavatet që fillimisht rriten me farë, të një lloji që zakonisht sigurohen nga fidanishtet ose lulërritësit për mbjellje apo për qëllime zbukurimi, megjithatë ai nuk mbulon patatet, qepët, hudhrrat, preshët ose produktet e tjera të kapitullit 7;

2. Çdo referencë për mallrat e ndonjë lloji do të analizohet duke e përfshirë si referencë për buqetat, shportat me lule, kurorat dhe artikujve të ngjashëm të bërë tërësisht apo pjesërisht nga mallrat e atij lloji, duke llogaritur që të mos merren material të tjera ndihmëse, por këto krerë nuk përfshijnë pllakat dekorative të kreut nr.97.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
06.00	Pemët dhe bimët e tjera të gjalla, kokat e bimëve dhe të tjera të ngjashme me to, lulet dhe gjethnajat zbukuruese	5

KAPITULLI 7

ZARZAVATET E NGRËNSHME DHE RRËNJËT E TYRE SI DHE FILIZAT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin produktet foragjere të kreut nr.12.00;

a) Produkte të kreut nr.12.00.

b) Drithërat e ëmbla në formën e specifikuar në kreun nr.11.00.

c) Patatet si miell irmik dhe si miell (kreu nr.11.00).

d) Zarzavatet e thata leguminoze të grira apo si miell (kreu nr.11.00).

2. Në kreun nr.07.00 fjala “zarzavate” përfshin: kërpudhat e ngrënshe, ullinjë, kungujt, drithërat e ëmbla, frutat e llojit Pimenta apo Capsium, kopër, majdanoz, si dhe të gjitha llojet e beharave apo erëzave.

3. Për frutat e thara, të grira apo të shtypura të llojit Capsium apo Pimenta, janë përjashtuar nga ky kapitull (kreu nr.09.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
07.00	Zarzavatet e ngrënshe dhe rrënjët e tyre si dhe filizat	5

KAPITULLI 8

FRUTAT DHE ARRAT E NGRËNSHME, LËKURAT E AGRUMEVE APO TË PJEPRAVE

1. Ky kapitull nuk përfshin frutat dhe arrat e pangrënshe.

2. Frutat dhe arrat e grira do të klasifikohen në të njëjtat kre si dhe frutat dhe arrat e freskëta.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
08.00	Frutat dhe arrat e ngrënshe, lëkurëkurët e agrumeve apo të pjeprave	5

KAPITULLI 9
KAJE, ÇAJ, MATE¹ DHE BEHARNA

Shënim:

1.Ky kapitull nuk mbulon piperin (pier, cubeba) apo produktet e tjera të kreut nr.12.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
09.00	Kafe, çaj, mate dhe beharna	10

KAPITULLI 10
DRITHËRAT

Shënime:

1. a) Produktet e specifikuara në këtë kapitull do të klasifikohen brenda tij vetëm në qoftë se paraqiten në formë kokrrash, pavarësisht nëse janë apo jo në kalli apo në kërcell.

b) Ky kapitull nuk përfshin kokrrat që janë të shkoqura a të punuara. Por orizi i zhveshur, i bluar, i pastruar, i smaltuar, i zier, si dhe mbetjet e kthyera klasifikohen brenda kreut nr.10.00.

2. Kreu nr.10.00 nuk i përfshin drithërat e ëmbla (kreu nr.07.00).

Kr eu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
10 .00	Drithërat	5

KAPITULLI 11
PRODUKTET E INDUSTRIE BLUAJTËSE, MALTI, NISESHTËJA, GLUTENI I
GRURIT, INULINA

Shënime:

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) Maltin e pjekur e krijuar si zëvendësuese kafeje (kreu nr.09.00 apo 21.00).

b) Miell i përgatitur, i bluar trashë apo niseshteja e kreut nr.19.00.

c) Kokrra drithi dhe produkte të tjera të kreut 19.00.

d) Zarzavatet, të përgatitura apo të ruajtura, të kreut nr.20.00.

e) Produktet farmaceutike (kreu nr.30.00)

f) Niseshtetë që kanë karakterin e preparateve farmaceutikozmetike apo tualeti (kapitulli 33).

2.Produktet që dalin nga industria bluajtëse, e drithrave të paraqitur në tabelën më poshtë do të futen në këtë kapitull në qoftë se kanë (sipas peshës mbi produktin e thatë):

a) përmbajtjen e niseshtesë më tepër se ajo e treguar në kolonën (2), të tabelës së drithërave në vazhdim:

b) përmbajtjen e hirit (pasi zbritet ndonjë mineral shtesë jo më tepër se ajo e treguar në kolonën (3), të tabelës së drithërave në vazhdim. Ndryshe ato futen në kreun nr.23.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
11.00	Produktet e indusrisë bluajtëse, maja, niseshteja, gluteni i grurit, inulinë	5

Drithërat	Përmbajtja e niseshtesë	Përmbajtja e hirit
1	2	3
-grurë dhe thekër	45%	2.5%

¹ Mate-një lloj e bërë nga gjethet e thara të një shkurreje gjithmonë jeshile që kultivohet në Amerikë.

-elb	45%	3%
-tërshërë	45%	5%
-misër dhe melakuq (kokërr)	45%	2%
-orizi	45%	1.6%
-okërr	45%	4%

KAPITULLI 12

FARAT VAJORE DHE FRUTAT ME PËRMBAJTJE VAJORE; DRITHËRA, FARA DHE FRUTA TË NDRYSHME; BIMËT INDUSTRIALE APO MEDICINALE; KASHTA DHE TAGJIA

Shënim:

1. Arrat dhe thelpinjtë e palmës, farat e pambukut, farat e vajit të recinit, farat e susamit, farat e mustardës, fara lulëkuqesh, do të konsiderohen si “fruta me përmbajtje vajore”. Kjo shprehje nuk do të zbatohet për produktet e kreut në 08.00 apo për ullinj të (kreu nr.07.00 apo 20.00).

2. Kreu nr.12.00 zbatohet jo vetëm për miellrat apo pluhurat e anglomeruara, të pa zhvajosura, por edhe për miellrat të cilat janë pjesërisht të zhvajosura apo të zhvajosura dhe të rivajosura tërësisht apo pjesërisht me vajin e tyre origjinal. Por ai nuk zbatohet për mbetjet e kreut nr.23.00.

3. Për qëllimet e kreut nr.12.00, farat e rrepave të kuqe, farat e barit dhe barishteve të tjera, farat e luleve zbukuruese, farat e zarzavateve, farat e pemëve të pyllit, farat e pemëve të frutave, do të vlerësohen si “farat e një lloji të përdorur për mbjellje”. Por, kreu nr.12.00 nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme, edhe në qoftë se ato përdoren për mbjellje:

a) zarzavatet leguminoze apo drithërat e ëmbla (kapitulli 7).

b) erëzat dhe produktet e tjera të kapitullit 9;

c) drithërat (kapitulli 10).

4. Kreu nr.12.00 zbatohet midis të tjerave edhe për bimët e mëposhtme apo pjesët prej tyre; nenexhik, të gjitha llojet e mëndezës, rozmarinë, syzë, sherbela, pelinë.

Kreu nr.12.00 nuk zbatohet:

a) medikamentet e kapitullit 30;

b) preparatet kozmetike, të parfumerisë, apo të tualetit të kreut nr.33.00.

c) insekticidet, herbicidet, disinfektantët, fungicidet të kreut nr.38.00.

5. Për qëllimet e kreut nr.12.00 termi “leshterikë dhe alga të tjera” nuk përfshin:

a) mikroorganizma njëqelizorë të ngordhura të kreut nr.21.

b) kulturat e mikroorganizamve të kreut nr.30.00;

c) plehrat kimike të kreut nr.31.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
12.00	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore, drithëra dhe fruta të ndryshme, bimët industriale apo medicinale, kashta dhe tagjia	5

KAPITULLI 13

GOMË, RRËSHIRË, NGJITËS, LËNGJE DHE EKSTRAKTE TË TJERA TË ZARZAVATEVE

Shënim:

1. Kreu nr.13.00 zbatohet midis të tjerave për ekstrakt jamballi, ekstraktin e kulprës së butë, ekstrakt opiumi si dhe ekstrakt pirethrumi.

Ky kre nuk përfshin:

a) Ekstrakt jamballi që përmban më shumë se 10% saharozë apo për atë që përdoret për ëmbëlsira (kreu nr.17.00)

b) Ekstrakt malti (kreu nr.19.00)

c) Ekstrakt kafeje, çaji apo mate (kreu nr.21.00);

d) Lëngje dhe ekstrakte të tjera të zarzavateve që përmbajnë pije alkoolike apo përgatitje të përbëra alkoolike të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve (kreu nr.22.00).

e) Kamfur, glicerhizinë, apo produkte të tjera të kreut nr.29.00.

- f) Medikamentet apo reagentët e grupit të gjakut (kreu nr.29.00)
g) Ekstrakt tanini apo ekstrakt ngjyroset (kreu nr.32.00).
h) Esencat vajore, të lëngëta apo të buta, rrëshiroidet, uji i distiluar aromatik dhe solucionet ujore të esencave vajore (kreu nr.33.00).
i) Gomë natyrore, balata guta-perka apo goma; e tjera të ngjashme natyrore (kreu nr.40.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
13.00	Gomë, rrëshirë, ngjitës, lëngje dhe ekstrakte të tjera të zarzavateve	15

KAPITULLI 14

MATERIALET ME ORIGJINË BIMORE QË PËRDOREN PË THURRJE, PRODUKTET, ZARZAVATET TË PASPECIFIKUARA APO TË PAPËRFSHIRA DIKU TJETËR

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin produktet e mëposhtme që do të klasifikohen në seksionin e XI; produktet e zarzavateve apo fibrat e tyre të një lloji të përdorur në radhë të parë në prodhimin e tekstileve, por megjithatë edhe materialet prej zarzavateve të përgatitura, të cilat kanë kaluar trajtimin për t'i bërë ato të përshtatshme vetëm për përdorim si materiale tekstili.

2.Kreu nr.14.00 zbatohet midis të tjerave edhe për bambunë (nëse është apo jo e çarë, e sharruar për së gjati, e prerë në copa, e rumbullakosur në fundet, e zbardhur, e lustrosur apo e lyer, i padjegshëm, shलगun e çarë, kallamat dhe të ngjashmet me të, e palmës indiane, palmën indiane të çarë apo të hapur. Kreu nuk zbatohet për drurët e prerë copa-copa (kreu nr.44.00).

3. Kreu nr.14.00 nuk zbatohet për leshin e drurit (kreu 44.00)

4. Kreu nr.14.00 nuk zbatohet për xhufkat dhe nyjet e përgatitura për bërjen e furçave apo fshesave (kreu nr.96).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
14.00	Materialet me origjinë bimore që përdoren për thurje, produktet (zarzavatet) të paspecifikuara apo të përfshira diku tjetër	5

SEKSIONI III

YNDYRNA SHTAZORE APO VEGJETALE DHE PRODUKTET E NDARJES SË TYRE; YNDYRNA TË PËRGATITURA TË NGRËNSHME; DYLLËT SHTAZORE APO VEGJETALE

KAPITULLI 15

YNDYRNA SHTAZORE APO VEGJETALE DHE PRODUKTET E NDARJES SË TYRE; YNDYRNA TË PËRGATITURA TË NGRËNSHME; DYLLËT SHTAZORE APO VEGJETALE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) dhjamin e derrave apo dhjamin e shpendëve (kreu nr.02.00)
b) gjalpë kakaon, e ngrirë apo vaj (kreu nr.18.00).
c)Pjesët e përgatitura të ngrënëshme që përbëjnë ndaj peshës më shumë se 15% të produkteve të kreut nr.04.00 (në përgjithësi kapitulli 21).
d) Bërsitë dhe mbetjet e tjera të forta, nëse janë apo jo të bluara apo në formën e pilulave, që rezultojnë nga ekstraktet e yndyrës apo të vajit të zarzavateve, të kreut nr.23.00.
e) Acidet vajore në një gjendje të veçuar, dyllët, medikamentet, bojrat, lustrat, sapunet, preparatet kozmetikë, të parfumerisë apo të tualetit, vajrat sulfanate apo mallrat e tjera të seksionit VI;
f) Fraksionet e rrjedhura nga vajrat (kreu nr.40.00)

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
15.00	Yndyrna shtazore apo vegjetale dhe produktet e	5

	ndarjes së tyre; yndyrna të përgatitura të ngrënshme; dyllet shtazore apo vegjetalë.	
--	--	--

SEKSIONI IV

ARTIKUJ USHQIMORË TË PËRGATITUR; PIJET ALKOOLET DHE UTHULLAT; CIGARET DHE DUHANI I PRODHUAR SI DHE ZËVENDESI E TYRE

1. Në këtë seksion termi “kokrra” ka kuptimin produkte që kanë qenë të aglomeruara ose direkt nga ngjeshja, ose nga shtesa e ndonjë lidhëse në raportin jo më tepër se 3% të peshës.

KAPITULLI 16

USHQIMET E PËRGATITURA PREJ MISHIT APO PESHKUT DHE KAFSHËT GUACKORE QË JETOJNË NËN UJË, MOLUSQET DHE KAFSHËT E TJERA JOVERTEBRORE UJORE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin mishin, të brendshmet e mishti, peshkun, kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore, të përgatitur apo të ruajtur nga proceset e specifikuar të kapitullit 2 dhe 3.

2. Ushqimet e përgatitura futen në këtë kapitull, me kusht që ato të përmbajnë më shumë se 20% ndaj peshës, sallami, mish të brendshmet e mishit, gjakut, peshkut, kafshëve guackore nënujore, ndonjë kombinimi të tyre. Kjo klauzolë nuk zbatohet për produktet e kreut nr.19.00 apo të përgatitjeve të kreut nr.21.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
16.00	Ushqimet e përgatitura prej mishit apo peshkut dhe kafshëve guackore që jetojnë nën ujë, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore ujore	5

KAPITULLI 17

SHEQERI DHE EMBELSIRAT

Shënim:

Ky kapitull nuk përfshin:

- Embelsirat me përmbajtje kakao (kreu nr.18.00)
- Sheqerin e pastër kimikisht (përveç saharozës, laktozës, maltoz, glukozë dhe fruktozë) apo produktet e tjera të kreut nr.29.00).
- Medikamentet apo produktet e tjera të kreut nr.30.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
17.00	Sheqeri dhe ëmbelsirat	10

KAPITULLI 18

KAKO DHE PRODUKTET E KAKAOS

Shënime:

1. Ky kapitull përfshin:

a) Dhallën, qumështin dhe ajkën e prerë, kosin të gjitha qumështet dhe ajkat e acidifikuara apo të fermentuara, nëse janë apo jo të koncentruar apo që përmbajnë sheqer shtesë, apo lëndë të tjera ëmbëlsuese apo aromatizuese, që përmbajnë fruta shtesë, arra apo kako (kreu nr.04.00).

b) Përgatitjet e ushqimeve si miell, niseshte apo ekstrakt mjalti, që nuk përmbajnë kako pluhur apo përmbajnë në raportin ndaj peshës më pak se 50% përgatitjet e ushqimeve si qumësht dhe ajkë, dhallë, qumështin dhe ajkën e prerë, hirrë apo produktet që përbëjnë pjesë në qumështin natyral, nëse janë apo jo të koncentruar apo që përmbajnë sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese që nuk përmbajnë pluhur kako apo e përmbajnë në raportin ndaj peshës më pak se 10% (kreu nr.19.00).

c) Ushqimi i përgatitur fituar nga bymimi apo pjekja e drithrave apo produktit drithor (p.sh. kokrrë, i pagatuar apo i papërgatitur ndryshe (kreu nr.19.00).

d) Buka, tortat, biskotat dhe prodhime të tjera të furrëpëjekësit, nëse përmbajnë apo jo kako (kreu nr.19.00).

e) akullore dhe akuj të tjerë të ngrënshëm që përmbajnë apo jo kako (kreu nr.21.00).

f. Pijet joalkoolike dhe pijet alkoolike; preparatet me përmbajtje alkooli, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve (kreu nr.22.00).

g) Medikamentet që konsistojnë në dy apo më shumë përbërës të cilët janë përzier së bashku përdorim terapisht apo profilaktik (kreu nr.30.00).

2. Kreu nr.18.00 përfshin ëmbëlsirat që përmbajnë kako dhe të nënshtruar ndaj shënimit (I) të këtij kapitulli, preparate të tjera ushqimore që përmbajnë kako.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
18.00	Kako dhe produktet e tij	10

KAPITULLI 19

USHQIMET E PËRGATITURA PREJ DRITHRAVE MIELLIT, NISËSHTESË APO QUMËSHTIT, PRDODUKTET E PASTICERISË APO BRUMRAVE

Shënime:

Ky kapitull nuk përfshin:

a) Përveçse në rastin e brumrave të mbushura, përgatitjet e ushqimeve që përmbajnë sallam, të brendshmet e mishit, gjak, peshk apo kafshë guackore të nënujshme, molusqe apo kafshë të tjera jovvertebrore; apo ndonjë kombinimi prej tyre më shumë se 20% të peshës (kreu nr.16.00)

b) Biskotat apo artikuj të tjerë të bërë nga mielli apo niseshteja, veçanërisht të përgatitur për përdorim në ushqimin e kafshëve (kreu nr.23.00) apo;

c) Medikamentet apo produkte të tjera të kreut nr.30.00.

2. Në këtë kapitull shprehja “miell”, ka kuptimin miell drithi të kapitulli 11 dhe miellrat apo pluhurat me origjinë prej zarzavate të çdo kapitulli.

3. Kreu nr.19.00 nuk përfshin ushqimet e përgatitura të fituar nga drithrat e bymyera apo të pjekura ose produktet drithore (p.sh.kokrra drithi); drithrat e tjera përveç misrit në formë kokrrash, të paragatuar apo të përgatitur ndryshe, që përmbajnë më shumë se 8% të peshës, kako pluhur ose veshur me çokolatë apo përgatitjeve të tjera ushqimore që përmbajnë kako (kreu nr.18.00).

4.Për qëllimet e kreut nr.19.00 shprehja “i përgatitur ndryshe”, ka kuptimin e përgatitur apo i procesuar në një zgjerim përtej asaj të siguruar nga kreu apo shënimet e kapitullit 10 apo 11.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
19.00	Ushqimet e përgatitura prej drithrave, miellrave, niseshteja apo qumështi, produktet e pasticerisë apo brumrave	10

KAPITULLI 20

USHQIMET E PËRGATITURA PREJ ZARZAVATEVE, FRUTAVE, ARRAVE APO PJESËVE TË TJERA TË BIMËVE

Shënime:

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) Zarzavatet, frutat apo arrat të përgatitura apo të ruajtur nga proceset e specifikuara në kapitullin 7,8,11.

b) Përgatitja e ushqimeve që përmbajnë më shumë se 20%, ndaj peshës, sallam, mish, të brendshme mishi, gjak, peshk, apo kafshë guackore të nënujshme, molusqe apo kafshë të tjera jovvertebrore, apo ndonjë kombinimi prej tyre (kapitulli 16).

c) Peltet e frutave, brumit të frutave, bajame të sheqeresura apo të ngjashme, molusqe apo kafshë të tjera jovvertebrore, apo ndonjë kombinimi prej tyre (kapitulli 18).

2. Kreu nr.20.00 përfshin vetëm ato produkte të kapitulli 7 (përveç miellit dhe pluhurat e produkteve të kapitullit 8) të cilat janë përgatitur apo ruajtur nga proceset e tjera nga ato të referuara në shënimin I(a).

3. Për qëllimet e kreut nr.20.00 shprehja “lëngjet e pafermentuara dhe që nuk përmbajnë alkool shtesë” ka kuptimin e një force alkoolike ndaj volumit (shiko shënimin 2 të kapitullit 22, jo më tepër se 0.5%.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
20.00	Ushqimet e përgatitura prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve	5

KAPITULLI 21 PËRGATITJE TË NDRYSHME TË NGRËNSHME

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) Zarzavatet e thara të përziera të plota të prera në feta, të shtypura apo si pluhur, por jo më tej të përgatitura (kreu nr.07.00).

b) Zëvendësuesit e pjekur të kafes që përmbajnë kafe në çdo porcion (kreu nr.09.00).

c) Piper i llojit piper; fruta të thara, të shtypura apo të grira të llojit Capsium apo Pimenta; vanilje, kanellë apo lule të drurit kanellë, karafil (fruti i plotë apo kërcelli); arrë hindi, lëkurë hindi e tharë; kopër, qimnon, krrokull, dafinë, trumzë, behanrna dhe erëza të tjea (kreu nr.09.00).

d) Përgatitjet ushqimore, përveç salcave dhe përgatitjet prej tyre, erëza të përziera dhe aromatizuesit e përzir, miell mustardë dhe mustardë e përgatitur, supat dhe lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre, përgatitjet ushqimore të përbëra të homogjenizuara, që përmbajnë më shumë se 20% ndaj peshës sallam, mishi, të brendshmet e mishit, peshkut, gjak, kafshëve guackore të nënujshme, molusqeve apo kafshëve të tjera jovertebrore apo ndonjë kombinimi prej tyre (kreu nr.16.00).

e) Përgatitjet e përbëra alkoolike të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve, të një force alkoolike (shiko shënimin 2, kapitulli 22), mbi 5% vol (kreu nr.22.00).

f) Majaja e përdorur si medikament apo produktet e tjera të kreut nr.30.00.

g) Enzimët e përgatitura të kreut nr, 35.00.

2. Ekstraktet e zëvendësuesve të shënimit I (b) të mësipërme do të klasifikohen brenda kreut nr.21.00.

3. Për qëllimet e kreut nr, 21.00 shprehja “përgatitjet ushqimore të përbëra të homogjenizuara”, ka kuptimin përgatitjet që konsistojnë në një përzirje të homogjenizuar mirë, të dy apo më shumë pjesëve përbërëse bazë, të tilla si mish, peshk, zarzavate apo fruta, të vendosura për shitjen me pakicë si ushqime për fëmijë apo për qëllime dietetike, në përbërësit me një peshë neto jo më shumë se 250 gram.

Për zbatimin e këtij përcaktimi, nuk do të bëhet asnjë llogaritje për sasi të vola të ndonjë komponenti, i cili mund të shohtet në përzirje për aromatizim, ruajtje apo për ndonjë qëllim tjetër. Përgatitjet të tilla mund të përmbajnë një sasi të vogël të pjesëve të dukshme të elementeve përbërëse.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
21.00	Përgatitjet e ndryshme të ngrënshme	10

KAPITULLI 22 PIJET, ALKOOLET DHE UTHULLAT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) Ujin e detit (kreu nr.25.00).

b) Ujin e distiluar apo ujin me të njëjtën pastërti (kreu nr.28.00).

c) Acid acetik të një koncentrimi më shumë se 10% (kreu nr.29.00).

d) Medikamentet e kreut nr.30.00.

e) Preparatet e parfumerisë apo të tualetit (kreu nr.3.00)

2. Për qëllimet e këtij kapitulli dhe të kapitujve 20 dhe 21, forca alkoolike ndaj volumit do të përcaktohet në temperaturën 20°C.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
22.00	Pijet, alkoolët dhe uthullat	15

KAPITULLI 23
MBETJET DHE METURINAT E IUNDUSTRISEË USHQIMORE. TAGJIA E PËRGATITUR PËR
KAFSHËT

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
23.00	Mbetjet dhe mbeturinat e industrisë ushqimore, tagjia e përgatitur për kafshët	5

KAPITULLI 24
DUHANI DHE ZËVENDËSUESIT E PRODHUAR TË DUHANIT

Shënim:

1.Ky kapitull nuk përfshin cigaret medicinale (kreu nr.30.00)

Kr eu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
24 .00	Duhani dhe zëvendësuesit e prodhuar të duhanit	15

SEKSIONI V
PRODUKTET MINERALE

KAPITULLI 25
KRIPA; SULFURE; OKSIDE DHE GURËT. MATERIALET SUVATUESE; GËLEQERE DHE
ÇIMENTO

Shënime:

1.Veçse kur konteksti i tyre apo shënimi 4 i këtij kapituli e kërkojnë ndryshe, kërret e këtij kapitulli përfshijnë vetëm produktet, të cilat janë në gjendje të papërpunuar apo të cilat kanë qenë larë (edhe me substanca kimike, që heqin papastërtitë pa ndryshuar strukturën e produktit), shtypur, bluar, pudëruar, situr, shoshitur, koncentruar nga fryrja ndarë magnetikisht, apo me procese të tjera fizike apo mekanike (përveç kristalizimit); apo fituar nga përzierje ose nga nënshtrimet ndaj proceseve përtej atyre që përmendëm.

Produktet e këtij kapitulli mund të përmbajnë një agjent shtesë kundër pluhurave me kusht, që të tillë agjentë të mos i japin produktit përshtatje të veçantë, për përdorim specifik më tepër se sa për përdorim të përgjithshëm.

2.Ky kapitull nuk përfshin:

- a) sulfurin e rafinuar, sulfurin e precipituar apo sulfurin kolodial (kreu nr.28.00).
- b) Oksidet me ngjyra që përmbajnë 70% apo më shumë ndaj peshës, hekur të kombinuar e llogaritur si Fe_2O_3 (kreu nr.28.00).
- c) Medikamentet dhe produktet e tjera të kreut nr.30.00).
- d) Preparatet e parfumerisë, kozmetikës dhe të tualetit (kapitulli 33).
- e) Pllakat e gurit, gurët e graniti, kubikët e mozaikëve apo të ngjashmet e tij, rasa çatie apo pllakat e fasadeve (kreu nr.11.00).
- g) kristali i përpunuar (përveç elementeve optikë) me peshë jo më pak se 2.5 gram secila, të klorurit të natriumit apo të oksidit të magnezit, të kreut nr.38.00 elementët optikë të klorurit të natriumit apo të oksidit të magnezit (kreu nr.90.00).
- h) shkumësat e bilardos (kreu nr.95.00).
- i) shkumsat e shkrimit, vizatimit rrobaqpsëve (kreu nr.96.00).

3. Kreu nr.25.00 përfshin midis të tjerave edhe penobetonin, perlitet dhe kloritet të

pazgjerueshme okside me ngjyra,. Nëse janë apo jo të kalcinuar apo të përzierë së bashku, okside hekuri natyral, izolues, argjile e bardhë (nëse është apo jo në copa të lustrosura); qelibar, argjilë e bardhë e aglomeruar dhe qelibar i aglomeruar, në fleta, shufra, shkopinj apo në forma të njëjta të papunuara pas derdhjes, qelibar i zi, elementet që përmbajnë strontium (nëse është apo jo i kalcinuar) përveç oksidit të strontiumit; poçeritë e thyera.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
25.00	Kriprat, sulfuret, oksidet dhe gurët. Materialet suvatuese, gëlqere dhe çimento	5

KAPITULLI 26 XEHERORËT, NGJYRAT DHE HIRI

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) zgjyrat dhe mbetjet e ngjashme industriale të përgatitura si zhavor (kreu nr.25.00).
- b) karbonate magneziumi natyral (magnezitë), nëse janë apo jo të kalcinuar (kreu nr.25.00).
- c) zgjyrat bazike të kapitullit 31;
- d) leshi i zgjyrës, lesh guri apo leshrat e ngjashme minerale (kreu nr.68.00).
- e) mbetjet apo mbeturinat e metaleve të çmuara apo të veshjeve metalike me metal të çmuar (kreu nr.71.00).
- f) veshjet prej bakri, nikeli apo kobalti, prodhuar nga çdo proces i shkrirjes (seksioni XV).

2. Për qëllimet e kreut nr.26.00, termi “xeherorë”, ka kuptimin e mineraleve të llojit mineralogjik, aktualisht të përdorur në industrinë metalurgjike për nxjerrjen e zhivës, të metaleve radioaktivë të kreut nr.28.00. apo të metaleve të seksionit XIV apo XV edhe në qoftë se ato destinohen për t’u përdorur për qëllime jometalurgjike, kreu nr.26.00, nuk përfshin mineralet që i nënshtrohen proceseve jo të zakonshme për industrinë metalurgjike.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
26.00	Xeherorët, zgjyrat dhe hiri	5

KAPITULLI 27 LËNDËT DJEGËSE MINERALE, VAJRAT MINERALE DHE PRODUKTET E DISTILIMIT TË TYRE. SUBSTANCAT BITUMINOZE, DYLLËT MINERALE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) përbërjet organike të prëcaktuara, të ndashme kimikisht përveç propanit dhe metanit të pastër; të cilët do të klasifikohen brenda kreut nr.27.00;
- b) medikamentet e kreut nr.30.00;
- c) hidrokraburet e përzierë jo të ndarë të kreut nr.33.00 apo 38.00.

2. Referencat për vajrat lubrifikante dhe vajrat e fituara nga mineralet bituminoze përfshirë jo vetëm vajrat e fituara nga mineralet bituminoze por gjithashtu vajrat e ngjashme si edhe ato që konsistojnë kryesisht në hidrokarburet e përzirë të pandarë, fituar nga çdo proces, me kusht që pesha e përbërësve jo aromatke ta tejkalojë atë të përbërësve aromatike.

Por, referencat nuk përfshijnë poliolefinat e lëngshme sintetike, më pak se 60% e së cilës destilohet në 300°C, pas konvertimit në 1013 milibar, ku përdoret metoda e distilimit me presion të ulur (kapitulli 39).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
27.00	Lëndët djegëse mineale; vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze, dyllët minerale	5

SEKSIONI VI PRODUKTET E INDUSTRISE KIMIKE DHE INDUSRIVE TË LIDHJEVE

Shënime:

1. Produktet radioaktive (përveç xeherorëve radioaktivë) do të klasifikohen brenda kreut nr.28.00 dhe jo në krerët e tjerë të nomenklaturës.

2. Të nënshtruar nga shënimi I më lart, mallrat e klasifikueshme brenda kreut nr.30.00, 33.00, 32.00, 35.00, 37.00 apo 38.00 për arsye të qenies së tyre në dozat e caktuara apo të vendosjes së tyre për shitje me pakicë, do të klasifikohen brenda këtyre krerëve dhe jo në krerët e tjerë të nomenklaturës.

3. Mallrat e vendosura në një grup që konisistojnë në dy apo më shumë përbërës të ndashëm, disa apo të gjitha nga të cilat bien në këtë seksion dhe kanë për qëllim të përzihen së bashku për të fituar një produkt të seksionit VI apo VII, do të klasifikohen brenda kreut më të përshtatshëm për atë produkt me kusht që pjesët përbërëse janë:

a) duke patur parasysh mënyrën në të cilën ato janë ndërtuar, qartësisht të identifikueshëm, përse i përket qënies së tyre, me qëllim për t'u përdorur së bashku pa qenë fillimisht të ringjeshura;

b) të paraqitur së bashku;

c) të identifikueshëm, pavarësisht nga natyra e tyre apo nga raportet relative në të cilat ato janë paraqitur përse i përket qënies së tyre plotësuese të njëri-tjetrit.

KAPITULLI 28

KIMIKATET INORGANIKE, PËRBËRJET ORGANIKE APO INORGANIKE TË METALEVE TË ÇMUAR TË METALEVE TË RRALLË SI DHE TË ELEMENTËVE RADIOAKTIVË APO IZOTOPEVE

Shënime:

1. Veçse ku konteksti i kërkon ndryshe, krerët e këtij kapitulli nuk zbatohen për:

a) elementët e ndashme kimikisht dhe përbërjet e caktuara të ndashme kimikisht, nëse përmbajnë apo jo papastërti;

b) produktet e përmendura në pikën (a) më lart, të tretur në ujë;

c) produktet e përmendura në pikat (a) më lart, të tretur në solventë të tjerë me kusht, që tretësira përbën një metodë normale dhe të nevojshme, për t'i bërë këto produkte të adoptueshme, veçanërisht për arsye të ruajtjes apo për transportin, dhe që solventi nuk i jep produktit përshtatje të veçantë për përdorim specifik më shumë sesa për përdorim të përgjithshëm;

d) produktet e përmendura në pika (a) (b) dhe (c) më lart me një stabilizator shtesë të nevojshme për ruajtjen dhe transportimin e tyre;

e) produktet e përmendura në pikat (a), (b), (c) dhe (d) më lart me një agjent antipluhur shtesë apo një substancë ngjyruese shtesë, për të lehtësuar identifikimin e tyre apo për arsye mbrojtëse; me kusht që shtesa nuk i jep produktit përshtatje të veçantë për përdorim specifik më shumë sesa për përdorim të përgjithshëm.

2. Në shtesë të ditionitëve dhe sulfoksilateve, të stabilizuar me substanca organike, karbonate dhe peroksorkarbonate me bazë inorganike, cianik, okside cianike dhe cianide komplekse me bazë inorganike, fulminate, cianata dhe tiacianate me bazë inorganike, përbërjet organike të metaleve të çmuara, elementet kimike radioaktive, izotopet (nëse janë apo jo radioaktive), metalet e rralla, itrium skandium apo përzierjet e këtyre metaleve dhe karbitet. Vetëm përbërjet e mëposhtme të karbonit do të klasifikohen në këtë kapitull:

a) oksid karboni cianur hidrogjeni dhe acidet fulminike, izocianik, tiocianik dhe të tjera acide cianogene të thjeshta apo të përbëra:

b) karbon disulfit;

c) tiokarbonatet, selenokarbonatet, telurokarbonatet, selecianatet, telurocianatet, tetratiocoanatodiamiokromatet dhe cianatet e tjera komplekse, me bazë inorganike;

d) peroksid hidrogjeni, i ngurtësuar me urë, oksisulfidet e karbonit, tiokarbonilet, cianogenet, cianamidet dhe derivatet e tyre metalike, përveç cianamid kalcimit, i pastër apo jo (kreu nr.31.00).

3. I nënshtruar ndaj përcaktimeve të shënimit I të seksionit VI, ky kapitull nuk përfshin:

a) klorit natriumi apo oksid magnezi, i pastër apo jo, apo produkte të tjera të Seksionit V;

- b) përbërjet organo-inorganike përveç atyre të përmendura në shënimin 2 e më lart;
 - c) produktet e përmendura në shënimin 2, 3, 4 apo 5 të kapitullit 31;
 - d) produktet inorganike të një lloji të përdorur si luminifore, të kreut 32.00;
 - e) grafitet artificiale, produktet e caktuara për zjarrfikëse, thithës boje, i vendosur në paketa për shitjen me pakicë, kristalet e përpunuara (përveç elementëve optikë) me peshë jo më pak se 2.5 gram secila, metalet alkaline (kreu nr.38.00).
 - f) gurët e çmuar apo gjysëm të çmuar (natyrale sintetike apo të rindërtuara) apo pluhuri i gurëve të tillë (kreu nr.71.00) apo lidhjet e metaleve të çmuara dhe metalet e çmuar të kapitullit 71;
 - g) metalet, të pastër apo jo, apo lidhjet metalike të Seksionit XV;
 - h) elementet optike (kreu nr.90.00)
4. Elementet kimike (p.sh. silicon) dhe sekeni 7, të stimuluar për qëllime elektronike, do të klasifikohen brenda këtij kapitulli, me kusht që ato të jenë në formë të papunuara siç nxirren, apo në formën e cilindrave apo shufrave. Kur priten në formën e diskut, apo të rrumbullakët, apo forma të ngjashme ato bien brenda kreut nr.38.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
28.00	Kimikatet inorganike, përbërjet organike apo inorganike të metaleve të çmuara, të metaleve të rrallë si dhe të elementëve radioaktivë apo izotopëve	5

KAPITULLI 29 KIMIKATET ORGANIKE

Shënime:

1. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, kërret e këtij kapitulli zbatohen vetëm për:
 - a) përbërjet organike të përcaktuara, kimikisht të ndashme nëse përmbajnë apo jo papasërti;
 - b) përzierjet e dy apo më shumë izomerëve të përzierjeve të njëjta organike (nëse përmbajnë apo jo papasërti), përveç përzierjeve të izomerëve aciklik hidrokarbonik (përveç stereoizomerëve nëse janë apo jo të saturuar (kapitulli 27).
 - c) provitaminat, vitaminat dhe hormonet, nëse janë apo jo të përcaktuar kimikisht; glukocidet dhe alkaloidet e zarzavateve, natyrale apo të riprodhuara nga sintezat dhe kriprat e tyre, esteret, steret dhe derivatet e tyre, nëse janë apo jo të përcaktuar kimikisht. Eteret dhe esteret e sheqerit dhe kriprat e tyre, nëse janë apo jo të përcaktuar kimikisht, antibiotikët, nëse janë apo jo të përcaktuar kimikisht;
 - d) produktet e përmendura në pikat (a),(b) dhe (c) më se të tretur në ujë;
 - e) produktet e përmendura në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër të tretur në solventë të tjerë me kusht që solucioni përbën një metodë normale dhe të nevojshme për t'i bërë këto produkte të adoptueshme, veçanërisht për arsye të ruajtjes apo të transportimit dhe që solveni nuk i jep produktit përshtatje të veçantë për përdorim specifik më shumë sesa për përdorim të përgjithshëm;
 - f) propduktet e përmdnura në (a), (b), (c),(d) dhe (e) më lart me një stabilizator shtesë të nevojshme për ruajtjen apo transportin e tyre;
 - g) propduktet e përmdnura në (a), (b), (c),(d), (e) dhe (f) më lartë me një agjent shtesë antipluhur apo substancë ngjyuese apo aromatizuese shtesë për të lehtësuar identifikimin e tyre apo për arsye mbrojtëse, me kusht që shtesa nuk i jep produktit përshtatje të veçantë për qëllime specifike më tepër sesa për qëllime të përgjithshme;
 - h) produktet e mëposhtme, të holluar drejt fortësisë së standardizuar, për prodhimin e azongjyrosësve kriprat diazonium, lidhësit e përdorur për këto kripera dhe aminet diazotizable dhe kriprat e tyre.
2. Ky kapitull nuk përfshin:
 - a) Yndyrnat si dhe fraksionet e tyre të peshkut apo të sisorëve detarë të rafinuar apo jo (kreu nr.15.00).
 - b)alkool etilik (kreu nr.22.00);
 - c) metan apo propan (kreu 27.00);
 - d) përbërjet e karbonit të përmendur në shënimin 2 të kapitullit 28;
 - e) urea (kreu nr.31.00);
 - f) lëndët ngjyrosëse me origjinë kafshore apo vegjetale, lëndët organike sintetike ngjyuese,

produktet organike sintetike të një lloji të përdorur si agjentë fluoreshentë ndriçues ose si luminofere ngjyrosëse apo lëndë të tjera ngjyrosëse të vendosur në forma apo paketa për shitjen me pakicë (kreu nr.32.00)

g) enzimët (kreu nr.35.00)

h) metaldehide, heksametilenetetramine apo substancat e ngjashme, vendosur në forma (p.sh. tableta, shkopinj apo forma të ngjashme) të përdorura si djegës, djegës lëng apo gaz në kontenierët e një lloji të përdorur për mbushjen apo rimbushjen e cigareve apo çakmakëve dhe të një kapaciteti jo më tepër se 300 cm² (kreu nr.36.00).

i) produktet e caktuara për zjarrfikësat apo vendosur në granatat zjarrfikëse; thithësit e bojës të vendosur në paketa për shitjen me pakicë (kreu nr.38.00).;

k) elementët optikë, p.sh.tartrati etilenidiaminë (kreu nr.90.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
29.00	Kimikatet organike	5

KAPITULLI 30 PRODUKTET FARMACEUTIKE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) ushqimet apo pijet (të tilla si ushqimet diabetike, dietike apo të përforcuara, ushqime shtojcë, pijet tonike dhe ujrat minerale). (Seksioni IV);

b) allçi, veçanërisht e kalçinuar apo e bluar imët për përdorim në stomatologji (kreu nr.25.00).

c) solucionet e ujhme apo të ujhme të distiluara të vajrave thelbësorë, të përshtatshme për përdorim mjekësor (kreu nr.33.00);

d) përgatitjet e mëposhtme: ujrat e parfumuara dhe të tualetit, përgatitjet për zbukurime dhe përgatitjet për kujdesin e lëkurës (përveç medikamenteve), duke përfshirë përgatitjet për t'u mbrojtur nga dielli, manikyret apo përgatitjet e tjera për thonjtë, përgatitjet për flokët ato për higjienën dentare apo të gojës, duke përfshirë pastat dhe pluhurat dentare, përgatitjet para-rroje gjatë rrojës apo pas rrojës, deodorantët personalë, përgatitjet e banjës, depilatorët dhe përgatitjet e tjera të parfumerisë, kozmetikës apo tualetit, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër, deodorantët e dhomës, nëse janë apo jo të parfumuara apo kanë qëllime desinfektimi, edhe në qoftë se ato kanë veti terapike apo profilaktike;

e) sapunët apo produktet e tjerë të kreut nr. 34.00 që përmbajnë medikamente shtesë;

f) preparatet me bazë allçie, për përdorim në stomatologji (kreu nr.34.00);

g) albumina e gjakut e përgatitur jo për përdorimin terapik apo profilaktik (kreu nr.35.00);

2. Kreu nr.30.00 përfshin, ndër të tjera edhe mallrat e mëposhtme, të cilat do të klasifikohen në këtë kre dhe jo në krerët e tjerë të nomenklaturës;

a) kordat sterile kirurgjikale, materialet e ngjashme sterile për qepjen e plagëve dhe lidhësit sterilë muskulorë për mbylljen e plagëve kirurgjikale;

b) mbuluesit sterilë prej metali;

c) hemostatikët detnarë apo hemostatikët sterilë absorbues kirurgjikalë;

d) përgatitjet e padepërtueshme nga drita për ekzaminime me rreze x dhe reagentët diagnostikues të përcaktuar për t'u administruar nga pacienti, duke qenë produkte të papërziera, të ndërtuar në doza të matura apo produkte që konsistojnë në dy apo më shumë pjesë përbërëse që janë përzier së bashku për të tilla qëllime;

e) reagentët e grupit të gjakut;

f) cementet dentare dhe mbushjet e tjera dentare; cementet e rindërtimit kockor;

g) kutitë dhe çantat e shpinës së ndihmës së parë;

h) përgatitjet kimike absorbuese bazuar në hormonet.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
30.00	Produktet farmaceutike	5

KAPITULLI 31
PLEHRAT KIMIKE

Shënime:

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) gjakun e kafshëve të kreut nr.05.00;

b) përbërjet e përcaktuara kimikisht të ndashme (përveç atyre që i përgjigjen përshkrimeve në shënimet 2/A, 3/A, dhe 4/A të mëposhtme);

c) kristalet e kloritit të përpunuar të potasiumit (përveç elementeve optikë) që peshojnë jo më pak se 2.5 gram secila, të kreut nr.38.00; elementët optikë të kloritit të potasiumit (kreu nr.90.00).

2. Kreu nr.31.00 përfshin ndër të tjera edhe mallrat e mëposhtme:

A. Mallrat që i përgjigjen njërit nga përshkrimet e dhëna më poshtë;

I. nitrat natriumi, i pastër apo jo;

II)anitrat amoni, i pastër apo jo;

III)akriprat e dubluara, të pastra apo jo, të sulfatit të amonit dhe nitratit të amonit;

IV) sulfat amoni i pastër apo jo;

V) kriprat e dubluara (të pastra apo jo) apo përzierjet e nitratit të kalciumit dhe nitratit të amonit;

VI) kriprat e dubluara (të pastra apo jo) apo përzierjet e nitratit të kalciumit dhe të nitratit të magnezit;

VII) cianamid kalciumi, i pastër apo jo apo i trajtuar me vaj;

VIII) urea, e pastër apo jo.

B. Plehrat kimike që konsistojnë në secilin nga mallrat e përshkruara në shkronjën A më lart, të përzier së bashku.

C. Plehrat kimike që konsistojnë në kloritin e amonit apo në secilin nga mallrat e përshkruara në shkronjën A apo B më lart të përzier me shkumës, allçi apo substanca të tjera inorganike jo plehëruese.

D. Plehrat kimike lëng që konsistojnë në mallrat e nënparagrafit A (II) apo VIII më lart, apo të përzierjeve të këtyre mallrave, në një solucion të lëngshëm apo në një solucion amoniaku.

3. Kreu nr.31.00 zbatohet ndër të tjera edhe për mallrat e mëposhtme:

A. Mallrat të cilat i përgjigjen njëres ndër përshkrimet e dhëna më poshtë:

I) ngjyrat bazike;

II) fosfatet natyrale të kreut nr.25.00, të kalcinuar apo të trajtuara me nxehtësi më tepër sesa për zhdukjen e papastërtive;

III) superfosfatet (njëshe, dyshe apo treshe);

IV) hidrogenfosfate kalciumi që përmbajnë fluorinë jo më pak se 0.2% ndaj peshës së llogaritur mbi produktin anhidrido të thatë.

B. Plehra kimike që konsistojnë në çdo mall të përshkruar në shkronjën A më lart, të përzier së bashku, por pa marrë parasysh kufirin e përmbajtjes së fluorinës.

C. Plehrat kimike që konsistojnë në çdo mall të përshkruar në shkronjat A apo B më lart, por pa marrë parasysh kufirin e përmbajtjes së fluorinës, të përzier me shkumës, gips apo substanca të tjera inorganike joplehëruese;

4. Kreu nr.31.00 zbatohet ndër të tjera edhe për mallrat e mëposhtme:

A. Mallrat që i përgjigjen njëres nga përshkrimet e mëposhtme:

I) kriprat natyrale të papërpunuara të potasit (p.sh.karnalitet, kainitet dhe silvitit);

II) klorit potasi, i pastër apo jo, përveç asaj siç është përcaktuar në shënimin I (e) më lart;

III) sulfat potasi, i pastër apo jo;

IV) sulfat potasi-magnezi, i pastër apo jo;

B. Plehrat kimike që konsistojnë në çdo nga mallrat e përshkruar në shkronjën A më lart, të përzier së bashku.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
31.00	Plehrat kimike	10

KAPITULLI 32
EKSTRAKTET NGJYROSËSE DHE TEKNIKE, TANINET DHE DERIVATET E TYRE;
NGJYROSËSIT; PIGMENTET DHE LËNDË TË TJERA NGJYROSËSE; BOJRAT DHE
LLUSTROSËSIT; STUKO DHE MASTICET E TJERA; BOJRAT E SHKRIMIT

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) elementët apo përbërjet e përcaktuara të ndashme kimikisht (përveç lëndëve ngjyrosëse, kreu nr.32.00) produktet inorganike të një lloji të përdorur si luminofore (kreu nr.32.00) xhami i fituar nga kuarci i shkrirë apo silice të tjera të shkria në forma të një lloji të përdorur në industrinë qeramike, në industrinë e qelqit apo atë zmltuese dhe gjithashtu ngjyrosësit dhe lëndë të tjera ngjyrosëse të vendosura në forma apo paketa për shitjen me pakicë (kreu nr.32.00);

b) tanatet apo derivatet e tjera tanike të provitaminave, vitaminave, hormoneve, glukocideve dhe alkaloidëve të zarzavateve ntaryale apo të riprodhuar nga sinteza dhe kripërat e tjera etere, estere dhe derivatet e tyre, antibiotikët, kazeinat, kaseinatet dhe derivatet e tjera të kazeinës, albuminës, helatinë dhe derivate të tjera të xhelatinës, peptonet si dhe derivatet e tyre;

c) masticet e asfaltit apo ngjitësa të tjera bituminoze (kreu nr.27.00).

2. Kreu nr.32.00 përfshin përzierjet e kriprave dhe lidhjeve të stabilizuara të diazonit për prodhimin e ngjyrosësve azo;

3.Shprehja “lëndët ngjyrosëse” në këtë kapitull nuk përfshin produktet e një lloji të përdorur si zgjerues në bojrat vajore nëse ato janë apo jo gjithashtu të përshtatshme për tempera ngjyrosëse.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
32.00	Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike; taninet, derivatet e tyre; ngjyrosësit, pigmentet dhe lëndë të tjera ngjyrosëse; bojrat dhe llustrosësit; stuko dhe mastiçet e tjera, bojrat e shkrimit	15

KAPITULLI 33
VAJRAT THELBËSORE DHE RRËSHIRAT; PREPARATET KOZMETIKE TË PARFUMERISË
APO TË TUALETIT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) përgatitjet e përbëra alkoolike të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve të kreut nr.22.00;

b) sapuni dhe prdukte të tjera të kreut nr.34.00;

c) terpentinat sulfate, prej gome apo druri apo produkte të tjera të kreut nr.38.00;

2. Kreu nr.33.00 përfshin ndër të tjera edhe produktet të përziera apo jo (përveç distilateve të lëngshme dhe solucioneve të lëngshme të vajrave thelbësore) të përshtatsme për përdorim si mallrat e këtij kreu dhe të paketuara në një lloj për shitjen me pakicë, për qëllime të tilla.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
33.00	Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, prerparatet kozmetike, të parfumerisë apo të tualetit	30

KAPITULLI 34
SAPUNI; AGJENTËT ORGANIKË , E VEPRIM TË SIPËRFAQSHËM, PREPARATET LARËSE,
PREPARATET LUBRIFIKUESE, DYLLËT ARTIFICIALE, DYLLËT E PËRGATITURA,
PREPARATET LUSTROSËSE APO PASTRUESE, QIRINJTË DHE ARTIKUJ TË NGJASHËM,
PASTAT MODELISTE, DYLLËT DENTARE DHE PËRGATITJET DENTARE NË BAZË ALLÇIE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) përzierjet apo përgatitjet e ngrënshme të yndyrnave shtazore apo vegjetale të një lloji të përdorur si preparate për nxjerrjen e formave nga kallëpi;

b) komponentë të përcaktuara kimisht të ndashme;
 c) kremart dhe pastat e shamos, të rrojes apo të pastave të dhëmbëve apo përgatitjeve të banjës, që përmbajnë sapun apo agentë të tjerë organikë me veprim të sipërfaqshëm (kreu nr.33.00);

2. Për qëllimet e kreut nr.34.00 shprehja “sapun”, zbatohet vetëm për sapunin e tretshëm në ujë. Sapuni dhe produkte të tjera të kreut nr.34.00 mund të përmbajnë substanca shtesë (p.sh.desinfektantë, pluhura abrazivë, mbushës apo medikamente).

3. Për qëllimet e kreut nr.34.00 “agjentët organikë me veprim të sipërfaqshëm” janë produktet të cilat kur përzihen me ujë me koncentrim 0.5% në 20°C dhe e lënë për një orë në të njëjtën temperaturë.

a) japin një lëng transparent apo gjysëm të tejdukshëm apo një emulsion të qëndrueshëm pa ndarjen e lëndës së patretshme;

b) ulin tensionin sipërfaqësor të ujit në 4.5×10^{-2} N/m (45 dyn/cm) apo më pak.

4. Shprehja “vajrat petrolium dhe vajrat e fituara nga mineralet bituminoze”, zbatohet për produktet e përcaktuar në shënimin 2 të kapitullit 27.

5. Të nënshtruar ndaj përjashtimeve të dhëna më poshtë, shprehja “dyllet artificiale dhe dyllet e përgatitura” zabtohet vetëm për:

A. produktet organike të prodhuara kimikisht me karakter dylli, nëse janë apo jo të tretshme në ujë;

B) produktet e fituara nga përzierja e dylleve të ndryshme;

C) produktet me karakter dylli me bazë të dy apo më shymë dylleve dhe që përmbajnë dhjamë, rrëshirë, substanca minerale apo materiale të tjera;

Kreu nr.34.00 nuk zbatohet

a) dhjamrat e kafshëve apo vegjetalë si dhe fraksionet e tyre, tërësisht apo pjesërisht të hidroizoluara, interesterifikuara, riesterifikuara, nëse janë apo jo të rafinuara, monokarboksilikset industriale, acidet dhjamore dhe vajore nga rafinimi i alkooleve yndyrore industriale edhe në qoftë se kanë karakter dylli;

b) dyllet kafshore të papërziera apo dyllet e papërziera vegjetale, nëse janë apo jo të ngjyrosur të kreut nr.15.00;

c) dyllet minerale apo produkte të ngjashme me të kreut nr.27.00, nëse janë apo jo të përziera apo thjeshtë të ngjyrosur;

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
34.00	Sapuni, agjentët organikë me veprim të sipërfaqshëm, preparatet larës, preparatet lubrifikues, dyllet artificialë, dyllet e përgatitura, preparatet lustrosës apo pastrues, qirinjtë dhe artikuj të ngjashëm, pastat modeliste, dyllet dentarë me bazë allçie	10

KAPITULLI 35

SUBSTANCAT ALBUMINOIDALE; PRODUKTET ME BAZË AMIDONI OSE NISESHTETË E NDRYSHME; TUTKALLET DHE ENZIMAT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) majanë (kreu nr.21.00);

b) fraksionet e gjakut (përveç albuminës së gjakut jo të përgatitur për përdorim terapik apo profilaktik), medikamentet apo produkte të tjera të kapitullit 30;

c) përgatitjet enzimatike për pararegjie (kreu nr.32.00),

d) përgatitjet enzimatike larëse dhe produkte të tjera të kapitullit 34;

e) proteinat e ngurta (kreu nr.39.00);

f) produktet xhelatinoze të industrisë shtypshkronjave (kapitulli 490).

2.Termi “dekstrinat” ka kuptimin produktet degraduese të niseshtesë me një ulje në përmbajtjen e sheqerit, të shprehur si dektrozë me produktin e thatë, jo më tepër se 10%.

Të tilla produkte me një ulje në përmbajtjen e sheqerit me 10% futen brenda kapitullit 17.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
35.00	Substancat albuminoidale, produktet me bazë amidoni ose niseshtetë dhe ndryshme, tutkallet dhe enzimata	15

KAPITULLI 36
EKSPLOZIVËT; PRODUKTET; PIROTEKNIKË; SHKREPSET; ALIAZHET PIROFONIKE;
PËRGATITJET E CAKTUARA TË DJEGSHME

1.- Ky kapitull nuk përfshin përbërjet e caktuara kimikisht të ndashme përveç atyre të përshkruara në shënimin 2(a) apo (b) më poshtë:

2. Shprehja “artikuj me material të djegshëm: zbatohet vetëm për:

a) substancat metaldehide, heksametilenetetramine dhe substancat e tjera të ngjashme, vendosur në forma (p.sh.tableta, shkopinj apo forma të ngjashme) për përdorim si lëndë djegëse; lëndët djegëse me bazë alkooli dhe lëndët e tjera të ngjashme djegëse, të përgatitura në formë solide apo gjysmë solide;

b) lëndët djegëse lëng apo gaz-lëng në kontenerë të një lloji të përdorur për mbushje apo rimbushje të cigareve apo çakmakëve dhe të një kapaciteti jo më tepër se 300 cm³.

c) pishtarët me rrëshirë, ndezësit e zjarrit dhe të ngjashmet e tyre.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
36.00	Eksplzivët, produktet piroteknikë, shkrepset, aliazhet pirofonikë, përgatitjet e caktuara të djegshme	15

KAPITULLI 37
MALLRAT FOTOGRAFIKË DHE KINEMATOGRAFIKE

Shënime

1. Ky kapitull nuk përfshin materialet e mbetura apo të kthyera.

2. Në këtë kapitull fjala “fotografikë” lidhet me një proces, i cili lejon formimin e imagjinatës, të dukshme, direkt apo indirekt nga veprimi i dritës apo formave të tjera të rrezatimit mbi një sipërfaqe të ndjeshme.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
37.00	Mallrat fotografike dhe kinematografike	15

KAPITULLI 38
PRODUKTE TË NDRYSHME KIMIKE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) përbërjet e caktuara të ndashme kimikisht me përjashtimet e mëposhtme:

1) grafitet artificialë;

2. insekticidet, rodenticidet, fungicidet, herbicidet, produktet kundër rritjes dhe rregullatorët e rritjes së bimëve, disinfektantët dhe produktet e ngjashme, vendosur në forma apo paketa për shitjen me pakicë apo si përgatitje ose artikuj (p.sh.fitila, qirinj, shirita të trajtuara me sulfur);

3. produktet e vendosura si ngarkesë në “zjarrfikëset apo vendosur në granatat zjarrfikëse”.

4. produktet e specifikuar në shënimin 2a) apo 2c si më poshtë:

b) përzierjet e kimikateve me ushqime apo substanca të tjera me vlera ushqimore, të një lloji të përdorur në përgatitjet e ushqimeve njerëzore (në përgjithësi kreu nr.21.00).

c) medikamentet (kreu nr.30.00)

2. Kreu nr.38.00 përfshin mallrat e mëposhtme, të cilat nuk klasifikohen në asnjë kre tjetër të nomenklaturës;

a) kristalet e kultivuara (përveç elementëve optikë), që peshojnë jo më pak se 2.5 gram secila, të oksidit të magnezit apo të metaleve alkaline;

- b) vaji i avionit dhe vaji Dippel;
- c) thithësit e bojës vendosur në paketa për shitjen me pakicë;
- d) korrektoret prj letre dylli dhe fluidet e tjera korrektuese vendosur në paketa për shitjen me pakicë;
- e) testues qeramike të shkrirshëm për kontrollet e temperaturës së furrave (p.sh.konet Seger).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
38.00	Produkte të ndryshme kimike	15

SEKSIONI VIII

PLASTIKAT DHE ARTIKUJT PREJ TYRE; GOMA DHE ARTIKUJT PREJ SAJ

Shënim:

1. Mallrat e vendosura në një grup që konsistojnë në dy apo më shumë përbërës të ndashëm, disa apo të gjitha prej të cilëve futen në këtë seksion, dhe kanë qëllim të përzihen së bashku për të fituar një produkt të Seksionit VI apo VII do të klasifikohen në krerët e përshtatshëm për atë produkt, me kusht që përbërësit janë:

a) duke pasur parasysh mënyrën në të cilën ato janë ndërtuar të identifikueshme qartë përsa i përket qëllimit për t'u përdorur së bashku pa qenë paketuar më parë:

b) të paraqitur së bashku;

c) të identifikueshëm, si nga natyra e tyre apo nga raportet relative në të cilat ato janë paraqitur, përsa i përket qenies së tyre plotësues të njëri-tjetrit.

2. Përveç tapeteve plastike, nëse janë apo jo të vetëngjithshme, në role apo në formën e pllakave, mbuluesit plastikë të mureve të tavanit, siç është përcaktuar në shënimin 6 të kapitullit 39, fletat, letrat e varakut, shiritat rripat etj, dhe forma të tjera plastike, nëse janë apo jo në role, plastikat, goma dhe artikujt e tyre të shtypur me motive, karaktere apo përfaqësues të tjerë piktoralë, të cilët nuk janë thjesht të parëndësishme për përdorim primar të mallrave, futen brenda kapitullit 49.

KAPITULLI 39

PLASTIKAT DHE ARTIKUTJ PREJ TYRE

Shënime:

1. Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “plastika” ka kuptimin e atyre materialeve të kreut nr.39.00, të cilët janë apo kanë qenë të aftë, në momentin e polimerizimit apo në disa faza të mëvonshme për të marrë formë nën influencën e jashtme (zakonisht nxehtësia dhe presioni, nëqoftëse është e nevojshme një solvent) nga dhënia e formës, shtypja, derdhja, petëzimi, apo proces tjetër, të cilat janë bazuar në zhvendosjen e influencës së jashtme.

Gjatë gjithë nomenklaturës çdo referencë për “plastikat”, përfshin gjithashtu fibrat e vullkanizuara. Por shprehja nuk zbatohet për materialet që kanë të bëjnë me materialet tekstile të seksionit XI.

2. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) dyllet e kreut nr.27.00 apo 34.00);
- b) përbërjet organike të përcaktuar, kimikisht të ndashme (kapitulli 29);
- c) heparinë apo kripërat e saj (kreu nr.30.00);
- d) letrat e varakut të stampuara të kreut nr.32.00;
- e) agjentët organikë me veprim të sipërfaqshëm apo përgatitjet e kreut nr.34.00;
- f) gomat estere (kreu nr.38.00);
- g) gomat sintetike, të përcaktuar për qëllimet e kapitullit 40 apo artikujt prj tyre;
- h) takëmet e kalit apo valixhet, çantat dhe kontenierët e tjerë të kreut nr.42.00;
- i) thurrrjet, punët me xunkth apo artikujt të tjerë të kapitullit 46;
- k) mbuluesit e mureve të kreut nr.48.00;
- l) mallrat e seksionit XI (tekstilet);
- m) artikujt e seksionit XII (p.sh.veshjet e këmbëve, veshjet e kokës, çadrat, çadrat e diellit, bastunet, kamzhikët apo pjesët e tyre);
- n) imitacionet e bizhuterive të kreut nr.71.00;

o) artikujt e seksionit XVI (makineritë dhe pajisjet mekanike apo elektrike);
 p) pjesët e avionave apo mjeteve të transportit (seksioni XVII);
 q) artikujt e kapitullit 90 (p.sh.elementët optikë, instrumentet e pikturës);
 r) artikujt e kapitullit 91 (p.sh.kutitë e orëve);
 s) artikujt e kapitullit 92 (p.sh.instrumentet e muzikorë dhe pjesët e tyre);
 t) artikujt e kapitullit 94 (p.sh. mobileritë, llampat dhe pajisjet e dritës, parafabrikatet, shenjat ndriçuese);

u) artikujt e kapitullit 95 (p.sh.lodrat, pajisjet sportive);
 v) artikujt e kapitullit 96 (p.sh.furçat, butonat ,krehtrat, pikat e duhanit, kutitë e duhanit apo të ngjashmet e tyre, pjesët e enëve të laboratorit vacuum, lapsat, stilolapsat).

3. Për qëllimet e këtij kapitulli veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, kopolimerët (duke përfshirë ko-polikondesatët, produktet e ko-polishtesë), bllokun e polimerëve dhe kopolimerët e shartuara, dhe përzierjet e polimerëve do të klasifikohen në kreun që mbulon polimerët e atyre komonomerëve, të cilat predominojnë nga pesha, mbi çdo konometër tjetër të vetëm, konomerët, pollimerët e të cilëve futen në të njëjtën kre, duke pasur parasysh përbërjen e konomerëve të vetëm do të vlerësohen si të tilë.

Në qoftë se asnjë kometër i vetëm nuk predonminon kopolimerët apo përzierjet e polimerëve, siç mund të paraqitet rasti, do të klasifikohen në krerët, të cilat mund të jenë të fundit në rendin numerik, midis tyre që mertiojnë konsiderata të barabarta.

Shprehja “kopolimer” mbulon gjithë polimerët në të cilat asnjë polimer nuk kontribuon 95%, apo më shumë ndaj peshës në total në përmbajtjen e polimerit.

4. Polimerët kimikisht të ndryshueshme, që janë ato në të cilat vetëm shtesat e vargut të polimerit kryesor janë ndryshuar nga reaksionet kimike, do të klasifikohen në kreun më të përshtatshëm për polimerët e pandryshueshme. Ky përcaktim nuk zbatohet për kopolimeret e shartuara.

5. Shprehja “tuba”, pipa, zorra” ka kuptimin për produktet e zgavruara, gjysëm-produkt apo produkt i gatshëm, të një lloji të përdorur në përgjithësi për transportimin, drejtimin apo shpërndarjen e gazit apo lëngut, p.sh.zorrë baceje e vijëzuar, tuba të përforcuara. Kjo shprehje përfshin gjithashtu mbajtësit e sallamit dhe tuba të tjerë. Por, përveç mallrave të sapopërmendura, ato që kanë një seksion kryq të brendshëm ndryshe nga të rrumbullakët, ovale apo kënddrejtë (në të cilën gjatësia nk e kalon një e gjysëm herë gjerësinë apo në formën e një shumëkëndëshi të rregullt, nuk do të merren si pipa, tuba apo zorrë, por si forma profil.

6. Shprehja “mbulesa plastike të mureve apo tavanit”, zbatohet për produktet në role, të një gjerësie, jo më pak se 45 cm, të përshtatshme për zbukurime muri apo tavani, duke konsistuar në plastikën e përhershme, mbrapa çdo materiali përveç letrës, shtresës së plastikës (mbi anën e përparme), duke qenë i kokërrzuar, i zbukuruar, i ngjyrosur apo i zbukuruar ndryshe.

7. Shprehja “fleta, pllaka, rripa etj” zbatohet për mallrat (përveç atyre të kapitullit 54) dhe për blloqet me një formë të rregullt gjeometrike, nëse janë apo jo të shtypur apo të punuar ndryshe në sipërfaqe të paprera apo të prera në kënd të drejtë (duke përfshirë katrorët), por jo më tej të punuara (edhe nëqoftëse kur priten kështu ato bëhen artikuj të gatshëm për përdorim).

Kr eu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
39 .00	Plastikat dhe artikujt prej tyre	15

KAPITULLI 40 GOMAT DHE ARTIKUJ TË PREJ TYRE

Shënime:

1. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “gomë” ka kuptimin e produkteve të mëposhtme nëse janë apo jo të vullkanizaura apo të forta; gomë natyrale dhe gomat e tjera të ngjashme natyrale, gomë sintetike, të rrjedhura faktikisht nga nafta dhe substanca të tilla të riaftësuar.

2. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) mallrat e seksionit XI (tekstilet dhe artikujt tekstile);
- b) veshjet e këmbëve apo pjesët e tyre të kapitullit 64;

- c) veshjet e kokës apo pjesët e tyre (duke përfshirë kapuçët e banjës) të kapitullit 65;
- d) pajisjet mekanike apo elektrike apo pjesët e tyre të seksionit XVI (duke përfshirë mallrat elektrike të të gjitha llojeve prej gome të fortë);
- e) artikujt e kapitullit 90, 92, 94 apo 96;
- f) artikujt e kapitullit 95 (përveç dorezave të sportit).

3. Në shënimin I të këtij kapitulli shprehja “gomë sintetike” zbatohet për:

a) substancat sintetike të pasaturuara, të cilat mund të transformohen në mënyrë të pakthyeshme nga vullkanizimi me squfur në substanca jo-termoplastike, të cilat në temperaturën midis 18 dhe 29°C, nuk thyhen po të zgjerohen 3 herë në gjatësi dhe rikthehen pas zgjerimit 2 herë në gjatësi, brenda një kohe prej 5 minutash, në gjatësinë jo më të madhe se 1.5 herë të gjatësisë normale.

Për qëllimet e këtij teksti, substancat e nevojshme për lidhjen kryq, të tilla si përsheptuesit apo vepruesit e vullkanizuar, mund të shtohen; prania e substancave të tilla është e lejueshme, por prania e substancave jo të nevojshme, për kryq-lidhjen, të tilla si zgjerues, mbushës, nuk është e lejueshme;

b) tioplast TM; dhe

c) gomë natyrale e modifikuar nga shartimi apo përzierja me gomë plastike natyrale të depolimerizuar. Përzierjet e substancave sintetike të pasaturuara, me polimerët e larta sintetike të saturuara, me kusht që të gjitha produktet e sipërpërmendura, plotësohen me kërkesat lidhur me vullkanizimin, zgjatjen dhe kthimin si në pikën (a) më lart.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
40.00	Gomat dhe artikujt prej tyre	15

SEKSIONI VIII

LËKURAT SI LËNDË E PARË, LËKURAT E PËRPUNUARA, GËZOFËT DHE ARTIKUJT E TYRE; TAKËMET E KALIT, SAMARËT; MALLRAT E UDHËTIMIT, ÇANTA DORE DHE KONTENIERË TË NGJASHËM; ARTIKUJ PREJ ZORRËVE TË KAFSHËVE (PËRVEÇ TË BRENDSHMËVE TË KRIMBIT TË MËNDAFSHIT)

KAPITULLI 41

LËKURËT SI LËNDË E PARË (PËRVEÇ GËZOFIT DHE LËKURËT E PËRPUNUARA)

Shënim:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) lëkurët e qëruara apo mbeturinat e ktheyra të lëkurës si lëndë e parë (kreu nr.05.00);
- b) lëkurët e zogjve apo pjesët e tyre, së bashku me puplat e tyre, të kreut nr.05.00 apo 67.00;
- c) lëkurët me flokët apo leshin, të përpunuara ose të regjura apo bruto (kapitulli 43); por, artikujt e mëposhtëm, do të klasifikohen në kapitullin 41, të quajtur, lëkurët si lëndë e parë me flokët apo leshin e lopëve (duke përfshirë buallin), të kuajve, deleve apo shelegëve (përveç Astrakhan, Caracul, Persian apo delet e ngjashme indian, Chinezë, Mongolian apo Tibetan), të dhive dhe të kecav (përveç kecave Yemen, Mongolian apo Tibetan), të derrave (duke përfshirë derrin e egër, të antilopës, të gazelës, të drerit polar, të drerit të kaprollit apo të qenit.

2. Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “lëkurë e ripunuar” ka kuptimin vetëm lëkura me bazë lëkure apo fibra lëkure, në fleta, shirita, pllaka, nëse janë apo jo në role.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
41.00	Lëkurat si lëndë e parë (përveç gëzofit) dhe lëkurat e përpunuara	5

KAPITULLI 42

ARTIKUJT PREJ LËKURE, SAMARËT DHE TAKËMET E KALIT, MALLRAT E UDHËTIMIT, ÇANTA DORE DHE KONTENIERËT E NGJASHËM, ARTIKUJT PREJ ZORRËVE TË KAFSHËVE (PËRVEÇ TË BRENDSHMËVE TË KRIMBIT TË MËNDAFSHIT)

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) Kordat sterile kirurgjikale apo materialet e tjera qepëse sterile (kreu nr.30.00)
- b) artikujt e veshjes dhe veshje ndihmëse (përveç dorezave mbuluar me gëzof apo qime artificiale apo në të cilat qimet artificiale janë të lidhura në anën e jashtme thjesht si zbukurim (kreu nr.43.00);
- c) artikujt të bërë nga rrjetat (kreu nr.56.00);
- d) artikujt e kapitullit 64;
- e) veshjet e kokës dhe pjesët e tyre të kapitullit 65;
- f) bastunet, kamzhiqet, dorezat e tyre etj, (kreu nr.66.00);
- f) lidhëset e manshetave, byzylyqet dhe imtacione të tjera të bizhuterive (kreu nr.71.00);
- h) pajimet apo zbukurimet për takëmet e kalit, të tilla si yzengji gojëza e kalit, togëzat etj, të paraqitura veç e veç (në përgjithësi seksioni XV);
- f) spangot, lëkurat për daullet apo të ngjashmet e saj, apo pjesët e tjera të instrumenteve muzikore (kreu nr.92.00);
- k) artikujt e kapitullit 94 (p.sh.mobiljet, llampat dhe pajisjet e dritës);
- j) artikujt e kapitullit 95 (p.sh.lodrat, artikujt sportive);
- m) butonat, mbërthyesat, togëzat, format e kopsave dhe pjesë të tjera të këtyre artikujve, vrimat e butonave të kreut nr.96.00.
2. Në shtesë të përcaktimeve të shënimit I më lart, kreu nr.42.00 nuk përfshin:
- a) çantat e bëra me fletë plastike, të shtypura apo jo, me doreza të papërcaktuara për përdorime të gjata (kreu nr.39.00);
- b) artikuj prej materialeve gërshetues, (kreu nr.46.00);
- c) artikujt e metaleve të çmuar, e metaleve të veshur me metale të çmuar, të perlave të përpunuara apo të gurëve të çmuar apo gjysëm të çmuar (natyrale, sintetike apo të rindërtuar), (kreu,nr.71.00);
3. Për qëllimet e kreut nr.42.00 shprehja “artikuj të veshjeve dhe veshje dytësore” ka zbatim ndër të tjera për dorezat (duke përfshirë dorezat e sportit), përparëset dhe rrobat e tjera mbrojtëse, rripat, tirantat, gjerdanët dhe rripat e kyçit (dorës) por përjashtohen rripat e orës (kreu nr.91.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
42.00	Artikujt prej lëkure, samarët dhe takëmet e kalit, mallrat e udhëtimit, çanta dore dhe kontenierët e ngjashëm, artikujt prej zorrëve të kafshëve (përveç të brendshmëve të krimbit të mëndafshit)	30

KAPITULLI 43 GËZOFËT DHE QIMET ARTIFICIALE; PRODHIMET PREJ TYRE

Shënime:

- 1.Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “gëzofë” përveç gëzofit të papërpunuar të kreut nr.43.00 zbatohet për lëkurët e të gjitha kafshëve që janë të veshur me flokë apo qime mbi të:
2. Ky kapitull nuk përfshin:
- a) lëkurat e zogjve apo pjesët e tyre, bashkë me puplat (kreu nr.05.00 apo 67.00);
- b) lëkurat e papërpunuara, e flokë, mbi to, të kapitullit 41 (shiko shëpnimin I(c) të këtij kapitulli);
- c) doreza që konsistojnë në lëkurë dhe gëzof, apo në lëkurë me qime artificiale (kreu nr.42.00);
- d) artikujt e kapitullit 64;
- e) veshjet e kokës apo pjesët e tyre të kapitullit 65;
- f) artikujt e kapitullit 95 (p.sh. lodrat, pajisjet sportive).
3. Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “qime artificiale” ka kuptimin çdo imitacion i gëzofit që konsiston në leshin, flokët apo fibra të tjera ngjitur apo qepur mbi lëkurë, thurjet apo materialet e tjera, por nuk përfshin imitacionet e gëzofit fituar nga thurja apo dredhja (në përgjithëse kreu nr.58.00 apo 60.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
----------	------------	---------------------

43.00	Gëzofët dhe qimet artificiale; prodhimet prej tyre	30
-------	--	----

SEKSIONI IX

DRURI DHE ARTIKUJT PREJ DRURI; QYMYRI I DRURIT; TAPA DHE ARTIKUJT PREJ TAPE; PRODHIMET PREJ KASHTË DHE MATERIALE TË TJERA GËRSHETUESE. PRODHIMI I SHPORTAVE DHE PUNËT E THURURA ME KALLAMA APO THUPRA

KAPITULLI 44

DRURI DHE ARTIKUJT PREJ DRURI; QYMYRI I DRURIT

Shënime:

1.Ky kapitull nuk përfshin:

a) drurin në ashkla të shtypur, bluar apo pudëruar, të një lloji të përdorur filimisht në parfumeri, farmaci apo qëllime insekticidale, funicidale apo të ngjashme me to (kreu nr.12.00);

b) bambun apo materiale të tjera gërshetuese (kreu nr.14.00);

c) drurin në ashkla të shtypur, bluar apo pudëruar të një lloji të përdorur në lyerje apo rregjie (kreu nr.14.00);

d) qymyri i drurit i aktivizuar (kreu nr.38.00);

e) baulet, valixhet, kutitë e tualetit, çantat e shkollës, kutitë e dylbive, kutitë e kamerave, kutitë e instrumenteve muzikore, kutitë e armëve si dhe kontenierët e ngjashëm; çanta udhëtimi, çanta tualeti, çanta shpine, çanta dore, çanta pazari, kuti hartash, kuletat, kutitë e cigareve, kutitë e duhanit, çantat e veglave, çanta sporti, kuti bizhuterish, kuti pudre, kutitë e takëmeve të ngrënies, si dhe kontenierët e ngjashëm, prej lëkure apo prej lëkure të riprodhuar, prej fletëve plastike, material tekstili, prej librave të vullkanizuar apo prej letre apo prej kartoni; tërësisht apo pjesërisht mbuluar me materiale të tillë (kreu nr.42.00);

f) artikujt e kapitullit 46.00

g) veshjet e këmbëve apo pjesët e tyre (kapitulli 64);

h) mallrat e kapitullit 66 (p.sh.çadra dhe bastune, si dhe pjesët e tyre);

i) panelet, dërrasat, pallakat, blloqet dhe artikuj të ngjashëm të fibrave vegjetale, prej kashte, tallashi, pluhurit të sharrës apo mbeturinave të tjera të drurit, të aglumeruara me çemente, allçi apo lidhëza të tjera mineralë (kreu nr.68.00);

k) imitacionet e bizhuterive (kreu nr.71.00);

l) mallrat e seksionit XVI dhe XVII (p.sh. pjesët e makinerive, kutitë, mbuluesit, dollapët për makineritë dhe aparatet si dhe magazinat.

m) mallrat e seksionit XVIII (p.sh.kutitë e orave dhe të instrumenteve muzikore dhe pjesët e tyre);

n) pjesët e armëve të zjarrit (kreu nr.93.00);

o) artikujt e kapitullit 94 (p.sh.mobileritë, llambat dhe pajisjet e dritës, parafabrikatet);

p) artikujt e kapitullit 96 (p.sh. lodrat dhe pajisjet sportive);

q) artikujt e kapitullit 96 (p.sh. pipat e duhanit dhe pjesët e tyre. Butonat, lapsat përjashtojnë drurin e trupit dhe dorezave të artikujve të kreut nr.96.00;

r) artikujt e kapitullit 97 (p.sh.veprat e artit).

2. Në këtë kapitull shprehja “dru i densifikuar” ka kuptimin e drurit, i cili i është nënshtruar trajtimeve kimike apo fizike (duke qënë një trajtim më tepër se ç’është e nevojshme për të siguruar një lidhje të mirë, në rastin e shtresave të lidhura së bashku) dhe në lidhje me të cilin kërkohet një rritje e densitetit apo të fortësisë, së bashku me përmirësimin e fortësisë mekanike apo rezistencës ndaj veprimtimit kimik apo elektrik.

3.Kreu nr.44.00 nuk zbatohet për veglat e punës, në të cilat tehu, ana e penës, sipërfaqja e punës apo pjesë të tjera të punës, janë formuar nga çdo material i specifikuar në shënimin I të kapitullit 82;

4. Për qëllimet e këtij kapitulli dhe i nënshtruar ndaj shënimit I (b) dhe I (f) më lart, çdo referencë për “drurin” zbatohet gjithashtu për bambunë dhe materiale të tjera me natyrë drusore.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
44.00	Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit	5

KAPITULLI 45
TAPA DHE ARTIKUJT PREJ TYRE

Shënim:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) veshjet e këmbëve dhe pjesët e tyre të kapitullit 64;
- b) veshjet e kokës dhe pjesët e tyre të kapitullit 65;
- c) artikujt e kapitullit 95 (p.sh. lodrat dhe artikujt sportive).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
45.00	Tapa dhe artikujt prej tape	5

KAPITULLI 46
PRODHIMET E KASHTËS DHE MATERIALEVE TË TJERA GËRSHETUESE PRODHIMI I SHPORTAVE DHE PUNËVE TË TJERA PREJ XUNKTHI

Shënime:

1. Në këtë kapitull shprehja “materiale gërshetuese”, ka kuptimin materiale në një gjendje apo formë të përshtatshme për gërshetim, thurrje apo procese të ngjashme duke përfshirë kashtën, shëlgun apo thuprat e shëlgut, bambunë, kallamt, xunkthin, shiritat e drurit, shiritat e materialeve të tjera vegjetale (p.sh. gjethet e ngushta apo shiritat të prerë nga gjethet e gjëra) apo fibra tekstile natyrore të padredhura apo lëkura monofilamentet dhe shiritat plastikë, apo shiritat e letrës, por jo shiritat e lëkurës apo të flokëve të rënë e të padredhura të njerëzve të kuajve të fijeve tekstile ose të monofilamenteve dhe shiritave të tjerë të kapitullit 54.

2. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) mbuluesit e mureve të kreut nr.48.00;
- b) litarët, spangot, kordat të gërshetuara apo jo (kreu nr.56.00);
- c) veshjet e këmbëve dhe të kokës apo pjesët e tyre të kapitullit 64 apo 65;
- d) mjetet e transportit apo pjesët e tyre prej kashte apo ndonjë materiali tjetër gërshetues (kapitulli 87);
- e) artikujt e kapitullit 94 (mobili, pajisjet e dritës).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
46.00	Prodhimet e kashtës dhe materialeve të tjera gërshetuese, prodhimi i shportave dhe punëve të tjera prej xunkthi	30

SEKSIONI X
BRUMI I DRURIT APO I MATERIALEVE TË TJERA FIBROZE CELULOZIKË; KTHIMET DHE MBETURINAT E LETRËS APO TË KARTONIT; LETRAT DHE ARTIKUJT PREJ TYRE

KAPITULLI 47
BRUMI I DRURIT APO I MATERIALEVE TË TJERA FIBROZE CELULOZIKE. KTHIMET DHE MBETURINAT E LETRËS DHE TË KARTONIT

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
47.00	Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze celulozike, kthimet dhe mbeturinat e letrës dhe të kartonit	5

KAPITULLI 48
LETRA DHE KARTONI; ARTIKUJT E BRUMIT TË LETRËS, TË LETRËS APO TË KARTONIT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) artikujt e kapitullit 30;

b) letrat e varakut të stampimit (kreu nr.32.00);

c) letrat e parfumuara apo letrat e mbushura apo të veshur me kozmetikë (kapitull 33);

d) letra apo celuloza e mbushur veshur apo mbuluar ne sapunë detrergjentë apo me llustrosës, kremra apo përgatitje të ngjashme (kreu nr.34.00);

e) letra apo kartoni të ndjeshëm ndaj dritës (kreu nr.37.00);

f) fletat plastike të letër-përforcuara apo shtresa të letrës apo të kartonit veshur apo mbuluar me një shtresë plastike, e fundit përbën më shumë se gjysmën e totalit të trashësisë apo artikujt e materialeve të tillë, përveç mbuluesve të murit të kreut; nr.48.00 (kapitullit 39);

g) baulet, valixhet, kutitë e tualetit, çantat e shkollës, kutitë e dylbive, kutitë e kamerave, kutitë e instrumenteve muzikore, kutitë e armëve si dhe kontenierë të ngjashëm, çanta udhëtimi, çanta tualeti, çanta shpine, çanta dore, çanta pazari, kuti hartash, kultat, kutitë e cigareve, kutitë e duhanit, çantat e veglave, çanta sporti, kuti bizhuterish, kuti puder, kuti të takëmeve të ngrënies si dhe kontenierët e ngjashëm, prej lëkure apo prej lëkure të përbërë prej fletëve plastike, material tekstili prej fibrave të vullkanizuara apo prej letre tërësisht apo pjesërisht mbuluar me materiale të tillë (kreu nr.42.00);

h) artikujt e kapitullit 46 (prodhimet e materialeve gërshetuese);

i) fije letre apo artikuj tekstile me fill letre (seksioni XI);

k) artikujt e kapitullit 64 apo 65;

l) letra apo kartoni abrazivë (kreu nr.68.00) ose letra apo mikë veshur me karton (kreu nr.68.00) (letra apo kartoni mbuluar me pluhur mike do të klasifikohet megjithatë në këtë kapitull);

m) letrat e varakut metalike veshur me letër apo karton (Seksioni XV);

n) plotësuesit (p.sh. letrat, disqet dhe roletë për instrumentet mekanikë) të instrumenteve muzikore (kreu nr.92.00);

o) artikujt e kapitullit 95 (lodrat pajisjet sportive) apo të kapitullit 96 (p.sh. butonat);

2. Për qëllimet e kreut nr.48.00 shprehja "letra muri dhe mbulues muri të ngjashëm: zbatohet vetëm për:

a) letrat në role, të një gjerësie jo më pak se 45 cm dhe më shumë se 160 cm të përshtatshme për zbukurime muri apo tavan;

(i) e kokërzuar, e stamposur, lyer, pikturuar, apo zbukuruar ndryshe (p.sh. me push tekstili) nëse janë apo jo të veshura apo të mbuluara me plastikë mbrojtëse transparente).

(ii) me një sipërfaqe jo të rrafshët që del nga bashkim i drurit, kashtës etj);

(iii) veshur apo mbuluar në anën e përparme me plastikë shtresë plastike të kokërzuar, stamposur, ngjyrosur, pikturuar apo zbukuruar ndryshe;

(iv) mbuluar në anën e përparme me materiale thurëse, nëse janë lidhur apo jo së bashku me thurje paralele;

b) bordurat dhe zbukurimet në pjesë pjesën e murit, menjëherë pas tavanit prej letre, trajtuar si më lart, nëse janë apo jo në role, të përshtatshme për zbukurime muri apo tavani;

c) mbuluesit prej letre të mureve bërë nga panele tëndryshme, në role apo në fleta, të prerë në formë të tillë që të formojnë një pamje apo motiv kur vihet në mur.

3. Letra kartoni dhe artikujt e tyre të shtypur me motive, karaktere apo përfaqësues piktorialë, të cilat nuk janë të parëndësishme në përdorimin e mallrave futen brenda kapitullit 49.

Kr eu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
48 .00	Letra dhe kartoni. Artikujt e letrës; të letrës apo të kartonit	5

KAPITULLI 49

LIBRAT, REVISTAT, FOTOGRAFITË DHE PRODUKTE TË TJERA TË INDUSTRIËSË SË
SHTYPIT; DORËSHKRIMET, SHTYPSHKRIMET DHE PROJEKTET

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) pozitivët apo negativët fotografikë me bazë transparente (kapitulli 37);
- b) hartat, projektet apo globet në reliev, të shtypur apo jo (kreu nr.90.00);
- c) letrat e bixhozit apo mallra të tjera të kapitullit 95;
- d) gdhendjet, shtypshkrinmet apo litografitë origjinale, pullat postare, vulat postare si dhe mjetet e tjera postare dhe të ngjashme me to, antikat e një moshe më tepër se 100 vjeçare apo artikuj të tjerë të kapitullit 97.

2. Për qëllimet e kapitullit 49, termi “shtyp” gjithashtu ka kuptimin e riprodhimeve të bëra nga një makinë krijuese kopjesh, prodhuar nga kompjuterat që e fotografojnë, stampojnë, fotokopjojnë apo e shtypin.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
49.00	Librat, revistat, fotografitë dhe produkte të tjera të industrisë së shtypit, dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet	5

SEKSIONI XI TEKSTILET DHE ARTIKUJT TEKSTILË

Shënime:

1. Ky seksion nuk përfshin:
 - a) qimet apo krifat e kafshëve për bërjen e furçave, qimet e kalit apo mbeturinat e tij (kreu nr.05.00);
 - b) flokët e njerëzve apo artikujt e tyre (kreu nr.05.00) apo (kreu nr.67.00, përveç kulluesve të një lloji të përdorur zakonisht në shtypjen e vajit apo të artikujve të ngjashëm (kreu nr.59.00);
 - c) push pambuku apo materialet e tjera vegjetale të kapitullit 14;
 - d) asbesti i kreut nr.25.00 apo artikujt e asbestit me bazë asbesti dhe karbonati magnezi, me bazë substancash të tjera, minerale apo celuloze, nëse janë apo jo të kombinuar me tekstile apo materiale të tjera (kreu nr.68.00);
 - e) artikujt e kreut nr.50.00 (p.sh. garza fasho dhe artikuj të ngjashëm për qëllime mjekësore, kirurgjikale, detnare apo veterinarë, materiale sterile kirurgjikale për lidhjen e plagëve);
 - f) tekstilet e ndjeshme ndaj dritës të kreut nr.37.00;
 - g) monofilamentet, çdo dimension kryq e të cilave i kalon 1 mm apo rripat apo artikj të ngjashëm me to (për shembull kashta artificiale) me një gjerësi të jashtme më tepër se 5 mm prej plastike (kapitulli 39) apothurje dhe punë të tjera xunkthi të monofilamenteve apo rripave të tillë (kapitulli 46);
 - h) mallrat e thurura apo kroshe të ngarkuara, mbuluar veshur apo ndërthurur me plastikë apo artikuj prej tyre të kapitullit 39;
 - j) mallrat e thurura apo kroshe, të ngarkuara, mbuluara apo ndërthurur me gomë si dhe artikujt prej tij të kapitullit 40;
 - k) lëkurat me qime apo flokë mbi to (kapitulli 41 apo 43) apo artikujt e gëzofit artificial apo artikuj prej tyre, të kreut nr.43.00.
 - l) takëmet dhe samarët e çdo kafshe (përfshirë thundrat, rripat e qenit, shalë kali, gojëzat etj). Baulet, valixhet, kutitë e tualetit, çantat e shkollës, kuti dylbish, kuti kamerash, kuti veglash muzikore, kuti armësh si dhe kontenierët e ngjashëm, çanta udhëtimi, çanta tualeti, çanta dore, çanta pazari, kuti duhani dhe cigaresh, kuti bizhuterish, kuti pudre si dhe kontenierët e ngjashëm, kutitë dhe çantat e sportit apo të veglave të punës bërë me material tekstil (kreu nr.42.00);
 - m) produktet e kapitullit 48;
 - n) veshjet e këmbëve apo pjesët e tyre, dollaku apo gjunjakët si dhe artikuj të ngjashëm të kapitullit 64;
 - o) rrjetat e flokëve apo veshje të tjera për kokën e kapitullit 65;
 - p) mallrat e kapitullit 67;
 - q) materialet tekstile të veshura me abraziv dhe gjithashtu fibrat e karbonit apo artikujt e tij (kreu nr.68.00);
 - r) fibrat e xhamit apo artikujt prej tyre, përveç qëndisjeve me fije xhami në pjesën e dukshme

të produktit (kapitulli 70);

s) artikujt e kapitullit 94 (për shembull, mobileritë, pajisjet e krevateve apo pajisjet e dritës);

t) artikujt e kapitullit 95 (për shembull lodrat, rrjeta dhe pajisjet e sportit);

2. (A) Mallrat që klasifikohen në kapitullin 50 deri 55 dhe mallrat e përziera me dy apo më shumë materiale tekstile, do të klasifikohen sikur ato përbëhen tërësisht nga ai material tekstili që predominon me peshë, sipër çdo materiali tjetër të vetëm tekstili;

B) Për qllimet e rregullit të mësipërm:

a) fijet e flokëve të kalit (kreu nr.51.00) dhe fijet e metalizuara (kreu nr.56.00) do të trajtohen si materiale të vetme tekstili, pesha e të cilit do të merret si agregat i peshës së çdo komponenti për klasifikimin e produkteve të thurura, fijet metalike do të merren si material tekstili;

b) zgjedhja e kreut të përshtatshëm do të ndikohet nga vendosja në fillim të kapitullit dhe pastaj të krerëve të përfshira brenda atij kapitulli, duke mos marrë parasysh çdo material që nuk përfshihet në atë kapitull;

c) kur të dy kapitujt 54 dhe 55 do të bashkohen me çdo kapitull tjetër, kapitulli 54 dhe 55 do të trajtohen si një kapitull i vetëm;

d) kur një kapitull apo një kre i referohet mallarave me materiale të ndryshme tekstili, të tilla materiale do të trajtohen si të përbëra nga një material;

C) përcaktimet e paragrafit (A) dhe (B) më lart zbatohen gjithashtu për fijet e referuara në shënimin 3 më poshtë:

3. (A) Për qëllimet e këtij Seksioni dhe i nënshtruar me përjashtimet e paragrafit (B) më poshtë, fijet (të vetme të shumëfishuara apo litar) e përshkrimeve të mëposhtme do të trajtohen si “spango apo litar”;

a) prej mëndafshi apo mbeturina të tij, me masë më shumë se 20 000 decitex.

b) prej fibrave të bëra me dorë (përfshirë fijet e dy apo më shumë monofilametneve të kapitullit 54) me masë më shumë se 10 000 decitex;

c) prej kërpi apo liri të vërtetë;

(i) i palëmuar apo i pazmaltuar me masë më shumë se 20 000 decitex;

(ii) I lëmuar apo i zmaltuar më shumë se 1429 decitex apo më shumë;

d) prej fibrave të guackës së arrës së kokosit;

e) prej fibrave të tjera vegjetale me masë më shumë se 20 000 decitex;

f) fijet e përforcuara me metal.

(B) Përjashtime:

a) fijet e leshit apo flokëve të tjera të kafshëve dhe fijet prej letre, përveç fijeve të përforcuara me metal;

b) kabllot prej filamenti të kapitullit 55 dhe fijet me shumë filamente pa dredhje apo me dredhje më pak se 5 rrotullime për metër të kapitullit 54;

c) zorrët e krimbit të mëndafshit të kreut nr.55.00 dhe monofilamentet e kapitullit 54;

d) fijet e metalizuara të kreut nr.56.00, fijet e përforcuara me fije metal, i është nënshtruar paragrafit (A) (f) më lart;

e) kordat zbukuruese, nyjet apo larjet e kreut nr.56.00.

4. për qëllimet e këtij seksioni shprehja “ndërtuar” ka kuptimin:

a) e prerë ndryshe përveç katrore apo këndrejtë;

b) prodhuar në gjendje të përfunduar, gati për përdorim, pa nevojën e qepjes apo punëve të tjera (p.sh. peshqirët, mbulesat e tavolinës, çarçafët, batanijet);

c) me buzë të palosura apo të rrumbullakosura apo me thekë të lidhur me anët e prea të të cilëve janë hequr nga koklavitjet prej goditjeve apo mjeteve të tjera;

d) prerë në masa dhe kanë kaluar procsin e tërheqjes së fillit;

e) bashkuar nga qepja, ngjitja apo ndryshe (përveç mallrave në copa që përbëhen na dy apo më shumë gjatësi nga materiale identike bashkuar fund më fund, dhe mallrat në copa, të përbëra nga dy apo më shumë tekstile të bashuara në shtresa, nëse janë apo jo të mbushura);

f) thurur apo punuar me grep për t’i dhënë formë, paraqitur në formën e numrit të artikujve në gjatësi.

5. Kapitulli 50 deri 55 dhe veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, kapitulli 56 deri 60, nuk zbatohet për mallrat e ndërtuara sipas shënimit 4 më lart. Kapitulli 50 deri 55 nuk zbatohet për mallrat e kapitullit 56 deri 59.

6. Pëlhurat e thurura të kapitullit 50 deri 55 përfshijnë pëlhurat që përbëhen nga shtresa të fijeve tekstile paralele mbivendosur mbi njëra-tjetrën me kënd të drejtë. Këto shtresa janë lidhur me një kryqëzim të fijeve, nga një lëndë ngjitëse apo nga një lidhës termik.

7. Produktet elastike që konsistojnë në materiale tekstile të kombinuara, me fije gome, do të klasifikohen në këtë seksion.

8. Për qëllimet e këtij seksioni shprehja “e ngopur” përfshin “e zhytur”.

9. Për qëllimet e këtij seksioni shprehja “poliamide” përfshih aramidet”.

KAPITULLI 50 MËNDAFSHI

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
50.00	Mëndafshi	5

KAPITULLI 51 LESHI; QIMET E KAFSHËVE TË HOLLA APO TË TRSHA; FIJET E FLOKËVE TË KALIT DHE PËLHURAT E THURURA

Shënime:

1. Gjatë gjithë nomenklaturës:

a) “lesh” ka kuptimin e fibrave natyrore të rritur në delet apo qingjat;

b) qime të holla kafshësh ka kuptimin e qimeve të deles së Perusë (aplaca), vikunës, devesë, demit të Azisë Qendrore, dhive Angora, Tibetan, Kashmi apo të ngjashmet e tyre (por jo dhia e zakonshme), lepurit (duke përfshirë lepurin Angora) kastorin;

c) “qime të trasha kafshësh” ka kuptimin e qimeve të kafshëve të përmendur më lart, përjashtoj qimet për bërjen e furçave dhe flokët e kalit (kreu nr.05.00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
51.00	Leshi, qimet e kafshëve të holla apo të trasha; fijet prej flokëve të kalit dhe pëlhurat e thurura	5

KAPITULLI 52 PAMBUKU

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
52.00	Pambuku	5

KAPITULLI 53 FIBRA TEKSTILE TË TJERA NË ORIGJINË VEGJETALE; FIJET PREJ LETRE DHE PËLHURAT E THURURA TË TYRE

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
53.00	Fibra tekstile të tjera me origjinë vegjetale, fijet prej letre dhe pëlhurat e thurura të tyre	5

KAPITULLI 54 FILAMENTET E BËRA NGA NJERËZIT

Shënim:

1. Gjatë gjithë nomenklaturës termi “fibra të bëra nga njerëzit” ka kuptimin fibrat dhe filamentet kryesore të polimerëve organikë të prodhuar nga proceset e prodhimit apo:

a) nga polimerizimi i monomerëve organikë, të tilla si poliamidë, poliestere, poliuretane apo derivatat e polivinilit;

b) nga transformimet kimike të polimerëve organikë natyralë (p.sh.celulozë, kazeinë, proteinë

apo alga), të tilla si shtap vizkoz, acetat me celulozë.

Termi “sintetike” dhe “artificiale” përdorur në lidhje me fibrat ka kuptimin sintetike për fibrat e përcaktuar në shkronjën (a); artificiale për fibrat e përcaktuar në shkronjën (a).

Tarifat “e bëra nga njerëzit”, “sintetike” dhe “artificiale” do të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në lidhje me materialet tekstile.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
54.00	Filamentet e bëra nga njerëzit	5

KAPITULLI 55 FIBRAT KRYESORE TË BËRA NGA NJERËZIT

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
55.00	Fibrat kryesore të bëra nga njerëzit	5

KAPITULLI 56 VATINA LSHI I PRESUAR DHE PËLHURA TË TJERA TË PATHURURA; FIJET SPECIALE; LITARËT, SPANGOT, KABLOT DHE ARTIKUJT PREJ TYRE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) vatinat, leshin e presuar apo pëlhurat e pathurura, të ngopura, të veshura me substanca apo preparate (p.sh. parfumet për kozmetikë të kapitullit 33, sapunë apo detergjentë, lustrosës, kremra apo përgatitje të ngjashme, kreu nr.34.00, pëlhura të zbutura, kreu nr.38.00, ku materiali i tekstit paraqitet thjesht si mjet mbrojtës;

b) produktet tekstile të mbushura me copa, të përbëra nga një apo më shumë shtresa, me tekstile të bashkuar me mbushje, nga qepja apo ndryshe, përveç qëndismave në copa, shirita apo motive (kreu nr.58.00);

c) pëlhurin nga kokrrizat natyrale apo me abrazoiv artificial, prapa vatinave, leshit të presuar apo pëlhurave të pathurura (kreu nr.68.00);

d) mika të aglomeruara apo të riformuara, prapa vatinave, leshit të presuar apo pëlhurave të pathurura (kreu nr.68.00);

e) krisaf metalike prapa vatinave, leshit të presuar apo pëlhurave të pathurura (Seksioni XV);

2. Termi “lesh i presuar” përfshin pëlhurat apo leshin e presuar të bëra në tezgjah, që përbëhet nga një rrjetë e fibrave tekstile, kohezioni i së cilës ka rrjedhur nga një proces i qepjes duke përdorur fibra nga vetë rrjeta.

3. Kreu nr.56.00 mbulon ndër të tjera edhe leshin e presuar apo mbuluar dhe pëlhurat e pathurura, të ngopura, veshur apo mbuluar me plastikë apo gomë, çfarëdo qoftë natyra e këtyre materialeve (kompakte apo celularë).

Kreu nr.56.00 gjithashtu përfshin pëlhurat e pathurura në të cilën plastika apo goma formon substancën lidhëse,

Por, kreu nr.56.00 nuk përfshin:

a) leshin e presuar të ngopur, veshur, mbuluar apo ndërthurur, me plastikë apo gomë, që përbëjnë 50% apo më pak ndaj peshës së materailit tekstil, apo leshin e presuar komplet i ngulur në plastikë apo gomë (kapitull 39 apo 40);

b) pëlhurat e pathurura ose komplet të ngulura në plastikë apo gomë, ose komplet i mbuluar apo veshur në të dy anët me material të tillë, me kusht që të tilla veshje apo mbulesa mund të shihen me sy të zhveshur pa marrë parasysh asnjë ndryshim rezultues të ngjyrës (kapitulli 39 apo 40);

c) pllakat, fletat, shiritat e plastikave apo gomave celularë kombinuar me leshin e presuar apo pëlhurat e pathurura, ku materiali i tekstit është paraqitur thjesht për qëllime përforcimi (kapitulli 39 apo 40).

4. Kreu nr.56.00 nuk përfshin fijet apo rripat tekstile të materialeve tekstile, sintetike apo artificiale me një gjerësi jo më tepër se 5 mm (kreu nr.54.00), në të cilat ngopja, mbulesa apo veshja nuk mund të shihen me sy të zbuluar (zakonisht kapitulli 50 deri 55); për qëllimet e këtij përcaktimi, nuk do të merret parasysh asnjë ndryshim rezultues i ngjyrës.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
56.00	Vatina, lesi i presuar dhe pëlhurat të tjera të pathurura; fijet speciale, litarët, spangot, kabllot dhe artikujt prej tyre	5

KAPITULLI 57
QILIMAT DHE MBULUESIT E TJERË TEKSTILË TË DYSHEMESË

Shënime:

1. Për qëllimet e këtij kapitulli termi “Qilimat dhe mbuluesit e tjerë tekstilë të dyshemesë” ka kuptimin mbuluesit e dyshemesë në të cilat materiali tekstil shërben si sipërfaqe e jashtme e artikullit dhe përfshin artikujt që kanë karakterisitikat e mbuluesit tekstil të dyshemesë por mund të përdoren edhe për qëllime të tjera.

2. Ky kapitull nuk përfshin nënshtresat mbuluese të dyshemesë.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
57.00	Qilimat dhe mbuluesit e tjerë të dyshemesë	30

KAPITULLI 58
PËLHURA SPECIALE TË THURURA; PËLHURAT TEKSTILE ME PUSH; DANTELLAT; TAPICERITË; ZBUKURIMET; QENDISMAT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin pëlhurat tekstile të referuara në shënimin I të kapitullit 59 të ngopura, veshura, mbuluara apo ndërthurura, apo mallrat e tjera të kapitullit 59.

2. Ky kapitull gjithashtu përfshin artikujt e bërë nga një metalike dhe të një lloji të përdorur në stolisje apo veshje si pëlhurat për veshmbathje apo për qëllime të ngjashme.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
58.00	Pëlhurat speciale të thurura; pëlhurat tekstile me push; dantellat; tapiceritë; zbukurimet; qëndismat	30

KAPITULLI 59
PËLHURAT TEKSTILE TË NGOPURA, TË VESHURA APO TË MBULUARA DHE TË NDËRTHURURA; ARTIKUJ TEKSTILË TË NJË LLOJI TË PËRSHTATSHËM PËR PËRDORIM INDUSTRIAL

Shënime:

1. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, për qëllimet e këtij kapitulli, shprehja “pëlhurat tekstile” zbatohet vetëm për pëlhurat e thurura të kapitullit 50 deri 55 dhe garzat, pëlhurat e thurura të ngushta (përveç etiketave, shenjave dalluese dhe artikujt e ngjashëm të materialeve tekstile në copë apo shirita) dhe pëlhurat e përbëra nga baza pa indin, e bashkuar me anën e një ngjitësi (kreu nr.58.00); zbukurime ornamentale në copa të kreut nr.58.00 dhe pëlhurat e thurura apo kroshe të kreut nr.60.00.

2. Kreu nr.59.00 zbatohet ndër të tjera për:

a) pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të ndërthurura me plastikë, ciladoqoftë pesha për metër katror dhe çfarëdolloj natyra e materialit plastik (kompakte apo celulare) përveç:

1. pëlhurave në të cilt ngopja, veshja apo mbulesa nuk mund të shihen me sy të lirë (zakonisht kapitulli 50 deri 55, 58 apo 60). Për qëllimet e këtij përcaktimi nuk do të merret parasysh asnjë ndryshim rezultues në ngjyrë;

2. produkte të cilat nuk mund të pëprkullen pa thyerje, me dorë rreth një cilindri me një diametër prej 7 mm në temperaturën midis 15-30⁰c (zakonisht kapitulli 39).

3. produktet në të cilat pëlhura tekstile është ose komplet e ngulur në plastikë ose tërësisht e veshur apo e mbuluar në të dyja anët me material të tillë, me kusht që të tilla veshje apo mbulesa mund të shikohen me sy të zhveshur pa marrë parasysh asnjë ndryhim rezultues në ngjyrë (kapitulli 39),

4. pëlhurat e veshura apo mbuluara pjesërisht me plastika dhe që durojnë pasojat e rrjedhura në këto trajtime (zakonisht kapitulli 50 deri 55, 58 apo 60);

5. pllakat, fletat apo shiritat e plastikave celulare, kombinuar me pëlhura tekstili, kur pëlhura e tekstilit paraqitet thjesht për qëllime përfundimi (kapitulli 39);

6. produktet tekstile të mbushura me copa, të përbëra nga një apo më shumë shtresa prej tekstili, të bashkuar me mbushjen me anë të qepjes apo ndryshe, përveç qëndismave në copa, shirita apo motive (kreu nr.58.00).

b) Pëlhurat e bëra nga fijet, rripat apo të ngjashmet me to, të veshura të ngopura apo mbështjella me plastikë të kreut nr.56.00;

3. Për qëllimet e kreut nr.59.00, shprehja “mbulesa tekstile për mure” zbatohet për produktet në role, me një gjerësi jo më pak se 45 cm, të përshtatshme për zbukurime muri apo tavani përbërë nga një sipërfaqe tekstili e cila është fiksuar në pjesën e prapme (e lagur apo e veshur për të lejuar ngjitjen).

Ky kre megjithatë nuk zbatohet për mbulesat e mureve që përbëhen nga push apo flokë tekstili të fiksuar direkt prapa letres (kreu nr.48.00) apo prapa tekstilit (në përgjithësi kreut nr.59.00).

4. Për qëllimet e kreut nr.59.00 shprehja “pëlhurat tekstile të gomuar” ka kuptimin:

a) pëlhurat tekstile të ngopura, veshura, mbuluara apo të ndërthurura me gomë;

i) që peshojnë jo më shumë se 1500 g/m²;

ii) që peshojnë më shumë se 1500 g/m² dhe përmbajnë material tekstili më shumë se 50% të peshës;

b) pëlhurat e bëra me fije, rripa apo të ngjashmet e tyre të ngopura, veshura apo mbuluara me gomë të kreut nr.56.00;

c) pëlhurat e përbëra nga fije tekstile, paralele të aglomeruara me gomë, në përpjestim me peshën për m²;

d) pllakat, fletat apo rripat e gomës celulare, të kombinuar me pëlhura tekstili, kur pëlhura e tekstilit është më shumë se thjesht e përfrocur, përveç produkteve tekstile të mbushura me copa, të përbëra nga një apo më shumë shtresa, me tekstile të bashkuara me mbushje, me qepje apo ndryshe, përveç qëndismave në copa, shirita apo motive (kreu nr.58.00).

5. Kreu nr.59.00 nuk përfshin:

a) pëlhurat në të cilat ngopja, veshja apo mbulimi nuk mund të shihen në sy të zhveshur (zakonisht kapitulli 50 deri 55, 58 apo 60). Për qëllimet e këtij përcaktimi, nuk do të merret parasysh asnjë ndryshim rezultues në ngjyrë;

b) pëlhurat pjesërisht mbuluar me figura (përveç kanavacës së vizatuar për skenat teatrale, rrobat e skenës etj);

c) pëlhurat pjesërisht mbuluar me flokë, push apo me pluhur tape dhe që durojnë skicimet, që rrjedhin nga ky trajtim. Për imitimet e pëlhurave me push mbeten të klasifikuara në këtë kre;

d) pëlhurat që përfundojnë me veshje normale duke patur një bazë të amilazës apo të substancave të ngjashme;

e) rimeso druri prapa pëlhurave tekstile (kreu nr.44.00)

f) kokrriza apo pudër natyrale apo artificiale abrazive, prapa pëlhurave tekstile (kreu nr.68.00);

g) mikë e aglomeruar apo e rindërtuar prapa pëlhurave tekstile (kreu nr.68.00);

h) krisaf metalik prapa pëlhurave tekstile (Seksioni XV);

6. Kreu nr.59.00 nuk zbatohet për:

a) rripat e transmisionit apo konvejerëve të materialeve tekstile, me trashësi më pak se 3 mm;

b) rripat e transmisionit apo konvejerëve, apo rripat e pëlhurave tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të ndërthurura me gomë apo bërë nga fije tekstile apo korda të ngopura, veshura apo ndërthurura me gomë (kreu nr.40.00);

7. Kreu nr.59.00 zbatohet për mallrat e mëposhtme, të cilat nuk futen në asnjë kre të Seksionit XI;

a) produktet tekstile në copa, prerë në gjatësi apo thjesht prerë në kënd të drejtë (përfshirë katrorin) ku futen pëlhurat e mëposhtme:

i) pëlhurat tekstile, pëlhurat vatinë apo të thurura dhe me lesh të presuar, të veshura, mbuluara

apo ndërthurura me gomë, lëkurë apo materiale të tjera, të një lloji të përdorur për veshjen e letrave dhe pëlhurat e ngjashme të përdorura për qëllime teknike;

ii) roletë me pëlhurë siç vjen nga tezgjahu.

iii) përlhura të forta të një lloji të përdorur në shtrydhjen e vajit apo në procese të tjera të ngjashme prej materiali tekstili apo prej flokëve të njerëzve;

iv) pëlhura tekstili të thurura, të lëmuara, me shumëfish baze apo indi, nëse është apo jo me vatinë, e ngopur apo e veshur, e një lloji të përdorur për qëllime teknike apo për makineritë;

v) pëlhurat tekstile të përforcuara me metal, të një lloji të përdorur për qëllime teknike;

vi) kordat, gërshetimet dhe të ngjashmet e tyre, nëse janë apo jo të veshura, të ngopura apo të përforcuara me metal të një lloji të përdorur në industri apo si material paketues apo lubrifikues;

b) artikujt tekstilë të një lloji të përdorur për qëllime teknike (p.sh. pëlhurat tekstile dhe leshi i presuar, pafund apo përshtatur me aparatet lidhëse, të një lloji të përdorur në makineritë e bërjes së letrës apo të tjetra, p.sh. për brumin apo asbestocementin, disqet larëse, lustrosëse dhe pjesë të tjera makinerie).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
59.00	Pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura apo të mbuluara dhe të ndërthurura. Artikujt tekstilë të një lloji të përshtatshëm për përdorim industrial;	15

KAPITULLI 60 PËLHURAT E THURURA APO KROSHETË

Shënime:

I. Ky kapitull nuk përfshin:

a) dantellat kroshe (kreu nr.58.00);

b) etiketat, simbolet dhe artikujt e ngjashëm, të thurura apo kroshe (kreu nr.58.00);

c) pëlhurat e thurura apo kroshe, të ngopura të veshura, të mbuluara apo të ndërthurura të kapitullit 59. Por, pëlhurat me push të thurura apo kroshe, të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të ndërthurura, mbeten të klasifikuara në kapitullin 60.00.

2. Ky kapitull gjithashtu përfshin pëlhurat e bëra nga fije metalike dhe të një lloji të përdorur në stolisje, si pëlhura mobilimi apo për qëllime të ngjashme.

3. Gjatë gjithë nomenklaturës çdo referencë për “mallrat e thurura” përfshin një referencë për mallrat e lidhura me qepje, në të cilat qepjet zinxhir janë bërë nga fije tekstili.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
60.00	Pëlhurat e thurura apo kroshtë	15

KAPITULLI 61 ARTIKUJT E VESHJES DHE RROBA TË TJERA PLOTËSUESE, TË THURURA APO KROSHE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) tirantat, korsetë, rripat, varëset, llastiqet e çorapeve si dhe artikuj të tjerë (për rroba të brendshme) si dhe pjesët e tyre, nëse janë apo jo të thurura apo kroshe (kreu nr.62.00).

b) rrobat e përdorura dhe artikuj të tjerë tekstilë të përdorura të shtrimit (kreu nr.63.00).

c) rripat kirurgjikalë si dhe zbatimet ortopedike (kreu nr.90.00).

2. Ky kapitull zbatohet vetëm për artikujt e prodhuar të thurura apo kroshe.

3. Artikujt e këtij kapitulli mund të bëhen me fije metali.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
61.00	Artikujt e veshjes dhe rroba të tjera plotësuese të thurura apo kroshe	30

KAPITULLI 62
ARTIKUJ TË VESHJES DHE RROBA TË TJERA PLOTËSUESE, JO TË THURURA APO KROSHE

1. Ky kapitull përfshin vetëm artikujt e bërë nga çdo pëlhurë tekstili, përveç atyre të mbushura, duke përjashtuar artikujt e thurur apo kroshe (përveç tirantat, korsetë, rripat, varëset, llastiqet e çorapeve si dhe artikujt të tjerë (për rroba të brendshme) si dhe pjesët e tyre, nëse janë apo jo të thurra apo kroshe kreu nr.62.00);

2. Ky kapitull nuk përfshin:

a) rrobat e përdorura apo artikujt të tjerë tekstilë të përdorur të kreut nr.63.00;

b) zbatimet ortopedike, rripat kirurgjikalë etj. (kreu nr.90.00);

3. Artikujt e këtij kapitulli mund të bëhen me fije metali.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
62.00	Artikuj të veshjes dhe rroba të tjera plotësuese, jo të thurura apo kroshe	30

KAPITULLI 63
ARTIKUJ TË TJERË TEKSTILE; KOMPLETET E SHTRIMIT; RROBAT E PËRDORURA DHE ARTIKUJ TË PËRDORUR TEKSTILË; LECKAT MBETURINË

I. Kreu nr.63.00 zbatohet ndër të tjera për mallrat e mëposhtme:

a) artikujt me material tekstili;

i) rrobat, si dhe rrobat ndihmesë dhe pjesët e tyre;

ii) batanijet dhe plaçkat e udhëtimit;

iii) çarçafët, mbulesat e tavolinës, mbulesa kuzhine apo mbulesa tualeti;

iv) artikujt mobilues, përveç qilimave të kreut nr.57 dhe tapiceritë e kreut nr.58.00;

b) veshjet e këmbëve dhe llojet e ndryshme të kapeleve çdo materiali përveç asbestos.

Me qëllim që artikujt e përmendur më lart, të klasifikohen në këtë kre, ato duhet të plotësojnë të dy kërkesat e mëposhtme:

i) ato duhet të paraqiten si veshje të pëlqyeshme;

ii) ato duhet të paraqiten në tufë apo në thasë apo në paketues të tjerë të ngjashëm.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
63.00	Artikujt të tjerë tekstilë, kompletet e shtresave, rrobat e përdorura dhe artikujt të përdorur tekstilë; lecat mbeturinë	15

SEKSIONI VESHJET E KËMBËVE, VESHJET E KOKËS, ÇADRA E DIELLIT, BASTUNET, KAMXHIKËT, MJETE TË TJERA TË HIPIZMIT DHE PJESËT E TYRE; PUPLAT E PËRGATITURA DHE ARTIKUJ TË BËRË BASHKË ME TO; LULET ARTIFICIALE; ARTIKUJ TË PREJ FLOKËVE TË NJERËZVE

KAPITULLI 64
VESHJET E KËMBËVE, GJYNJAKËT DHE ARTIKUJ TË NGJASHËM; PJESËT E ARTIKUJVE TË TILLË

Shënime:

I. Ky kapitull nuk përfshin:

a) këpucët pa u hedhur gjysma prej tekstili (kapitulli 61 apo 62);

b) këpucët e përdorura të kreut nr.63.00;

c) artikujt e asbestit (kreu nr.68.00);

d) veshjet ortopedike të këmbëve apo mallra të tjera ortopedikë, apo pjesët e tyre (kreu nr.90.00);

e) këpucët sportive apo çizmet e skive me patinat e akullit të ngjitura; mbrojtësit e kërcinjve

apo veshje të ngjashme mbrojtëse, sportive (kapitulli 95).

2. Për qëllimet e kreut nr.64.00 shprehja “pjesët e këpucëve” nuk përfshin kunjat, mbrojtësit e çizmeve, ylyqet, grepat e çizmeve, togëzat, zbukurimet, qëndisjet apo zbukurimet e tjera (të cilat janë klasifikuar në krerët e tyre përkatës) apo butonat dhe mallrat e tjera të kreut nr.96.00;

3. Për qëllimet e këtij kapitulli shprehja “gomë apo plastikë” përfshin çdo material tekstili të veshur apo mbuluar, dukshëm nga ana e jashtme me një apo dy nga këto materiale.

4. Të nënshtruar ndaj shënimit 3 të këtij kapitulli:

a) materiali i sipërm do të merret si material përbërës duke pasur sipërfaqen më të madhe të jashtme, pa marrë parasysh ndihmësit apo përforcuesit, të tillë si pullat e nyjeve të këmbës, zbukurimet, togëzat, ylyqet apo ngjitës të ngjashëm;

b) materiali përbërës i pjesës së jashtme do të merret materiali që ka sipërfaqen më të madhe të lidhjes me bazën, pa marrë parasysh ndihmësit apo përforcuesit e tillë si thumba, gozhdë, mbrojtësit apo lidhësit e ngjashëm.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
64.00	Veshjet e këmbëve, gjynjakët dhe artikujt e ngjashëm, pjesët e këtyre artikujve	15

KAPITULLI 65 VESHJET E KOKËS DHE PJESET E TYRE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) veshjet e kokës të përdorura (kreu nr.63.00);

b) veshjet e kokës prej asbesti (kreu nr.68.00);

c) veshjet e kokës të kukullave, veshjet e kokës të lodrave të tjera apo artikujt të karnavaleve të kreut nr.95.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
65.00	Veshjet e kokës dhe pjesët e tyre	15

KAPITULLI 66 ÇADRAT, ÇADRAT E DIELLIT, BASTUNËT, KAMZHİKËT, PAJISJET E TJERA TË HIPIZMIT DHE PJESET E TYRE

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) bastunët, shkopinj të matës apo artikujt të ngjashëm (kreu nr.90.00);

b) trupi i armëve të zjarit, dorezat e shpatave, shkopinj të gomës, apo të artkujve të ngjashëm (kreu nr.93.00);

c) mallrat e kapitullit 95 (p.sh., çadrat lodrat, çadrat e diellit lodër).

2. Kreu nr.66.00 nuk përfshin pjesët, zbukurimet apo plotësuesit prej materialeve tekstile, apo mbuluesit, xhufkat, rripat, kutitë e çadrave apo artikujve të tjerë të ngjashëm prej çdo materiali. Mallra të tillë të praqitur me artikujt e kreut nr.66, por që nuk i përshtaten atyre, do të klasifikohen veç dhe nuk do të trajtohen si pjesë përbërëse të këtyre artikujve.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
66.00	Çadrat, çadrat e diellit, bastunët, kamzhikët, pajisjet e tjera të hipizmit dhe pjesët e tyre	30

KAPITULLI 67 PUPLAT DHE PUSHI I PËRGATITUR DHE ARTIKUJT E BËRË NGA PUPLAT, LULET ARTIFICIALE, ARTIKUJT E BËRË NGA FLOKËT E NJERËZVE

Shënime:

I. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) rrobën e fortë të bërë nga flokët e njerëzve (kreu nr.59.00);
- b) motivet e qëndismave të pëlhurave të zbukuruara apo tekstile të tjera (Seksioni XI);
- c) veshjet e këmbëve (kapitulli 64);
- d) veshjet e kokës apo rrjetat e flokëve (kapitulli 65);
- e) lodrat, pajisjet sportive apo artikuj të karnavaleve të kapitullit 95;
- f) push puplash. Pufe pudre apo rrjetë thithëse për flokët (kapitulli 96);

2. Kreu nr.67.00 nuk përfshin:

a) artikujt në të cilat puplat apo pushi formojnë vetëm mbushjen (p.sh.shtrojat e kreut nr.94.00);

b) artikujt e veshjes apo të veshjeve ndihmëse në të cilat puplat formojnë thjesht zbukurim apo fryrje;

3. Kreu nr.67.00 nuk përfshin:

a) artikujt prej xhami (kapitulli 70);

b) lulet artificiale, gjethnajat apo frutat në materiale poçarie, guri, metali, druri apo materiale të tjera, fituar në një copë të vetme nga dhënia e formës, gdhëndja, stampimi apo proces tjetër, apo të përbëra nga pjesë të bashkuara ndryshe nga lidhja, ngjitja, futja në njëra-tjetrën apo metoda të ngjashme.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
67.00	Puplat dhe pushi i përgatitur dhe artikujt e bërë nga puplat; lulet artificiale. Artikujt e bërë nga flokët e njerëzve	30

SEKSIONI XIII

ARTIKUJT PREJ GURI, ALLÇIE, ÇIMENTO, ASBESTI, MIKË APO MATERIALE TË NGJASHME, PRODUKTET QERAMIKE, XHAMI DHE QELQURINAT

KAPITULLI 68

ARTIKUJT E GURIT, ALLÇISË, ÇIMENTOS, ASBESTIT, MIKËS APO MATERIALEVE TË NGJASHME

Shënime:

I. Ky kapitull nuk përfshin:

- a) mallrat e kapitullit 25;
- b) letra e mbuluar, ngopur apo veshur e kreut nr.48. (p.sh. letra e mbuluar me pluhur mike apo grafiti, letra e bituminuar apo asfaltuar);
- c) pëlhura tekstile të veshura, ngopura apo mbuluara të kapitullit 56 apo 59 (p.sh.pëlhura e veshur apo e mbuluar me pluhur mike, pëlhura e bituminuar apo e asfaltuar);
- d) artikujt e kapitullit 71;
- e) veglat e punës apo pjesët e tyre, të kapitullit 82;
- f) gurët litografikë përgatitur për qëllime shtypi (kreu nr.84.00);
- g) izolatorët elektrikë apo përshtatjet e materialeve izolues të kreut nr.85.00;
- h) turjelat dentare (kreu nr.90.00);
- i) artikujt e kapitullit 91 (p.sh.orat dhe kutitë e tyre);
- k) artikujt e kapitullit 94 (p.sh.mobiljet, llampat apo pajisjet e dritës, parafabrikatet);
- l) artikujt e kapitullit 95 (p.sh.lodrat, pajisjet sportive);
- m) artikujt e kreut nr.96.00 (p.sh.butonat, lapsat. Pllakat e shkrimit apo vizatimit);
- n) artikujt e kapitullit 97 (p.sh. veprat e artit).

2. Në kreun nr.68.00 shprehja “gurët e veprave monumentale apo të ndërtesave” zbatohet jo vetëm për llojet e gurëve të referuara në kreun nr.25.00, por gjithashtu për të gjithë gurët e tjerë natyralë (p.sh. kuarcite, dolomite, stralli) të punuar njëlloj. Por megjithatë nuk zabtohet për rrasat e shkrimit.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
68.00	Artikujt prej guri, allçie, çimento, asbesti ,mikë apo materiale të ngjashme	5

KAPITULLI 69 PRODUKTET QERMIKKE

Shënime:

1. Ky kapitull zbatohet vetëm për produktet qermaiike që janë pjekur pas dhënie të formës:

2. Ky kapitull nuk përfshin:

a) elementët kimikë radioaktivë dhe izotopet e tyre radioaktivë (duke përfshirë elementët dhe izotopet kimikë të ndashme apo plehëruese) dhe përbërjet e tyre; përzierjet dhe mbetjet e përbëra nga këto produkte (kreu nr.28.00);

b) artikujt e kapitullit 71 (imitacionet e bizhuterive);

c) metalqeramikat e kreut nr.31.00;

d) artikujt e kapitullit 82;

e) izoluesit elektrikë apo përshtatjet e materialeve izolues (kreu nr.85.00);

f) dhëmbët artificiale (kreu nr.90.00);

g) artikujt e kapitullit 91 (p.sh.orat dhe kutitë e orave);

h) artikujt e kapitullit 94 (p.sh.mobileritë, llampat dhe pajisjet e dritës, parafabrikatet);

i) artikujt e kapitullit 95 (lodat, pajisjet sportive);

j) butonat, kopsat, mbërtheakat, format e butonave dhe pjesë të tjera të këtyre artikujve, vrimat e butonave, pipat e duhanit dhe mbajtësit e duhanit dhe cigareve si dhe pjesët e tyre (kreu nr.96.00).

l) artikujt e kapitullit 97 (p.sh.veprat e artit).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
69.00	Produktet qeramike	5

KAPITULLI 70 QELQI DHE QELQURINAT

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) zmalin dhe glazurën e qelqëzuar, qelqin e thërrmuar, qelqe të tjera në formën e pluhurit, kokrrizave apo grimcave (kreu nr.32.00);

b) artikujt e kapitullit 71 (p.sh.imitacionet e bizhuterive);

c) kullotat me fibra optike, izolatorët elektrikë apo përshtatjet e materialeve izoluese të kreut nr.85.00;

d) fibrat optike, elementët optikë të punuar në to, shiringa hipodermike, sy artificiale, termometra, barometra, hidrometra apo artikuj të tjerë të kapitullit 90;

e) pajisjet e dritës apo llampat, shenjat ndriçuese, pllakat ndriçuese apo artikuj të ngjashëm, që kanë një burim të përhershëm drite, apo pjesët e tyre të kreut nr.94.00

f) lodrat, pajisjet sportive, zbukurimet e pemës për krishtlindje apo artikujt të tjerë të kapitullit 95 (përfshijë sytë prej xhami, pa mekanizmat për kukullat apo për artikujt të tjerë të kapitullit 95);

g) butonat, enët laboratorike vacuum, parfumet apo sprucot e ngjashme apo artikujt të tjerë të kapitullit 96.

2. Për qëllimet e kreut nr.70.00 shprehja “lesh xhami” ka kuptimin:

a) leshi mineral me përmbajtje silici (SiO_4) më pak se 60%;

b) leshi mineral me përmbajtje silici (SiO_4) në më pak se 60% por me përmbajtje oksidi alkalin (K_2O apo Na_2O) më tepër se 5 % apo të oksidit borik (B_2O_3) më tepër se 2%;

c) leshi mineral i cili nuk plotëson specifikimet e mësipërme futet brenda kreut nr.68.00.

3.Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “qelq” përfshin kuarcin e shkrirë dhe silicat e tjera të shkrira.

Kr	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
----	------------	---------------------

eu nr.		
70	Qelqi dhe qelqurinat	5
.00		

SEKSIONI XIV

PERLAT NATYRALE APO TË KULTIVUARA, GURËT E ÇMUAR APO GJYSËM TË ÇMUAR, METALET E ÇMUARA, VESHJET E METALEVE ME METAL TË ÇMUAR DHE ARTIKUJT PREJ TYRE; IMITACIONET E BIZHUTERIVE, MONEDHAT

KAPITULLI 71

PERLAT NATYRALE APO TË KULTIVUARA, GURËT E ÇMUAR APO GJYSMË TË ÇMUAR, METALET E ÇMUARA; VESHJET E METALEVE ME METAL TË ÇMUAR DHE ARTIKUJT PREJ TYRE; IMITACIONET E BIZHUTERIVE; MONEDHAT

Shënime:

I. të nënshtruar ndaj shënimit I(a) të Seksionit VI dhe prëveç siç është përcaktuar më poshtë, gjithë artikujt që përbëhen tërësisht apo pjesërisht: a) nga perla natyrale apo të kultivuara apo nga gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar (natyralë, sintetike apo të kultivuara); b) nga metale të çmuar apo metale të veshura me metal të çmuar do të klasifikohen në këtë kapitull.

2. Ky kapitull nuk përfshin:

a) amalgamën e metaleve të çmuar, apo metalet e çmuar koloidal (kreu nr.28.00);
b) metarialet sterile kirurgjikale, mbushjet dentare apo mallra të tjera të kapitullit 30;
c) artikujt e kapitullit 32 (p.sh. ilustratat);
d) baulet, valixhet, kutitë e tualetit, çantat e shkollës, kutitë e dylbive, kutitë e kamerave, kutitë e instrumentave muzikorë, kutitë e armëve si dhe kontenierë të ngjashëm, çanta udhëtimi, çanta tualeti, çanta shpine, çanta dore, çanta pazari, kuti hartash, kuletat, kutitë e cigareve, kutitë e duhanit, çantat e velgave, çanta sporti, kutitë e takëmeve të ngrënies si dhe kontenierët e ngjashëm prej lëkure të përbërë prej fletëve plastike, material tekstil prej fibrave të vullkanizuara apo prej letre pjesësisht apo tërësisht mbuluar me material të tillë. Apo artikuj të veshjes dhe rrobave plotësuese prej lëkure, apo prej lëkure të përbërë (kreu nr.42.00);

e) artikuj të veshjes, rrobave plotësuese dhe artikuj të tjerë prej gëzofi apo qime artificiale dhe artikujt prej tyre (kreu nr.43.00);

f) mallrat e seksionit XI (tekstilet dhe artikujt tekstilë);

g) veshjet e këmbëve, kokës apo artikuj të tjerë të kapitullit 64 apo 65);

h) çadrat, bastunët apo artikujt të tjerë të kapitullit 66;

i) mallrat abrazive të kreut nr.68.00 apo 82.00, që përmbajnë pluhur të gurëve të çmuar apo gjysmë të çmuar (natyrale apo sintetike). Artikujt e kapitullit 82 me një pjesë pune prej gurëve të çmuar apo gjysmë të çmuar (natyrale sintetike apo të kultivuara); makineritë, pajisjet mekanike apo mallrat elektrike, apo pjesët e tyre të seksionit XVI. Por artikujt dhe pjesët e tyre, tërësisht me gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar (natyrale, sintetike apo të kultivuara); makineritë, pajisjet mekanike apo mallrat elektrike apo pjesët prej tyre të seksionit XVI. Por artikujt dhe pjesët e tyre tërësisht me gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar (natyrale, sintetike apo të rindërtuara) mbeten të klasifikuara në këtë kapitull, përveç safirëve të punuar të pamontuar dhe diamantet për stoli (kreu nr.85.00);

k) artikuj të kapitullit 90, 91 apo 92 (instrumente shkencore, orë dore apo muri, instrumentet muzikorë);

l) armët dhe pjesët e tyre (kapitulli 93);

m) artikujt e përfshirë nga shënimi 2 i kapitullit 95;

n) mbërtheqat dhe pjesët e tyre, stilolapsat, kapsat me majë të mbushur dhe ata me majë poroze dhe shënuesit; stilografët, lapsat-stilografa dhe lapsa të tjerë, stilolapsa dyfish, mbajtëse lapsash, stilolapsash dhe mbajtës të ngjashëm; pjesët e lapsave dhe të mbajtësve të tyre (përfshirë kapësat dhe kapakun); shkumësat me ngjyrë; maja lapsi; qymyr druri për vizatime, shkumësa për shkrim dhe shkumësat e rrobaqepësit, rrasat dhe dërrasat me gjithë sipërfaqen e shkrimit apo të vizatimit; çakmakët, nëse janë apo jo mekanikë apo elektrikë dhe pjesët e tyre, përveç strallit dhe fitilit; pipat e duhanit dhe mbajtësit e duhanit të cigareve dhe pjesët e tyre; spray-t e parfumit dhe spray të tjerë të ngjashëm të tualetit. Pufe pudre dhe taponat (mbushjet) për bërjen e kozmetikës apo

tualetit. Enët laboratorike vacuum dhe enë të tjera vacuum, së bashku me kutitë, manekinët e rrobaqepësve; manekinët dhe reklamime të tjera frymëzuese përdorur në dyqanet e hapura të rrobave (kreu nr.96.00).

o) statujat apo skulpturat origjinale, copa të mbledhura apo antika të një moshe më tepër se 100 vjeçare (kreu nr.97.00) përveç perlave natyrale apo të kultivuara ose gurët e çmuar apo gjysmë të çmuar.

3.(a) Shprehja “metale të çmuara” ka kuptimin ar, argjend, dhe platin.

b) shprehja platin ka kuptimin platinium, iridium, osmium, palladium, rodium dhe ruthenium.

c) shprehja “gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar” nuk përfshin ndonjë substancë të specifikuar në shënimin 2(b) të kapitullit 96.

4. Për qëllimet e këtij kapitulli çdo lidhje (duke përfshirë një përzierje të aglomeruara dhe përbërjet intermetalike), që përmban metale të çmuara do të trajtohen si një lidhje e metalit të çmuar në qoftë se çdo njëri prej metaleve të çmuar përbën 2 për qind të peshës së lidhjes. Lidhjet e metaleve të çmuar do të klasifikohen në përputhje me rregullat e mëposhtme:

a) lidhja me 2% apo më shumë platin do të trajtohet si lidhje platin;

b) lidhja me 2% apo më shumë ar dhe pa platin ose edhe me platin më pak se 2% do të trajtohet si lidhje ari;

c) lidhjet e tjera me 2% apo më shumë të argjendit do të trajtohen si lidhje argjendi.

5. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, çdo referencë në nomenklaturë për metalet e çmuar, apo për metale të veçanta të çmuara, përfshin një referencë për lidhjet e trajtuara si lidhje të metaleve të çmuara apo të një metali të veçantë në përputhje me rregullat në shënimin 4 e më lart, por jo për veshjet e metaleve me metale të çmuar po të metaleve bazë, apo pllakave jo metalike me metale të çmuar.

6.Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja “metalet e veshura me metale të çmuar” ka kuptimin materiale bërë me bazë metal, mbi një apo më shumë sipërfaqe në të cilat ndodhet e ngulur nga saldimi, ngjitja, ngjitje me kallaj apo mjete të ngjashme mekanike si një mbulesë prej metali të çmuar. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe shprehja mbulon gjithashtu dhe metalet bazë zbukuruar me metale të çmuara.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
71.00	Perelat natyrale apo të kultivuara dhe gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar, metalet e çmuara dhe veshjet metalike me metal të çmuar	5
71.02	Mallra të tjera të përfshira në bizhuteri, të argjendarëve dhe arpunuesve si dhe artikuj të tjerë	30

SEKSIONI XV METALET BAZË DHE ARTIKUJT PREJ METALEVE BAZË

Shënime:

1. Ky kapitull nuk përfshin:

a) bojrat e përgatitura apo produkte të tjera me bazë të kokrrizave apo pluhurit metalik (kreu nr.32.00);

b) fero-cerium apo lidhjet e tjera pirofonike (kreu nr.36.00);

c) veshjet e kokës apo pjesët e tyre (kreu nr.65.00);

d) skeleti i çadrave apo artikuj të tjerë të kreut nr.66.00;

e) mallrat e kapitullit 71 (p.sh.lidhjet e metaleve të çmuar, veshjet e metaleve bazë me metale të çmuar, imitacionet e bizhuterive);

f) artikujt e seksionit XVI (makineritë, pajisjet mekanike dhe mallrat elektrike);

g) tramvaj hekurudhorë apo kamionët tramvajë (kreu nr.86.00) apo artikujt të tjerë të seksionit XVII (mjetet e transportit, anijet dhe varkat, avionët);

h) instrumentet apo aparaturat e seksionit XVIII duke përfshirë orat dhe zemrekun e tyre;

i) plumbat e përgatitur si municion (kreu nr.93.00) apo artikujt e tjerë të seksionit XIX (armët dhe municionin);

k) artikujt e kapitullit 94 (p.sh.mobileritë, pajisjet shtëpijake, llampat dhe pajisjet e dritës, shenjat ndriçuese, parafabrikatet);

l) artikujt e kapitullit 97 (p.sh.lodrat, pajisjet sportive);

m) sitat e dorës, butonat, lapsat, mbajtëset e lapsave, majat e penëve apo artikuj të tjerë të kapitullit 96 (artikuj të ndryshëm të prodhuar);

n) artikujt e kapitullit 97 (p.sh. veprate artit);

2. Gjatë gjithë nomenklaturës shprehja: pjesët e përdorimit të përgjithshëm” ka kuptimin:

a) tubi i pipave (p.sh. lidhja, kthesa), litarët, kabllot, telat, rripat e gërshtetuara, gjalmët dhe artikuj të tjerë të ngjashëm jo të izoluar elektrikisht; zinxhirat dhe pjesët e tyre; gozhdët, thumbat, gjilpërat, kapëse, gozhdët e valëzuara, fletët metalike të valëzuara (përveçse në shirita të keut nr.83.00 dhe artikuj të ngjashëm, nëse janë apo jo me koka të materialeve të tjerë, por, përjashtohen artikujt të tillë me koka bakri; vidat, bulonat, grepat,dadot, vida karrocash, perçina, krevatë portativë, vidat e tyre, rondelet (përfshi rondelet sustë) dhe artikuj të ngjashëm prej hekuri dhe çeliku (kreu nr.73.00);

b) sustat dhe fletat e sustave me bazë metali përveç orave apo sustave të orave (kreu nr.91.00);

d) drynet dhe bravat (të operuara me çelës, të kombinuara apo elektrikë), kapëset dhe skeleti i drynave, çelësat apo artikujt e mësipërm; pajisjet, instalimet dhe artikujt të ngjashëm të përshtatshëm për pajisjet e shtëpisë derës, shkallëve, dritareve, grilat e dritareve, takëmeve të kalit, bauleve, sënduqeve, kutive apo artikujve të tjerë të ngjashëm; varëset e kapeleve, kapëse kapelesh, mbajtëse dhe mbështetëse të ngjashme, rrotëzat (në këmbët e tryezës) bashkë me instalimet, mbyllësit automatikë të derës, togëzat, kapëset e tyre, grepat sytë vrimëzat dhe artikuj të ngjashëm të një lloji të përdorur për rroba, këpucë, çantat e dorës, tendat, mallrat e udhëtimit apo artikuj të tjerë; perçina njësh apo të bigëzuara, ruazat dhe xhixhat, pllakat, pllakat e emrit, të adresës dhe pllaka të ngjashme, numrat e shkronjat dhe simbole të tjera duke përjashtuar pllakat e emrit ndriçuese dhe artikuj të ngjashëm (kreu nr.94.00) si dhe skeletet dhe pasqyrat me bazë metali (kreu nr.83.00).

Në kapitujt 73 deri 76 dhe 78 deri 82 (përjashtoj zinxhirët dhe pjesët e tyre prej hekuri dhe çeliku) referohen pjesët e mallrave që nuk përfshihen në referencën e pjesëve të përdorimit të përgjithshëm siç u përcaktua më lart.

Nënshtuar në paragrafin paraprirës dhe në shënimin 1 të kapitullit 83, artikujt e kapitullit 80 apo 83 janë përjashtuar nga kapitujt 72 deri 76 dhe 78 deri 81.

3. Klasifikimi i lidhjeve (përveç ferro-lidhjeve dhe lidhjeve kryesore siç është përcaktuar në kapitullin 72 dhe 74);

a) një lidhje me metalet bazë do të klasifikohet si një lidhje e metaleve të cilët predominojnë në peshë mbi secilën nga metalet e tjerë;

b) një lidhje e përbërë e metaleve bazë të këtij seksioni dhe i elementëve që nuk futen brenda këtij seksioni, do të trajtohet si një lidhje e metaleve bazë të këtij seksioni në qoftë se pesha totale e metaleve të tillë barazohet apo e tejkalon peshën totale të elementëve të tjerë të paraqitur;

c) në këtë seksion termi “lidhje” përfshin përzierjet e pluhurave metalike përzierjet heterogjene të fshehta fituar, nga shkrirja (përveç metaloqeramikat) dhe përbërjet intermetalike.

4. Derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, çdo referencë, në nomenklaturë për metalet bazë përfshin një referencë për lidhjet të cilat sipas shënimit 3 më lart, do të klasifikohen si lidhje të atyre metaleve.

5. Klasifikimi i artikujve të përbërë:

Veçse kur kreu e kërkon ndryshe, artikujt e metaleve bazë (përfshirë artikujt e materialeve të përzierë trajtuar si artikujt të metaleve bazë sipas rregullave interpretativë) që përbëhen nga dy apo më shumë metale bazë do të trajtohen si artikuj të metaleve bazë që predominojnë në peshë mbi secilën nga metalet e tjera. Për këtë qëllim:

a) hekuri dhe çeliku apo lloje të ndryshme hekuri dhe çeliku, do të vlerësohen si një dhe i vetmi metal;

b) një lidhje vlerësohet si kur është e përbërë tërësisht nga ai metal po ashtu si edhe një lidhje e klasifikuar sipas shënimit 3;

c) një metaloqeramik i kreut nr.81.00 do të klasifikohet si një metal i vetëm bazë;

6. Në këtë seksion shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin shënuar ngjitur me ta:

a) mbeturina apo kthime;

Mbeturina apo kthime metali nga prodhimi apo punimi mekanik i metaleve dhe mallrat metalikë të përcaktuar të papërdorshme nga thyerja, këputja, konsumi apo arsye të tjera.

b) pluhura.
Produktet 90% shuma e të cilave kalojnë nëpërmjet sitës duke patur një vrimë rrjete prej 1 mm.

KAPITULLI 72 GIZA, HEKURI DHE ÇELIKU

Shënime:

1. Në këtë kapitull dhe në rastin e shembullit (d), (e) dhe (i) gjatë gjithë nomenklaturës, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e shënuar bashkëngjitur tyre:

a) “gizë e derdhur”

Giza e derdhur që përmban ndaj peshës, një apo më shumë nga elementët e mëposhtëm në raportet e caktuar:

- jo më shumë se 10% krom;
- jo më shumë se 6% magnez;
- jo më shumë se 3% fosfor;
- jo më shumë se 8% silic;
- një total prej jo më shumë se 10% të elementëve të tjerë.

b) “gizë pasqyrë” :

Lidhjet gizë-karbon që përmbajnë më shumë se 6% por jo më shumë se 30% magnez dhe elementët e tjerë në përputhje me specifikimet (a) më lart:

c) “ferro-lidhjet”

Lidhjet në forma të derdhura të bashkuar apo në forma të tjera të ngjashme fillestare, në forma të fituara nga derdhjet e vazhdueshme dhe gjithashtu në forma të granuluara apo pluhur, agjentët desufluror apo për përdorime të ngjashme në ferometalurgjinë dhe në përgjithësi jo shumë i farktueshëm, që përmbajnë ndaj peshës 4% apo më shumë hekur dhe një apo më shumë nga elementët e mëposhtme:

- më shumë se 10% krom;
- më shumë se 30% magnez;
- më shumë se 3% fosfor;
- më shumë se 8% silic;
- totali i elementëve të tjerë më shumë se 10% (përfshijë karbonin) si dhe i nënshtruar në një përmbajtje maksimumi 10% në rastin e bakrit.

d) “çelik”

Ferro-materialet përveç atyre të kreut nr.72.00 të cilët (me përjashtimet e tipave të caktua të prodhuara në format e derdhjes) janë shumë të farktueshëm dhe të cilët përmbajnë 2% më pak karbon. Por çeliku i kromuar mund të përmbajë raporte më të larta karboni.

e) “çelik i pandryshkshëm”:

Çeliku i lidhur që përmban 1,2% apo më pak karbon dhe 10,3 % apo më shumë krom, me apo pa elementët e tjerë.

f) “çelike të tjera të lidhura”:

Çeliket që nuk përputhen me përcaktimin e çelikeve të pandryshkshëm dhe që përmbajnë ndaj peshës një apo më shumë nga elementët e mëposhtme në raportet e treguar:

- 0.3% apo më shumë alumin;
- 0.000% apo më shumë bor;
- 0.3% apo më shumë krom;
- 0.3% apo më shumë kobalt;
- 0.4% apo më shumë bakër;
- 0.4% apo më shumë plumb;
- 1.65% apo më shumë manganez;
- 0.03% apo më shumë molibden;
- 0.3% apo më shumë nikël;
- 0.06% apo më shumë niobium;
- 0.6% apo më shumë silic;
- 0.05% apo më shumë titan;

- 0.3% apo më shumë volfram;
- 0.1% apo më shumë vanadium;
- 0.05% apo më shumë xirkonium;
- 0.1% apo më shumë elementë të tjerë përveç sulfurit, fosforit, karbonit, nitrogjenit) të marra veç e veç.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
72.00	Giza, hekuri dhe çeliku	5

KAPITULLI 73 ARTIKUJT E GIZËS DHE ÇELIKUT

Shënime:

1. Në këtë kapitull shprehja “gizë e derdhur” zbatohet për produktet e fituara nga derdhja në të cilën giza predominon ndaj peshës mbi secilin nga elementet e tjerë dhe e cila nuk plotësohet me përbërjet kimike të çelikut, siç është përcaktuar në shënimin 1 (d) të kapitullit 72;

2. Në këtë kapitull fjala “tela” ka kuptimin produktet e formuara në të ftohtë apo në të nxehtë të çdo forme seksionale, në të cilat asnjëdimension seksional nuk e kalon 16 mm.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në përqindje
73.00	Artikujt e gizës dhe çelikut	5

KAPITULLI 74 BAKRI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Shënim:

I- Në këtë kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkëngjitur tyre:

a) bakër i rafinuar;

Metal që përmban të paktën 99.85% bakër;

Apo

Metal që përmban 97.5% bakër, me kusht që përmbajtja e ndonjë elementi tjetër të mos e kalojë limitin e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Elementët e tjerë

Elementët	Limiti në %
Ag argjend	0.25
As arsenik	0.5
Cd kadium	1.3
Cr kromium	1.4
Mg magnezium	0.8
Pb plumb	1.5
S squfur	0.7
Sn kallaj	0.8
Te telur	0.8
Zn zink	1
Zr zirkonium	0.3
Elemente të tjera, secila	
Elemente të tjera janë p.sh. Al, Be, Co, Fe, Mn, Ni, Si	

b) lidhjet e bakrit;

Substancat metalike, përveç bakrit të “rafinuar, në të cilën bakri predominon ndaj çdo elementi tjetër, me kusht që:

(i) përmbajtja e të paktën një prej elementëve të tjera është më e madhe se limiti i dhënë në tabelën e sipërpërmendur;

apo

- (ii) përmbajtja në total e elementëve të tjerë të tilla ta kalojë 2.5%;

c) krye-lidhjet:

Lidhjet që përmbajnë ndaj elementëve të tjerë më shumë se 10% bakër, jo më shumë të fakëtueshme dhe zakonisht të përdorur si një shtesë në prodhimin e lidhjeve të tjera apo si de-oksides, apo si agjent de-sulfurues apo për qëllime të ngjashme në metalurgjinë e metaleve jo-ferikë. Por, përbërja fosfor-bakër, që përmban më shumë se 15% fosfor futet në kreun nr.28.00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
74.00	Bakri dhe artikujt prej tij	15

KAPITULLI 75
NIKEL DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
75.00	Nikeli dhe artikujt prej tij	5

KAPITULLI 76
ALUMINI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
76.00	Alumini dhe artikujt prej tij	5

KAPITULLI 77

-i rezervuar

KAPITULLI 78
PLUMBI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
78.00	Plumbi dhe artikujt prej tij	5

KAPITULLI 79
ZINKU DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
79.00	Zinku dhe artikujt e tij	5

KAPITULLI 80
KALLAJI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
80.00	Kallaji dhe artikujt prej tij	5

KAPITULLI 81
METALE TË TJERA BAZË, METALOQERAMIKAT; ARTIKUJT PREJ TYRE

reun nr.	K	Përshkrimi	Tarifa në %
1.00	8	Metale të tjera bazë; metaloqeramikat; artikujt prej tyre	5

KAPITULLI 82
VEGLAT E PUNËS, PAJISJET, TAKËMET E NGRËNIES, LUGËT DHE PIRUNËT PREJ METALEVE BAZË, PJESËT E TYRE PREJ METALI BAZË

Shënime:

1- Duke ndarë veç llampat e fryra, furrat e shkrirjes portative, rrotat grirëse bashkë me skeletin, llojet e llaqeve dhe manikyreve si dhe pllakat, dorezat, majat dhe artikujt të ngjashëm për vegla e punës, të paraqitura veç nga to, prej metalit të karbitit apo prej metaloqeramikat, ky kapitull përfshin vetëm artikujt me teh, anë pune, sipërfaqe pune apo pjesëve të tjera të punës prej:

- a) metali bazë;
- b) metalit të karbitit apo prej metaloqeramikës;
- c) guri të çmuar apo gjysëm të çmuar (natyrale, sintetike apo të kultivuara) si mbështetje e metaleve bazë, karbiteve apo metalo-qeramikat;
- d) materiali abraziv në mbështetje të metalit bazë, me kusht që, artikujt të kenë dhëmbë prerës, kanale, vrima apo gjëra të tjera të ngjashme, me metal bazë, i cili e ruan identitetin e tij si dhe funksionet e tij pas zbatimit të abrazivit.

2- Pjesët prej metali bazë të artikujve të këtij kapitulli do të klasifikohen me artikujt, pjesë e të cilëve ata janë, përveç pjesëve të specifikuara veç si të tillë dhe mbajtëset e veglave për veglat e dorës (kreu nr.84.00). Por, pjesët e përdorimit të përgjithshëm siç është përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV do të përjashtohen në të gjitha rastet nga ky kapitull.

Kokat, tehet, dhe pllakat prerëse për makinat e rrojes elektrike, apo për makinat elektrike të qethjes së flokëve do të klasifikohen në kreun nr.85.00

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
82.00	Veglat e punës, pajisjet, takëmet e ngrënies, lugët dhe pirunët prej metaleve bazë, pjesët e tyre prej metali bazë	15

KAPITULLI 83
ARTIKUJ TË NDRYSHËM PREJ METALEVE BAZË

Shënim:

1- Për qëllimet e këtij kapitulli, pjesët prej metali bazë do të klasifikohen me artikujt e tyre. Por, telat e thurur, litarët, kabllot, rripat e thurrura, gjalmat dhe artikuj të ngjashëm jo të izoluar elektrikisht, zinxhirët dhe pjesët e tyre, gozhdët, pineskat kapëse, gozhdët e përdredhura, fletat /(veçse jo në shirita) të kreut nr.83.00 si dhe artikuj të ngjashëm, por, përjashtoj artikujt të tillë me koka bakri, vidat, dadot, bullonat, grepat, vida karrocash, përçina, krevatët portativ, vidat e tyre, rondelet (përfshi rondelet sustë) dhe artikuj të ngjashëm, apo sustat dhe fletat e sustave, prej hekuri dhe çeliku (kreu nr.73 00) apo artikuj të ngjashëm me metale të tjera bazë (kapitujt 74 deri 76 dhe 78 deri 81) nuk do të marrin pjesë si artikuj të këtij kapitulli.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
83 00	artikuj të ndryshëm me metale bazë	15

SEKSIONI XVI
MAKINERITË DHE PAJISJET MEKANIKE; PAJISJET ELEKTRIKE DHE PJESËT E TYRE;

APARATET E REGJISTRIMIT OSE TË RIPRODHIMIT TË TINGULLIT, APARATET E
REGJISTRIMIT OSE TË RIPRODHIMIT TË FIGURAVE DHE TË TINGULLIT NË TELEVISION
DHE PJESËT E PLOTËSUESIT E TYRE

Shënime:

1- Ky seksion nuk përfshin;

a) rripat e transimisionit apo kovejerit, ose rripat prej plastike të kapitullit 39, apo prej gome të vullkanizuara; apo artikuj të tjerë të përdorur në zbatimet mekanike apo elektrike ose në makineritë, apo përdorime të tjera teknike prej gome të vullkanizuara, përveç gomës së fortë (kreu nr.40 00);

b) artikuj lëkure (kreu nr.42 00) apo gëzofi (kreu nr. 43 00) të një lloji të përdorur në makineritë, pajisjet mekanike apo për qëllime të tjera teknike;

c) bobinat, konet, bërthamat, rrotëzat, kasetat apo pajisje të ngjashme, prej çdo materiali (psh kapitulli 39, 40, 44 apo 48 apo seksioni XV);

d) letrat e përfuara për Jakuard apo makina të ngjashme (psh kapitulli 39 apo 48 apo seksioni XV);

e) rripat e transmisionit apo të konvejerëve prej materiali tekstili apo artikuj të tjerë prej materiali tekstili për qëllime teknike (kreu nr.59.00);

f) gurët e çmuar apo gjysmë të çmuar (natyrale, sintetike apo të kultivuara) apo artikuj tërësisht prej gurëve të tillë të kreut nr.71 00 përveç safirëve të punuar dhe të pangjitur, si dhe diamantet (kreu nr.85 00);

g) pjesët e përdorimit të përgjithshëm siç është përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, me metal bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme prej plastike (kapitulli 39);

h) puntot gërryese (kreu nr.73 00);

i) rripa të pafund prej teli apo rripa metali (seksioni XV);

k) artikujt e kapitullit 83 apo 82;

l) artikujt e seksionit XVII;

m) artikujt e kapitullit 98;

n) orat dhe artikujt të tjerë të kapitullit 91;

o) veglat e punës të ndërrueshme të kreut nr.82 00 apo furçat e një lloji të përdorur si pjesë makinash të kreut nr. 96 00; veglat e tjera të ngjashme të ndërrueshme do të klasifikohen në përputhje me materialin përbërës të pjesës së tyre të punës (psh në kapitullin 40, 42, 43, 45 apo 59 apo kreu nr.68 00 apo 69 00);

p) artikujt e kapitullit 95.

2- Derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, makinat e përbëra nga dy apo më shumë makineri të përshtatura së bashku në formën e së tërës dhe makineri të tjera të adaptuara për qëllime të kryerjes së dy apo më shumë funksioneve plotësuese apo atyre alternative do të klasifikohen sikur përbëhen vetëm nga ai përbërës apo sikur është ajo makinë që kryen funksionin kryesor.

3- Kur një makinë (përfshi edhe makinat e kombinuara) përbëhet nga kompetentë individual (nëse janë të ndarë apo të ndërlidhur me tuba, mjete transimisioni, kablllo elektrike apo me mjete të tjera) që kanë qëllimin të kontribuojnë së bashku për një funksion të përcaktuar qartë, që përfshihet në një nga krerët e kapitullit 84 apo 85; të tëra bien për t'u klasifikuar në kapitullin e përshtatshëm për atë funksion.

4- Për qëllimet e këtyre shënimeve, shprehja “makinë” ka kuptimin çdo makinë, makineri, pajisje, aparat apo zbatim i përmendur në krerët e kapitujve 84 apo 85.

Kapitulli 84

Reaktorët nuklear; ngrohtësit e ujit, pajisjet mekanike dhe makineritë mekanike e pjesët e tyre

Shënime:

1- Ky kapitull nuk përfshin:

a) gurët e mullirit, gurët bluajtës apo artikujt e tyre të kapitullit 68;

b) pajisjet e makinerive (psh, pompat) apo pjesët e tyre prej materiali qeramik (kapitulli 69);

c) qelqurinat e laboratorit; makineri, pajisjet apo artikujt e tjerë për përdorime teknike apo pjesët e tyre prej qelqi (kreu nr.70 00);

d) sobat, skarat, enët e gatimit, hellin, larëset e pjatave dhe pajisje të tjera shtëpiake jo elektrike dhe pjesët e tyre, radiatorë për ngrohje qendrore, ngrohësit jo elektrike dhe pjesët e tyre, ngrohësit e ajrit të freskët dhe shpërndarësit e ajrit të ngrohtë (përfshi shpërndarësit e ajrit të freskët ao

kondicionerët) përfshirë edhe kondicionerët e makinave dhe pjesët e tyre, prej hekuri apo çeliku (kreu nr.73 00) apo artikuj të tjerë me metale të tjera bazë (kapitujt 74-76 apo 78-81);

e) veglat elektro-mekanike për punët me dorë apo pajisjet shtëpiake elektro-mekanike të kreut nr.85 00;

f) fshesat mekanike të operuara, jo të motorizuara (kreu nr.96 00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
84.01	Makineri bujqësore	0
84.02	Reaktorët nuklearë, ngrohësit e ujit, pajisjet mekanike dhe makineritë mekanike si dhe pjesët e tyre	5

KAPITULLI 85

PAJISJET DHE MAKINERITË ELEKTRIKE DHE PJESËT E TYRE: APARATET E REGJISTRIMIT OSE TË RIPRODHIMIT TË ZËRIT; APARATET E REGJISTRIMIT OSE TË RIPRODHIMIT TË FIGURAVE DHE TË TINGULLIT NË TELEVIZOR; PJESËT DHE PLOTËSUESIT E ARTIKUJVE TË TILLË

Shënime:

1-Ky kapitull nuk përfshin:

a) batanijet elektrike, jorganët elektrike, jastëkët elektrike apo artikuj të ngjashëm me to; rrobat, këpucët apo artikuj të tjerë me ngrohje elektrike që mund të vishen apo i përkasin një personi;

b) artikujt e qelqit të kreut nr.70.00;

c) mobileritë apo pajisjet me ngrohje elektrike të kapitullit 94.

2- kreu nr.85.00 përfshin vetëm makinat elektro-mekanike të mëposhtme të përdorura zakonisht për qëllime shtëpiake;

a) fshesë korrenti, pastrueset e dyshemesë, ngrirësit dhe përzierësit e ushqimeve dhe shtrydhësit e frutave të çdo peshe;

b) makina të tjera me kusht që pesha e tyre të mos kalojë 20 kg.

Kreu nr.85.00 nuk zbatohen megjithatë për fryrësit apo ventilatorët apo këllëfët e rrotullimit së bashku ventilatorët nëse janë përshtatur apo jo me filtra, makinat e centrifugimit të rrobave, të larjes së pjatave, makinat qepse, hekurat (kreu nr.84 00).

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
85 00	Pajisjet dhe makineritë elektrike dhe pjesët e tyre: aparatet e regjistrimit ose të riprodhimit të tingullit; aparatet e regjistrimit ose të riprodhimit të figurave në TV...	15

SEKSIONI XVII

MJETET E TRANSPORTIT, AVIONËT, ANIJET DHE PAJISJET SHOQËRUESE TË TRANSPORTIT

Shënime:

1- Ky seksion nuk përfshin lodrat me rrota, modelet e zvogëluara dhe artikujt me kurdisje, si dhe pajisje të tjera argëtuese apo sajat slitat dhe artikuj të ngjashëm të kreut nr.95 00

2- Shprehja “pjesët” dhe “pjesët dhe plotësuesit” nuk zbatohen për artikujt e mëposhtëm, nëse janë apo jo mallra të këtij seksioni:

a) guarnicionet apo vendet e bashkimit, prej çdo materiali (klasifikuar në përputhje me materialin e tyre përbërës apo në kreun 84. 00) apo artikuj të tjerë prej gome të vullkanizuar përveç gomës së fortë (kreu nr.40. 00);

b) pjesët e përdorimit të përgjithshëm, siç është përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, prej metali bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike (kapitulli 39);

c) artikujt e kapitullit 82 (veglat);

d) zilet, gongu dhe artikuj të ngjashëm jo-elektrikë, statujat dhe zbukurime të tjera, fotografi, piktura apo pasqyra dhe skelete të ngjashme, prej metaleve bazë (kreu nr.83. 00);

- e) makinat dhe aparaturat e kreut nr.84. 00;
- f) makineritë dhe pajisjet elektrike (kapitulli 85);
- g) artikujt e kapitullit 90;
- h) artikujt e kapitullit 91;
- i) armët (kapitulli 93)
- k) llampat dhe pajisjet e dritës (kreu nr.94 00);
- l) furçat e një lloji të përdorur si pjesë automjesh (kreu nr.96 00);

3- Referencat në kapitujt 86-88 për “pjesët” apo “plotësuesit” nuk zbatohet për pjesët apo plotësuesit që nuk janë të përshtatshme për përdorim, të paraqitur më vete apo kryesisht me artikujt e këtij kapitulli. Një pjesë apo plotësues i cili i përgjigjet përshkrimit të dy apo më shumë krerëve të këtyre kapitujve që do të klasifikohet në atë krye që i korrespondon përdorimit kryesor të asaj pjesë apo plotësuesi.

4- Avionët të ndërtuar që të mund të përdoren edhe si automjete rruge do të klasifikohen si avionë. Mjetet e transportit amfib do të klasifikohen si automjete.

5- Mjetet e transportit me jastëk-ajri do të klasifikohen brenda këtij seksioni me automjetet të cilëve ata i ngjajnë më shumë si më poshtë:

a) në kapitullin 86 në qoftë se janë të përcaktuar të udhëtojnë në një shinë (trenat me jastëk ajri);

b) në kapitullin 87 në qoftë se janë të përcaktuar të udhëtojnë në tokë apo së bashku në tokë dhe ujë;

c) në kapitullin 89 në qoftë se janë të përcaktuar të udhëtojnë në ujë, nëse janë të aftë apo jo të vendosen në breg apo tokë, apo gjithashtu të afta të udhëtojnë në akull.

Pjesët dhe plotësuesit e mjeteve me jastëk-ajri do të klasifikohen në të njëjtën mënyrë si ata mjetet, në kreun në të cilën mjetet me jastëk-ajri do të klasifikohen, sipas të njëjtave përcaktime.

Pajisjet dhe shinat e trenave me jastëk-ajri do të klasifikohen si shinat, pajisjet e hekurudhave po ashtu edhe shenja sinjalet, dhe pajisjet e kontrollit për këto trenat do të klasifikohen si ato të hekurudhave.

KAPITULLI 86

LOKOMOTIVAT E HEKURUDHAVE DHE TRAMVAJEVE, VAGONËT DHE PJESËT E TYRE: SHINAT, PAJISJET E HEKURUDHAVE DHE PJESËT E TYRE: SINJALET DHE PAJISJET E KONTROLLIT MEKANIK (PËRFSHI ELEKTRO-MEKANIKE) TË ÇDO LLOJI

Shënime:

1- Ky kapitull nuk përfshin

a) traversat e hekurudhave apo tramvajeve prej druri apo betoni, apo seksionet e shinave të betonuara për trenat me jastëk ajri (kreu nr.44.00 apo 68 00);

b) shinat e hekurudhave apo tramvajeve të ndërtuara me material-hekuri apo çeliku të kreut nr. 73 00;

c) sinjalet, pajisjet e kontrollit elektrik të kreut nr.85 00.

2- Kreu nr.86 00 zbatohet ndër të tjera për:

a) boshtet, rrotat, ingranazhet, bucelat e rrotave, rrathë rrote dhe pjesët e tjera të rrotave;

b) skeletet, shasitë me shumë rrota;

c) kutitë e boshteve, frenat;

d) amortizatorët e vagonave, grepat dhe pajisjet e tjera lidhëse dhe lidhjet e korridoreve;

e) karrocera.

3-I nënshtruar nga përcaktimi i shënimit 1 më lart, kreu nr. 86 00 zbatohet ndër të tjera për:

a) amortizatorët e platformës, për kompleksin e shinave, matësit e ngarkesave;

b) semaforët, disqet, mekanike, instrumentet e kontrollit të kryqëzimeve, sinjalet mekanike (përfshi edhe ato elektro-mekanike, pajisjet e sigurimit teknik, nëse janë apo jo të përshtatshme për dritë elektrike, për hekurudhat, tramvajet, rrugët, rrugët ujore brenda vendit, lehtësi parkimi, instalimet e portit.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
----------	------------	-------------

86 00	Lokomotivat e hekurudhave dhe tramvajeve, vagonët dhe pjesët e tyre, sinjalet dhe pajisjet e kontrollit mekanik (përfshi elektro-mekanike) të çdo lloji	5
-------	---	---

KAPITULLI 87

MJETET VEÇ VAGONËVE TË HEKURUDHAVE DHE TRAMVAJEVE SI DHE PJESET DHE PLOTËSUESIT E TYRE

Shënime:

1- Ky kapitull nuk përfshin vagonët e hekurudhave dhe tramvajeve të përcaktuar për të ecur vetëm mbi shinat

2- Për qëllimet e këtij kapitulli traktor” ka kuptimin mjet i ndërtuar kryesisht për tërheqjen apo shtytjen e mjeteve të tjera, apo të pajisjeve dhe ngarkesave, nëse përmbajnë apo jo mjete ndihmëse për transport, në lidhje me përdorimin kryesor të traktorëve për mbjellje, plherëim etj.

3. Kreu nr.87.02 përfshin të gjitha biçikletat e fëmijëve. Mjete të tjera të fëmijëve futen brenda kreut nr.95 00.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
87.01	Traktorë	0
87.02	Mjetet e transportit, veç vagonëve të hekurudhave dhe tramvajeve si dhe veç traktorëve. Pjesët dhe plotësuesit e tyre	5

Shënim: Për automjetet e përdorura do të zbatohen këto taksa doganore:

a) motoçikletat e triciklet të të gjitha llojeve që kanë përshkuar mbi 5 mijë km.....2 mijë lekë.

b) autoveturat mbi 10 mijë km 15 mijë lekë

c) për kamionët mbi 3 tonë dhe autobusët, mbi 10 mijë lekë të përdorur50 mijë lekë.

d) për mikrobuzët, kamioncinat, furgonat dhe kamionët deri në 3 tonë, mbi 10 mijë km të përdorur.....30 mijë lekë.

Masa e taksës ndryshon në përputhje me masën e indeksit të inflacionit

KAPITULLI 88

AVIONËT, ANIJET KOZMIKE DHE PJESET E TYRE

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
8.00	Avionët, anijet kozmetike dhe pjesët e tyre	5

KAPITULLI 89

ANIJET, VARKAT DHE STRUKTURA E FLOTËS DETARE

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
9.00	Anijet, varkat dhe struktura e flotës detare	5

SEKSIONI XVIII

INSTRUMENTAT DHE APARATURAT OPTIKE FOTOGRAFIKE, KINEMATOGRAFIKE, MATËSE KONTROLLI PRECIZE, MJEKËSORE APO KIRURGJIKALE, ORËT, INSTRUMENTET MUZIKORE, PJESET DHE PLOTËSUESIT E TYRE

KAPITULLI 90
INSTRUMENTE DHE APARATURAT OPTIKE FOTOGRAFIKE, KINEMATOGRAFIKE,
MATËSE, KONTROLLI, PRECIZE MJEKËSORE APO KIRURGJIKALE; PJESËT DHE
PLOTËSUESIT E TYRE

Shënime:

1- Ky kapitull nuk përfshin:

a) artikujt e një lloji të përdorur në makineritë, pajisjet apo për qëllime të tjera teknike, prej gome të vullkanizuar përveç gomës së fortë (kreu nr.44.00), prej lëkure apo lëkurë e përbërë (kreu nr.42.00) apo prej materiali tekstili (kreu nr.59.00);

b) mallrat zjarrduruese, qeramikat për laborator për qëllime kimike apo teknike, të kreut nr.69.00;

c) pasqyrat prej xhami jo të punuara nga ana optike (kreu nr.70.00) apo pasqyrat me metale bazë apo metale të çmuar, që nuk janë elemente optikë (kreu nr.83.00);

d) mallrat e kreut nr.70.00;

e) pjesët e përdorimit të përgjithshëm, siç është përcaktuar në shënimin nr.2 të seksionit XV me metal bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme prej plastike (kapitulli 39);

f) pompat së bashku me mjetet matëse, peshoret dhe makineritë e kontrollit; pajisjet e ngritjes dhe uljes; makinat e të gjitha llojeve të prerjes së letrës dhe të kartonit; pajisjet për përshtatjen e veglave në vegla makinë, përfshi pajisjet me mjete “optike” për të lexuar (p.sh. të ashtuquajturit ndarës “optikë”) por, jo ata që në vetvete janë kryesisht elemente optikë (p.sh. teleskopët dhe tubat optikë për matjen e këndeve horizontale); makinat e kalkulimit, valvolat dhe pajisje të tjera (kreu nr.84.00);

g) projektorët e një lloji të përdorur për motoçikleta apo automjete, llampat elektrike portative, regjistruarit, kinematografik të tingullit, aparaturat e riprodhimit apo të reregjistrimit, radarët, radiomarrësit e anijeve luftarake apo radiokontrollët, kabllot me fibra optikë (kreu nr.85.00);

h) projektorët (kreu nr.94.00);

i) artikujt e kapitullit 95;

k) rrotkat, bobinat apo pajisje ndihmëse të ngjashme (të cilat do të klasifikohen në përputhje me materialin përbërës, p.sh. në kreun nr.39.00 apo seksioni XV);

1- matësit e kapacitetit, që do të klasifikohen në përputhje me materialin përbërës;

2- Të nënshtruar ndaj shënimit 1 më lart, pjesët dhe plotësuesit për makina, aparatura, instrumenta apo artikujt të këtij kapitulli do të klasifikohen në përputhje me rregullat e mëposhtme:

a) pjesët dhe plotësuesit të cilët janë mallra të përfshirë brenda këtij kapitulli apo kapitujve 84, 85, 91 janë në të gjitha rastet të klasifikuara brenda kapitujve të tyre respektive;

b) të gjitha pjesët dhe plotësuesit e tjerë do të klasifikohen brenda këtij kreu (nr.90.00).

3-Shënimi 4 i seksionit XVI zbatohet gjithashtu edhe për këtë kapitull.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
90.00	Instrumentat dhe aparaturat, optike, fotografike, kinematografike, matësae, kontrolli, precize, mjekësore apo kirurgjikale, pjesët dhe plotësuesit e tyre	

KAPITULLI 91
ORËT DHE PJESËT E TYRE

Shënime:

1- Ky kapitull nuk përfshin:

a) xhamat apo peshat e orëve si të dorës edhe të murit, (të klasifikuara, në përputhje m materialin e tyre përbërës);

b) zinxhirët e orave (kreu nr.71.00);

c) pjesët e përdorimit, të përgjithshëm të përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, prej metali bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme prej plastike (kapitulli 39) apo prej metaleve të çmuar apo veshje metali me metal të çmuar (në përgjithësi kreu nr.71.00), zemberekët e orave megjithatë, do të klasifikohen në kreun nr.91.00;

d) kushinetat (kreu nr.73.00 apo 84.00 siç mund të jetë rasti);

e) motorat me djegie të brendshme dhe motorat e ndërtuar për të punuar pa marmitë (kreu nr.84.00);

f) sferat e kushinetave (kreu nr.84.00);

g) artikujt e kapitullit 85, të pambledhura akoma së bashku me komponentë të tjerë për lëvizjet e orave apo për artikujt të përshtatshëm për përdorim, vetëm apo kryesisht si pjesë të lëvizjeve të tilla (kapitulli 85).

2- Për qëllimet e këtij kapitulli, shprehja “lëvizësit e orave” ka kuptimin mjetet që rregullohen nga një rrotë-balanci dhe qimja, kristale kuarci apo ndonjë sistem tjetër i aftë të përcaktojë intervalet e kohës, me një paraqitje apo një sistem të cilin është bashkangjitur një mekanizëm tregues. Lëvizës të tillë të orës nuk i tejkalojnë 12 mm në trashësi dhe 50 mm në gjerësi, gjatësi apo diametër.

3- Përveç se siç është përcaktuar në shënimin 1, lëvizësi dhe pjesët e tjera të përshtatshme për t’u përdorur si në orët dhe në artikujt të tjerë (psh instrumentat precize) do të klasifikohen brenda këtij kapitulli.

reun nr.	K	Përshkrimi	Tarifa në %
1.00	9	Orët dhe pjesët e tyre	

KAPITULLI 92

INSTRUMENTAT MUZIKORË, PJESET DHE PLOTËSUESIT E ARTIKUJVE TË TILLË

Shënim:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

a) pjesët e përdorimit të përgjithshëm, të përcaktuara, në shënimin 2 të seksionit XV, prej metali bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike (kapitulli 39);

b) mikrofonët, amplifikatorët, altoparlantët, kufjet, çelësat dhe instrumenta të tjerë ndihmëse të kapitullit 85 apo 90 për përdorime, por jo të bashkuar apo të vendosur në të njëjtën vend si instrumentat e këtij kapitulli;

c) aparaturat dhe instrumentat të përdorura si lodra (kreu nr.95.00);

d) furçat për pastrimin e instrumentave muzikore (kreu nr.96.00)

e) pjesët e mbledhura apo antikat (kreu nr.97.00)

f) rrotkat, bobinat apo pajisjet e ngjashme (të cilat do të klasifikohen në përputhje me materialin e tyre përbërës, p.sh kreu nr.39.00, seksioni XV).

SEKSIONI XIX

ARMËT DHE MUNICIONET, PJESET DHE PLOTËSUESIT E TYRE

KAPITULLI 93

ARMËT DHE MUNICIONET, PJESET DHE PLOTËSUESIT E TYRE

Shënime:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

a) mallrat e kapitullit 36 (p.sh detonatorët, kapsulat plasëse, sinjalet e dritës);

b) pjesët e përdorimit të përgjithshëm, siç është përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, prej metali bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike (kapitulli 39);

c) automjetet e blinduara (kreu nr.87.00);

d) dylbitë apo mjete të tjera optike për përdorim së bashku me armët, derisa të fiksohen në armët e zjarrit apo paraqitur me armët e zjarrit në të cilat ato janë përcaktuar të fiksohen (kapitulli 90);

e) shigjetat, harqet, shpatat apo lodrat imagjinare (kapitulli 95);

f) copat e mbledhura nga koleksionistët apo antikat (kreu nr.97.00)

2- Në kreun nr.93.00 referenca “pjesët prej tyre” nuk përfshin radiot dhe radarët e kreut nr.85.00

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
----------	------------	-------------

93.00	Armët dhe municionet; pjesët dhe plotësuesit e tyre	30
-------	---	----

SEKSIONI XX
ARTIKUJ TË NDRYSHËM TË PRODHUAR

KAPITULLI 94

MOBILJET, PAJISJET E DRITËS DHE LLAMPAT, PAJISJET E FJETJES, PAJISJET E DYSHEKËVE, JASTËKËT, DYSHEKËT DHE PAJISJET E TJERA TË MBUSHUA, TË PASPECIFIKUARA APO TË PAPËRMENDURA DIKU TJETËR; SHENJAT NDRIÇUESE, PLLAKAT NDRIÇUESE DHE ARTIKUJ TË NGJASHËM; PARAFABRIKATET

Shënime:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

- a) jastëkët, dyshekët pneumatikë apo me ujë, kapitujt 39, 40, 63;
- b) pasqyrat e përcaktuara për t'u vendosur në dysHEME apo tokë të kreut nr.70.00;
- c) artikujt e kapitullit 71;
- d) pjesët e përdorimit të përgjithshëm siç janë përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, me metale bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike të kapitullit 39; apo kasafortat (kreu nr.83.00);
- e) pajisjet veçanërisht të përcaktuara si pjesë të frigoriferëve apo për makinat qepëse (kreu nr.34.00);
- f) llampat dhe pajisjet e dritës të kapitullit 85;
- g) pajisjet veçanërisht të përcaktuara si pjesë të aparatave të kreut nr.85;
- h) pjesët dhe plotësuesit e motoçikletave (përfshi biçikletat me motor) dhe biçikletat e pajisura me një motor ndihmës, me apo pa kosh motociklete, bicikletat me kosh dhe biçikleta të tjera (triçiklet) të paamortizuara dhe karrocet e invalidëve, nëse janë apo jo të motorizuara apo me mjete të tjera mekanike shtytëse (kreu nr.87.00);
- i) karrike dentare së bashku me pajisjet dentare apo pështymoret (kreu nr.90.00);
- k) artikujt e kapitullit 91 (psh, orët dhe kutitë e tyre);
- l) lodrat apo llampat dhe pajisjet e dritës si lodra, tabelat e bilardos dhe mobiljet e tjera të ndërtuara për lojra, pajisjet për prestigjatorët apo pajisjet për zbukurim (përveç kurorave elektrike) të tilla si fenerët kineze (kreu nr.95.00)

2- Mobilieritë apo pajisjet (përveç pjesëve) të referuar në kreun nr.94.00 do të klasifikohen në atë kre vetëm nëqoftëse është përcaktuar për t'u vendosur në dysHEME apo në tokë.

Por, të mëposhtmet do të klasifikohen në krrerët e sipërpërmendur edhe nëqoftëse ata janë përcaktuar për t'u varur apo ngulur në mur apo të qëndrojnë njera mbi tjetrën:

- a) bufetë, bibliotekat, raftet e librave, raftet e tjera;
- b) karriket apo ndenjës të krevatet.

3- Për qëllimet e kreut nr.9.00 shprehja "parafabrikate" ka kuptimin ndërtesa që janë mbaruar në fabrikë apo ndërtuar si elementë, të paraqitur së bashku, të grumbulluar në vendqëndrim, të tillë si banesa, apo kantierët e ndërtimit, zyra, shkolla, dyqane, garazhe apo ndërtesa të ngjashme.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
94.01	Mobiljet, pajisjet e fjetes, dyshekët, jastëkët dhe pajisjet e tjera të mbushura; llampat dhe pajisjet e dritës të paspecifikuara apo të papërmendura diku tjetër; shenjat ndriçuese, pllakat ndriçuese dhe artikujt të ngjashëm	30

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
91.02	Parafabrikatet	5

KAPITULLI 95

LODRAT, PAJISJET E SPORTIT DHE TË LOJRAVE TË NDRYSHME; PJESET DHE
PLOTËSUESIT E TYRE

Shënime:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

- a) qirinjtë e pemës për Krishtlindje (kreu nr.34.00)
- b) fishekzjarret dhe artikujt e tjerë piroteknik (kreu nr.36.00);
- c) fijet, monofilamentet, kodrat apo artikuj të ngjashëm për peshkim, të kapitullit 39, të kreut nr.42.00 apo seksioni XI;
- d) çantat e sportit apo kontenierë të tjerë të kreut nr.42.00;
- e) rroba sporti apo kostumet maskarade, prej tekstili të kapitullit 61 apo 62;
- f) flamujt tekstilë apo velat për varkat (kapitulli 63);
- g) këpucët sportit (përveç patinave me çizme të ngjitur në to) të kapitullit 64 apo kapelet e sportit të kapitullit 65;
- h) bastunët, kamzhikët, rripat për hipizëm apo artikuj të ngjashëm apo pjesët e tyre (kreu nr.66.00);
- i) sy xhami të pangulur për kukulla apo lodra të tjera (kreu nr.70.00)'
- k) pjesët e përdorimit të përgjithshëm siç është përcaktuar në shënimin nr.2 të seksionit XV, prej metali bazë, (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike (kapitulli 39);
- l) zilet, gongu apo artikuj të ngjashëm (kreu nr.83.00);
- m) motorët elektrike, transformatorët apo aparatet e radio kontrollit (kreu nr.85.00);
- n) automjetet sportive (përveç slitave dhe pajisjeve të ngjashme) të seksionit XVII;
- o) bicikletat e fëmijëve (kreu nr.87.02);
- p) pajisjet lundruese sportive si kanoet apo kaiket (kapitulli 89) apo mjetet e tyre të shtytjes (kapitulli 44 për artikuj të tillë të bërë me dru);
- q) syze mbrojtëse apo artikuj të ngjashëm për sportet dhe lojrat jashtë (kreunr.90.00);
- r) bilbilat apo mjete të tjera të ngjashme (kreu nr.92.00)'
- s) armët dhe artikujt e tjerë të kapitullit 93;
- t) zbulurimet elektrike të të gjitha llojeve (kreu nr.94).
- u) telat, fijet, tendat apo mallra të tjera kampingu apo dorezat (klasifikohen sipas materialit përbërës);

2- Ky kapitull përfshin artikujt në të cilët perlat natyrale apo të punuara, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar (natyrale, sintetike apo të kultivuara), metalet e çmuar apo veshjet e metaleve me metal të çmuar, përbëjnë vetëm përbërësit më të parëndësishëm.

3- Të nënshtruar nga shënimi 1 më lart, pjesët dhe plotësuesit që janë të përshtatshëm për t'u përdorur të vetëm apo kryesisht me artikujt e këtij kapitulli do të klasifikohen me këta artikuj.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
95.00	Lodrat; pajisjet e sportit dhe të lojrave të ndryshe; pjesët dhe plotësuesit e tyre.	30

KAPITULLI 96 ARTIKUJ TË NDRYSHËM TË PRODHUAR

Shënime:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

- a) lapsat për kozmetikë apo për tualet (kapitulli 33);
- b) artikujt e kapitullit 66 (psh pjesët e çadrave apo bastunëve);
- c) imitacionet e bizhuterive (kreu nr.71.00);
- d) pjesët e përdorimit të përgjithshëm, siç është përcaktuar në shënimin 2 të seksionit XV, me metal bazë (seksioni XV) apo mallra të ngjashme plastike (kapitulli 39);
- e) takëmet, kompletet e ngrënies apo artikuj të tjerë të kapitullit 82 me doreza apo pjesë të tjera prej materiali prerës apo material që jep formë; kreu nr.96.00 zbatohet megjithatë për doreza të paraqitura veç apo pjesë të tjera të artikujve të tillë;
- f) artikujt e kapitullit 90 (psh skeleti i syzave, laps për pëdroim në matematikë, furçat e përshtatura për përdorim në stomatologji apo mjekësi kirurgji apo veterinar);
- g) artikujt e kapitullit 91 (psh orët apo kutitë e tyre);
- h) instrumentat muzikore apo pjesët dhe plotësuesit e tyre (kapitulli 92);

- i) artikujt e kapitullit 93 (armët dhe pjesët e tyre);
- k) artikujt e kapitullit 94 (p.sh mobileritë, llampat apo pajisjet e dritës);
- l) artikujt e kapitullit 95 (lodrat, pajisjet sportive);
- m) veprat e artit apo antikat (kapitulli 97).

2- Mbërthyesat dhe pjesët e tyre; stilolapsat, lapsat me majë të mbushur dhe ata me majë poroze dhe shënuesit; stilografët, lapsat, stilografa dhe lapsa të tjerë, stilolapsa dyfish; mbajtëse lapsash, stilolapsash dhe mbajtës të ngjashëm; pjesët (përfshirë kapëset dhe kapakun) e lapsave dhe mbajtësve të tyre; shkumësat me ngjyrë, maja lapsi, qymyr druri për vizatim, shkumësa për shkrim dhe shkumësat e rrobaqepësit; rrasat dhe dërrasat me gjithë sipërfaqen e shkrimit apo vizatimit; çakmakët nëse janë apo jo mekanikë apo elektrikë dhe pjesët e tyre (përveç strallit dhe fitilit); pipa e duhanit dhe mbajtësit e duhanit dhe cigareve dhe pjesët e tyre. Spray-t e parfumit dhe spray të tjerë të ngjashëm të tualetit; pufe pudre dhe tamponet (mbushjet për bërjen e kozmetikës dhe tualetit); enët laboratorike vacuum dhe enë të tjera vacuum, së bashku me kutitë; manekinët e rrobaqepësve, automatë dhe reklamime të tjera frymëzuese përdorur në dyqanet e hapura të rrobave (kreu nr.96.00), mbeten të klasifikuara brenda kapitullit, nëse janë apo jo të përbëra tërësisht apo pjesërisht me metal të çmuar apo veshje metali me metal të çmuar, me perla natyrale apo të kultivuara, apo gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar, (natyralë, sintetikë apo të riprodhuara). Por, ky kapitull përfshin artikujt e sipërpërmendur në të cilat perlat natyrale apo të kultivuara, gurët e çmuar apo gjysmë të çmuar (natyralë, sintetikë apo të riprodhuara), metalet e çmuar apo veshjet e metalit me metal të çmuar përbëjnë vetëm një përbërës të parëndësishëm ose përbëjnë pakicën e artikullit.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
96.00	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	30

SEKSIONI XXI

VEPRAT E ARTIT; PJESET E MBLEDHURA NGA KOLEKSIONISTËT DHE ANTIKAT

KAPITULLI 97

VEPRAT E ARTIT; PJESET E MBLEDHURA NGA KOLEKSIONISTËT DHE ANTIKAT

Shënime:

I-Ky kapitull nuk përfshin:

a) stampat postare të papërdorshme, shkresuritë postare dhe artikuj të ngjashëm, të dala vazhdimisht apo të reja, në vendet drejt të cilave ato janë të destinuara (kapitulli 49);

b) sfondi i skenave teatrale, studiove apo vendeve të ngjashme me kanavacë të pikturuar (kreu nr.59.00) përveçse nëqoftëse mund të klasifikohen brenda kreut nr.97.00;

c) perlat natyrale apo të kultivuara, apo gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar (kreu nr.,71.01);

2- Për qëllimet e kreut nr.97.00 shprehja “gdhendjet, shtypjet dhe litografite origjinale” kanë kuptimin ndjenja, mbresa të prodhuara direkt në ngjyrë të bardhë apo të zezë, me një apo më shumë pllaka të tëra të bëra me dorë nga një artist, pavarësisht nga procesi apo materiali i përdorur nga ai; por, nuk përfshin ndonjë proces mekanik apo fotomekanik.

3- Kreu nr.97.00 nuk zbatohet për riprodhimet e prodhuar në masë apo punët e zejtarisë tradicionale me karakter tregtar.

4- Të nënshtruar nga shënimi 1 deri 3 më lart, artikujt e këtij kapitulli do të klasifikohen në këtë kapitull dhe në asnjë kapitull tjetër të nomenklaturës.

5- Skeletet përreth pikturave, vizatimeve apo pllakave të ngjashme dekorative, gdhendjeve, shtypjeve apo litografive, do të trajtohen si pjesë përbërëse e këtyre artikujve, me kusht që, ata të jenë të një lloji dhe të një vlere të njëjtë me këta artikuj.

Kreu nr.	Përshkrimi	Tarifa në %
97.00	Veprat e artit, pjesët e mbledhura nga koleksionistët dhe antikat	0